FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 112

Tiranë – E enjte, 15 korrik 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.6.2021	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021–2030, dhe të planit të saj të veprimit.....	10213
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 15.7.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 544, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për lejimin e përdorimit të brigjeve në funksion të realizimit të projektit investues strategjik *'Green Coast'"*, të ndryshuar.....	10386
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 15.7.2021	Për mbështetjen financiare për menaxhimin e mbetjeve në bashkitë e qarkut të Durrësit.....	10387
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 249, datë 25.6.2021	Për miratimin e rregullores, për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe të Impianteve Kombëtare (DSGIK), për veprimtarinë e sektorit të gazit natyror, në kuadër të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) në rolin e inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror.....	10387
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 372/1, datë 8.7.2021	Për një ndryshim në urdhrin nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.....	10398
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 33, datë 7.7.2021	Për miratimin e rregullores "Për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë për administrimin e aktiveve".....	10398
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 34, datë 7.7.2021	Për miratimin e rregullores "Për kriteret për përcaktimin e normave të konvertimit të detyrimeve në kapital".....	10403
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 35, datë 7.7.2021	Për miratimin e rregullores "Për llojet e marrëveshjeve që do të mbrohen në transferimin e pjesshëm".....	10407
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 37, datë 7.7.2021	Për dhënien e miratimit paraprak për zotërimin nga *Çalik Holding A.Ş.* të 100 për qind të kapitalit aksionar të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a.....	10410

Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 289, datë 13.7.2021

Për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi projektit "Unaza lindore e Kavajës"..... 10410

Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të vdekur të shtetasit Burhan Strazimiri..... 10412

Vendim *(i shkurtuar)* për heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasin Fatmir Guci..... 10412

Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Fejzi Petanaj..... 10412

VENDIM
Nr. 400, datë 30.6.2021

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE, 2021–2030, DHE TË PLANIT TË SAJ TË VEPRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021–2030, dhe të planit të saj të veprimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe insitucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR BARAZINË GJINORE 2021–2030
Qershor 2021

PËRMBAJTJA

SHKURTIMET
PJESA I - KONTEKSTI STRATEGJIK
1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik
2. Kuadri ligjor dhe institucional, si dhe lidhja me dokumentet strategjike
2.1 Kuadri ligjor kombëtar
2.2 Kuadri institucional
2.3 Lidhja e SKBGJ 2021–2030 me dokumentet strategjike
3. Arritjet, analiza dhe sfidat
4. Vizioni dhe misioni i dokumentit
5. Metodologjia
PJESA II – QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT PRIORITARE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË
Politika I
Politika II
Politika III
Politika IV
PJESA III – ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA
RAPORTIMI DHE MONITORIMI
Llogaridhënia, monitorimi dhe raportimi
PJESA IV: ANALIZA BUXHETORE
ANEKS 1. MATRICA E QËLLIMEVE TË POLITIKËS DHE TREGUESIT
ANEKS 2. MATRICA E OBJEKTIVAVE SPECIFIKË DHE TREGUESIT
ANEKS 3. MATRICA E MASAVE DHE TREGUESIT
ANEKS 4. LOGJIKA E NDËRHYRJES, INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE, AFATET KOHORE

SHKURTIMET

AGD	Aleanca e Grave Deputete
AGK	Aleanca e Grave Këshilltare (në nivel të Këshillave Bashkiakë)
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKAFPK	Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
AKEFP	Agjencia Kombëtare për Edukimin dhe Formimin Profesional
AKK	Aleanca Kombëtare e Këshilltarëve
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
AKR	Agjencia Kombëtare e Rinisë
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMVV	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore
AP	Avokati i Popullit
ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
ASHDMF	Agjensia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve
BDHTI	Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
BE	Bashkimi Evropian
BGJ	Barazia Gjinore
BPGJ	Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor

BtF	Projekti Bashki të Forta
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DHBGJ	Dhunë me Bazë Gjinore
DHF	Dhunë në Familje
DHKA	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
ETN	Ekipi Teknik Ndërdisiplinar i trajtimit të rasteve të dhunës në familje
GAP III	Grupi Ndërinstitucional i Punës
GNP	Plani i Veprimit për Barazinë Gjinore III 2021–2025, i Bashkimit Evropian
GREVIO	Grupi i Ekspertëve për Veprimet kundër Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje
GTIS	Grupi i treguesve dhe i integritetit të statistikave
ISHPSHSH	Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
KB	Kombet e Bashkuara
KE	Këshilli i Evropës
KKBGJ	Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVDHF	Koordinatore/Koordinator Vendor kundër Dhunës në Familje
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MSA	*Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe komuniteteve evropiane e shteteve të tyre anëtare*
MSHD	*Ministri i Shtetit për Diasporën*
MSHMS	*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*
MIE	*Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë*
MKR	*Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në familje*
MTM	*Ministria e Turizmit dhe Mjedisit*
KLD	*Këshilli i Lartë i Drejtësisë*
KMD	*Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi*
NBGJ	Nëpunëse/nëpunës i Barazisë Gjinore
NJF	*Ndihma Juridike Falas*
NJPF	*Ndihma Juridike Parësore Falas*
NJDF	*Ndihma Juridike Dytësore Falas*
NJMF	*Njësi për Mbrojtjen e Fëmijëve*
NJVKSH	*Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor*
NJVV	*Njësi e Vetëqeverisjes Vendore*
OJF	*Organizatë Jofitimprurëse*
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
OKB	*Organizata e Kombeve të Bashkuara*
PKIE	*Plani Kombëtar i Integrimit Evropian*
QFP	Qendra e Formimit Profesional
QKEV	Qendra Kombëtare për Edukimin në Vazhdim
QKTVDHF	Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje
RSH	Republika e Shqipërisë
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
SHM	Shkolla e Magjistraturës
SHSSH	*Shërbimi Social Shtetëror*
UM	Urdhër Mbrojtjeje
UMM	Urdhër i Menjëhershëm Mbrojtjeje
UMPMM	Urdhër për Masa Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme
VKB	*Vendim i Këshillit Bashkiak*
VKM	*Vendim i Këshillit të Ministrave*
ZVAP	Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

PJESA I
KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit strategjik.

"Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030" (këtu e në vijim SKBGJ 2021–2030) u përgatit në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe konsultim me ministritë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për arritjen e barazisë gjinore dhe zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në Shqipëri.

E konceptuar si vijim dhe e lidhur logjikisht me Strategjinë e mëparshme për Barazinë Gjinore 2016–2020[1], SKBGJ 2021–2030 përbën një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individëve gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, u jepen

[1] https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf

mundësi të barabarta të zhvillojnë potencialet e tyre; të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në vendimmarrjen politike e publike; të zgjedhin e të zgjidhen; të edukohen dhe aftësohen gjatë gjithë jetës; të punësohen e punësojnë duke avancuar drejt profesioneve të reja e duke sfiduar steriotipat dhe ndarjen gjinore të punës; të ndikojnë në zhvillimin socio-ekonomik të vendit dhe të mbështeten për t'u zhvilluar në aspektin social dhe ekonomik; të krijojnë familje të shëndetshme, ku prindërit ndajnë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë dhe ku komunikimi është çelësi i zgjidhjes së problemeve; të jetojnë të lirë nga praktikat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cenueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës – pra një shoqëri ku barazia nuk ngatërrohet me njëtrajtshmërinë dhe ku askush nuk duhet të mbetet pas.

SKBGJ 2021–2030 është e katërta e këtij lloji dhe padyshim reflekton (sikurse dhe strategjitë e mëparshme), përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që qeveria e Shqipërisë i kushton arritjes së barazisë gjinore, si dhe zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Kjo nënkupton lidhjen e drejtpërdrejtë të saj me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II 2015–2020[2], si dhe me Programin Qeverisës 2017–2021[3]. E përgatitur për një periudhë kohore dhjetëvjeçare, SKBGJ 2021–2030 reflekton gjithashtu edhe lidhjen e drejtpërdrejtë me plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm[4] (OZHQ) dhe të Agjendës 2030[5]. Po kështu, masat dhe veprimet e parashikuara në këtë strategji ndërthuren apo lidhen dhe me masat dhe veprimet e parashikuara në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020–2025[6] të Bashkimit Evropian, të specifikuar më tej në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021–2025, publikuar në 25 nëntor 2020[7,8]. Përgatitja e SKBGJ 2021–2030 ishte planifikuar edhe në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për vitin 2021, në Planin Kombëtar të Integrimit Evropian (PKIE) 2021–2023, konkretisht në kapitullin 19, II.7, "Barazia midis grave dhe burrave në punësim dhe politikë sociale", si dhe është në linjë me *Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre anëtare*(MSA), neni 99 "Bashkëpunimi Social".

Ky dokument strategjik reflekton në mënyrën e duhur edhe plotësimin e standardeve apo detyrimeve që rrjedhin nga dokumente të tjera ndërkombëtara, kundër më të rëndësishmet veçojmë Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskrimiminit ndaj Grave (CEDAW)[9], Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit[10], si dhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave e Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit)[11] etj. Gjithashtu, gjatë planifikimit të masave të caktuara për adresimin e shqetësimeve kryesore në fushën e barazisë dhe të drejtësisë gjinore, janë mbajtur në konsideratë edhe Rekomandimet e Komisionit Evropian të dërguara nëpërmjet "Raportit për Shqipërinë 2020", ku evidentohen çështjet kryesore për t'u konsideruar për vitin 2021, përfshirë edhe mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave të ndara sipas seksit e statistikave gjinore, në të gjitha fushat, mundësisht edhe në ekonominë informale[12].

[2] https://elbasani.gov.al/sq-al/Documents/Strategjia%20Kombetare%20per%20Zhvillim%20Integrim%202015-2020.pdf
[3] https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf
[4] https://sdgs.un.org/goals
[5] https://sustainabledevelopment.un.org/content/documents/21252030%20Agenda%20for%20Sustainable%20Development%20web.pdf
[6] https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020DC0152&from=EN
[7] https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/join-2020-17-final_en.pdf
[8] https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/swd_2020_284_en_final.pdf
[9] https://hrrp.eu/alb/docs/CEDAw-a.pdf
[10] https://awenetwork.org/wp-content/uploads/2019/05/Deklarata-dhe-Platforma-per-Veprim-e-Pekinit.pdf
[11] https://rm.coe.int/168046246b
[12] https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/default/files/albania_report_2020.pdf

SKBGJ 2021–2030 u hartua duke u bazuar në gjetjet dhe rekomandimet nga "Raport-vlerësimi: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2016–2020", për rrjedhojë synon zgjerimin, thellimin dhe shtimin e masave të parashikuara dhe të pazbatuara plotësisht apo edhe të zbatuara, por që kërkojnë mbështetje për qëndrueshmëri afatgjatë, sipas qëllimeve strategjike të përcaktuara më herët në SKBGJ 2016–2020.

Në të gjithë dokumentin strategjik dhe planin e veprimit të SKBGJ 2021–2030, theksohet rëndësia e mbështetjes, trajtimit dhe fuqizimit të grave, të të rejave dhe të vajzave në tërësi, përfshirë edhe nga grupe të cenueshme e që pësojnë diskriminim të shumëfishtë, si: gra, të reja dhe vajza nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, nëna të vetme, të dhunuara, të trafikuara, të moshuara, azilkërkuese etj., pra nga të gjitha grupet në shoqëri.

2. Kuadri ligjor dhe institucional, si dhe lidhja me dokumentet strategjike

Qeveria e Shqipërisë prej vitesh tashmë ka vënë në prioritet fuqizimin e kuadrit ligjor dhe institucional, në lidhje me barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore e dhunën në familje, duke synuar njëkohësisht dhe harmonizimin e këtij kuadri ligjor kombëtar me atë ndërkombëtar, bazuar veçanërisht në: Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Protokollin Shtesë të saj, Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020–2025 të Bashkimit Evropian dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021–2025 etj.

2.1 Kuadri ligjor kombëtar.

Njohja dhe respektimi i të drejtave ligjore të barabarta ndërmjet grave dhe burrave theksohen që në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në nenin 18/2 të së cilës promovohen parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit: "Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla, si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale".

Përpjekjet në vazhdimësi për harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me atë ndërkombëtar, kanë rezultuar në evidentimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe të luftës kundër diskriminimit gjinor, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, jo vetëm në ligje të veçanta dedikuara këtyre çështjeve, por edhe në legjislacionin shqiptar në tërësi.

Ligji nr. 9970, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri". Nga vetë objekti i tij ligji rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe të trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës. Në këtë ligj parashikohen masa të veçanta të përkohshme për të garantuar të paktën 30% pjesëmarrje të gjinisë më pak të përfaqësuar në postet politike dhe vendimmarrëse publike, si dhe mbrojtja nga diskriminimi në sektorët e arsimit, punësimit, medias etj. Gjithashtu parashikohet mbledhja e detyrueshme e statistikave gjinore, nga të gjitha organet shtetërore, si dhe ngritja e strukturave dhe mekanizmave institucionalë për çuarjen përpara të barazisë gjinore. Plotësimi i kuadrit nënligjor për zbatimin e këtij ligji, ndër të tjera edhe me VKM-në nr. 465, datë 16.7.2012, "Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm", i hapi rrugën jo vetëm planifikimit të objektivave të matshëm gjinor në programet buxhetore të institucioneve qendrore, por edhe të gjithë hapave të mëtejshëm në drejtim të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor (BPGJ) në Shqipëri. Ndërsa, me **ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore",** u është vënë detyrim kryetareve/kryetarëve të bashkive, që në emërimet e zëvendëskryetarëve/kryetarëve të bashkive dhe emërimet e administratoreve/administratorëve të njësive administrative të zbatojnë dhe respektojë barazinë gjinore.

Ligji nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", parashikon për herë të parë detyrimin e subjekteve zgjedhore për të respektuar barazinë gjinore. Ky Kod parashikoi në disa dispozita të tij zbatimin e kuotave gjinore, si në administratën zgjedhore, komisionet e nivelit të dytë dhe në përbërjen e trupit të zgjedhur legjislativ, Kuvendit. Kodi Zgjedhor vendosi detyrimin që në listën shumemërore të kandidateve/kandidatëve për deputete/deputetë të partive politike, për zgjedhjet për Kuvendin, asnjëra prej gjinive nuk mund të

përfaqësohej me më pak se 30%. Kjo do të garantohej nga përfshirja në listat shumemërore të kandidateve/kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për zgjedhjet për Kuvendin ,për çdo zonë zgjedhore, e kriterit të kuotës gjinore, sipas të cilit të paktën tridhjetë për qind dhe/ose një në tre emrat e parë duhet t'i përkasë secilës gjini. Me amendimet që iu bënë këtij Kodi në vitin 2015, u vendos kuota 50% burra dhe 50% gra në listat e kandidateve/kandidatëve për këshilltaret/këshilltarët në zgjedhjet vendore. Ndërsa me amendimet e vitit 2020, me **ligjin nr. 101/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,** u përfshi koncepti i "gjinisë së nënpërfaqësuar" (gjinia me tradicionalisht numrin më të vogël të anëtareve/anëtarëve në Kuvend ose, sipas rastit, në këshillat vendorë në rang vendi), si dhe u saktësuan përcaktimet mbi lirinë zgjedhore dhe barazinë gjinore në nenin 4 të këtij Kodi.

Ligji nr. 57/2016, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, përfshin për herë të parë konceptin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në menaxhimin e sistemit buxhetor, duke shtuar si parim të funksionimit të tij respektimin e barazisë gjinore, ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të së njëjtës natyrë. Ndërsa **ligji nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore",** ka krijuar mundësitë për përfshirjen e efektshme të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi). Ndër të tjera, ky ligj synon të sigurojë që nëpërmjet krijimit dhe shpërndarjes së burimeve financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore të përshpejtohet dhe të realizohet barazia gjinore.

Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 136/2015, ku theksohen ndër të tjera: trajtimi i punëmarrëseve/punëmarrësve pa diskriminim; marrja e masave të përkohshme dhe të veçanta nga punëdhënësi/punëdhënësja, të cilat synojnë përshpejtimin e vendosjes reale të barazisë në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi, për çdo shkak të përmendur në nenin 9 të Kodit të Punës, si dhe ndërprerja e kësaj mase sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit dhe të ofrimit të mundësive të barabarta; sigurimi nga punëdhënësi/punëdhënësja i përshtatjes së arsyeshme të vendit të punës për personat me aftësi të kufizuara ose persona të ndodhur në kushte të tjera; marrja e masave të nevojshme për të ndaluar ngacmimin moral të kryer prej punëdhënësit/ punëdhënëses dhe nga punonjëset/punonjësit e tjerë, si dhe afishimi i dispozitave mbi ngacmimin moral dhe seksual dhe sanksionet përkatëse; ndalimi i punëdhënësit/punëdhënëses të kryejë çdo veprim që përbën shqetësim seksual për punëmarrëset/ punëmarrësit dhe moslejimi nga ana e punëdhënësit/punëdhënëses kryerjen e veprimeve të tilla nga punëmarrëset/punëmarrësit e tjerë etj.

Ligji nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", përcakton të drejtat thelbësore që lidhen me përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, me qëllim garantimin e mundësive dhe kushteve të barabarta të tyre me të tjerët. Ndër parimet bazë të këtij ligji është dhe barazia gjinore, që siguron që gratë me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të barabarta, si burrat me aftësi të kufizuara për të përfituar të drejtat e garantuara nga ky ligj. Në aspektin institucional, ligji parashikon themelimin e Këshillit Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, si organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, të përbërë nga 17 anëtare/anëtarë të emëruar nga Kryeministri, duke i kushtuar vëmendjen e duhur gjithëpërfshirjes së kategorive të ndryshme, si aftësisë së kufizuar, moshës dhe gjinisë.

Ligji nr. 104/2014, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, e drejta e lejes për kujdesin ndaj fëmijës iu njoh edhe babait, pas periudhës prej 63 ditësh pas lindjes së fëmijës dhe, kur këtë të drejtë nuk e ushtron ose nuk ka kushte për ta përfituar nëna. Për gratë shtatzëna është shtuar periudha e ndalimit të punës pas lindjes nga 42 ditë (që ishte përpara miratimit të ndryshimit ligjor) në 63 ditë. Parashikime të tjera në këtë ligj janë bërë edhe për rikthimin e nënës në vendin e punës pas 63 ditëve me dëshirën e saj dhe përshtatjen e gjendjes së saj me kushtet e punës,

ushqimin me gji të fëmijës etj. Me VKM-në nr. 740, datë 12.12.2018, "Për përcaktimin e ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të porsalindura dhe procedurën për dhënien e tij", hyri në fuqi më 1 janar 2019 aplikimi i bonusit për nënat me foshnja të porsalindura, që varion nga 40,000 mijë lekë për fëmijën e parë në 80,000 lekë për fëmijën e dytë dhe 120,000 mijë lekë për fëmijën e tretë. Këtë bonus e përfitojnë edhe nënat që i lindin fëmijët e tyre jashtë vendit me kushtin që fëmija të regjistrohet sipas afateve ligjore.

Në mënyrë të veçantë për çështjet e dhunës në familje dhe të mosdiskriminimit përmendim:

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar. Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe të zvogëlojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të mbrojë viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përballueshme dhe të thjeshtë. Dy përmirësimet më të rëndësishme të këtij ligji datojnë në vitet 2018 dhe 2020. **Ligji 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare",** përmbushi rekomandimet e dhëna nga Komiteti CEDAW (2016) dhe nga GREVIO (2017). Nëpërmjet ndryshimeve të bëra, u forcuan masat mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtja e viktimave, përmes lëshimit të urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet. Gjithashtu, për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesa ose bashkëjetesa. Në detyrim të ligjit nr. 47/2018, janë miratuar katër udhëzime:

- Udhëzimi nr. 816, datë 27.11.2018, i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, "Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale";
- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Brendshëm nr. 912, datë 27.12.2018, "Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme";
- Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Brendshëm, "Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje";
- Udhëzim i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe i Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 9, datë 17.6.2020, "Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre".

Ndërsa, me ndryshimet e bëra nëpërmjet **ligjit nr. 125/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare"**, përcaktohen masat për largimin menjëherë të dhunuesit nga banesa nëpërmjet UMPMM-së nga Policia e Shtetit apo nëpërmjet UMM/UM të lëshuar nga Gjykata për atë afat kohor që përcaktohet në këto urdhra, programet specifike të rehabilitimit për dhunuesit, krijimi i regjistrit të UMM/UM-ve etj. Lidhur ngushtësisht me zbatimin e këtij ligji është edhe **vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 334, datë 17.2.2011, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij"**, i cili po rishikohet.

Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar. Sipas këtij ligji, askush nuk mund të diskriminohet, për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicionit gjenetik, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër. Edhe ky ligj është përmirësuar me **ligjin 124/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi"**, ku ndër të tjera saktësohet më tej objekti i këtij ligji, shtohen përkufizimet, duke theksuar gjuhën e urrejtjes, jepet përkufizim për format e rënda të diskriminimit etj.

Ligji nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ku në pikën 3 të nenit 6 parashikohet, se: "Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënëseve/ nxënësve dhe punonjëseve/ punonjë-sve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose

mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral".

Gjatë periudhës 2016–2020 janë miratuar apo përmirësuar edhe një sërë ligjesh të tjera, ku është theksuar parimi i barazisë gjinore apo mbrojtja nga dhuna dhe diskriminimi, siç mund të përmendim:

Ligji 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", ku parimi i mosdiskriminimit për një tërësi shkaqesh, duke filluar nga gjinia, renditet në parimet bazë për ofrimin e shërbimeve. Ligji, gjithashtu, parashikon ofrimin e shërbimeve të specializuara për gratë dhe vajzat e dhunuara apo të trafikuara, për gratë dhe vajzat shtatzëna ose prind i vetëm me fëmijë deri në 1 vjeç etj.

Ligji 65/2016, "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë", që ndër të tjera synon punësimin e personave të pafavorizuar në tregun e punës, si: personat që trajtohen me ndihmë ekonomike, personat me aftësi të kufizuara, jetimet/jetimët, gratë viktima të dhunës dhe trafikimit etj.

Ligji 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", që përmirëson qasjen e viktimave në informacion përmes vendosjes së një koordinatori/koordinatoreje për marrëdhëniet me publikun në secilën prokurori, përgjegjës/ përgjegjëse për informimin e viktimave.

Ligji 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", ku barazia dhe mosdiskriminimi përmenden që në parimet e përgjithshme të tij. Ligji përcakton, se çfarë do të thotë mbrojtje e fëmijës, duke qartësuar "masat e mbrojtjes", që mund të aplikojnë punonjësit/punonjëset, kur konstatojnë raste të fëmijëve në situatë të pasigurt, për shkak të dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Për herë të parë parashikohet mbrojtja e fëmijëve në situatë rruge apo që punojnë/ shfrytëzohen për punë, adresimi i formave të ndryshme të dhunës ndaj fëmijëve, si bulizmi, dhuna në shkolla, në familje, abuzimi seksual, shfrytëzimi ekonomik, siguria e fëmijëve në internet, fëmijët e pashoqëruar ose viktima të trafikimit etj.

Ligji 37/2017, "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur", që garanton një kornizë ligjore për drejtësinë penale për fëmijët, promovon riintegrimin e fëmijës në konflikt me ligjin, mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe parandalon riviktimizimin/viktimizimin dytësor të fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një vepre penale.

Ligji 111/2017, "**Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti**", që ndër të tjera garanton ndihmë juridike falas për kategori të veçanta: viktima të dhunës në familje, abuzimit seksual, trafikimit të qenieve njerëzore, të mitur/mitura në konflikt me ligjin, fëmijë në institucionet e përkujdesjes shoqërore, persona, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim etj.

Ligji 35/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale", i ndryshuar, ku parashikohen dispozita të reja ligjore, që përmirësojnë ndjeshëm pozitën e viktimës në çështjet penale, si dhe të drejta procedurale të posaçme për viktimën e mitur, të abuzuar seksualisht dhe viktimën e trafikimit të qenieve njerëzore.

Ligji 70/2017, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe të trafikimit nëpërmjet masave parandaluese ndaj pronës", ku parashikohet se dispozitat e tij zbatohen për pasuritë e personave që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, mbi të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm, për kryerjen e veprave penale lidhur me trafikimin e të rriturave/rriturve dhe të miturave/miturve. Ky ligj përcakton krijimin e një fondi të posaçëm për parandalimin e krimit të organizuar, për të cilin përdoren si burim pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara (me vendimin e Gjykatës). Fondi i veçantë është caktuar për qëllime sociale, duke përfshirë rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të trafikimit.

Ligji nr. 79/2017, "Për sportin", i ndryshuar ku pika 3 e nenit 5 të këtij ligji parashikon, se: "Ndalohet diskriminimi në veprimtaritë sportive, për shkaqe si: bindjet politike a fetare, raca, etnia, gjuha, gjinia, orientimi seksual, gjendja ekonomike ose shoqërore".

Ligji 22/2018, "Për strehimin social", ku theksohet parimi i mosdiskriminimit, për planifikimin, pajisjen, shpërndarjen dhe menaxhimin e strehimit për grupet sociale në nevojë për strehim. Nga programi i banesave të specializuara përfitojnë shtresat vulnerabël

përfshirë viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna.

Ligji 110/2018, "Për noterinë", që fuqizon pavarësinë ekonomike të gruas dhe është garant kryesor i të drejtave pronësore të saj, duke sjellë risi në çështjet e rregullimit të barazisë gjinore në aspektin e mbrojtjes së pasurive.

Ligji 111/2018, "Për kadastrën", që, gjithashtu, rregullon çështjet e barazisë gjinore, lidhur me regjistrimin e pasurisë së bashkësisë ligjore.

Ligji 15/2019, "Për nxitjen e punësimit", ku viktimat/viktimat e mundshme të trafikimit, dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje apo nënat nën moshën 18 vjeç, specifikohen te grupet e veçanta të punëkërkueseve/punëkërkuesve të disavantazhuar në tregun e punës, të cilat/cilët përfitojnë nga shërbimet dhe programet e nxitjes së punësimit.

Ligji 57/2019, "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë" ku përcaktohen si përfituese/përfitues të ndihmës ekonomike, ndër të tjera viktimat e trafikimit, pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre, si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore.

Ligji 34/2019, "Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara", ku theksohet miradministrimi dhe përdorimi eficient, efektiv dhe ekonomik i pasurive të sekuestruara e konfiskuara nga organet e drejtësisë dhe pasurive të sekuestruara me urdhër të ministrit përgjegjës për financat, rikthimi në komunitet i pasurive të fituara në mënyrë të paligjshme dhe kompensimi financiar i viktimave të krimit.

Ligji nr. 75/2019, "Për rininë", konkretisht pika 1 e nenit, 3 parashikon se: "Mbështetja dhe fuqizimi i të rejave/rinjve bazohet në parimet e mëposhtme: a) parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi; b) parimin e mundësive të barabarta dhe garantimit të pjesëmarrjes së të rejave/rinjve në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse në fushat e arsimit, kërkimit shkencor, politikave financiare, punësimit, vullnetarizmit, mbrojtjes e përfshirjes sociale, shëndetësisë, kulturës, sportit, mjedisit, turizmit, drejtësisë, punëve të brendshme e të jashtme, integrimit dhe të mbrojtjes, teknologjisë së informacionit, sipërmarrjes dhe në fusha të tjera që inkurajojnë zhvillimin e të rejave/rinjve; ... etj."

Ligji nr. 35/2020, "Për një ndryshim në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, 'Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë', i ndryshuar, që konsiston në kriminalizimin e dhunës psikologjike, mbrojtjen e personave në lidhje ose ish-lidhje intime me autorin e veprës penale etj., pra që harmonizon përmbajtjen e këtij neni me nenin 3 të Konventës së Stambollit dhe ndryshimet në ligjin për dhunën në familje. Gjithashtu, ligji parashikon ashpërsimin e dënimeve për disa figura të kësaj vepre penale. Ky ndryshim i Kodit Penal për çështje që lidhen me dhunën në familje është tepër i rëndësishëm dhe në vijim të të gjitha parashikimeve, si vepra penale për dhunën në familje dhe forma të tjera të dhunës ndaj grave, ndryshime këto të ndodhura në vitet 2012 dhe 2013.

Ligji 13/2020, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, 'Për të Huajt'", ku parashikohet mbrojtje më e mirë për viktimat e huaja të trafikimit etj.

2.2. Kuadri institucional.

Në Shqipëri ka disa struktura, të cilat trajtojnë çështjet e barazisë gjinore, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

Sipas ligjit nr. 9770, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri" dhe ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, autoriteti shtetëror përgjegjës për barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje është ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore.

Me organizimin e qeverisë së re në shtator 2017, bazuar në pikën "e" të VKM-së nr. 508, datë 13.9.2017, fusha e përgjegjësisë për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje iu ngarkua **Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** (MSHMS). Ministria e ushtron këtë funksion përmes rolit drejtues të Ministres në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe **Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore,** si

pjesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Sipas ligjit nr. 9770, datë 24.7.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", nenet 11 dhe 12, **Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore** (KKBGJ) është organi më i lartë këshillues për çështjet e barazisë gjinore dhe sigurimin e integrimit gjinor në të gjitha fushat, veçanërisht në çështjet politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Këshilli ngrihet me urdhër të Kryeministrit dhe rinovohet një herë në katër vjet. KKBGJ-ja drejtohet nga ministrja e MSHMS-së dhe në përbërje ka 9 përfaqësuese/përfaqësues të ministrive të linjës në rang zëvendësministreje/ zëvendësministri dhe drejtuesesh/drejtuesish të lartë, si dhe tre përfaqësuese/përfaqësues të shoqërisë civile, të cilat/cilët zgjidhen mbi bazën e një konkurrimi të hapur, duke pasur si kriter eksperiencën dhe kontributin për këto çështje.

Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor kanë detyrimin ligjor të bashkëpunojnë me ministren/ministrin përkatës, që mbulon çështjet e barazisë gjinore për të shkëmbyer informacion dhe për të lehtësuar përmbushjen e funksionit të saj/tij. Për këtë qëllim, **në çdo ministri** është caktuar një **nëpunëse/nëpunës i barazisë gjinore (NBGJ)** që ka për detyrë adresimin e çështjeve të barazisë gjinore dhe në **secilën bashki** emërohen një ose më shumë punonjëse/punonjës vendorë të barazisë gjinore.

Urdhri i Kryeministrit nr. 32, datë 12.2.2018, "Për përcaktimin e koordinatorit kombëtar për barazinë gjinore", ka përcaktuar zëvendës-kryeministrin koordinator kombëtar për barazinë gjinore, i cili autorizohet të fuqizojë mekanizmin për barazinë gjinore në nivel qendror dhe të ndërmarrë rol koordinues.

Në nivelin e Kuvendit të Shqipërisë, në datë 4 dhjetor 2017, u miratua rezoluta "Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj". Në zbatim të angazhimeve të marra në këtë rezolutë dhe bazuar në nenin 19 të Rregullores, me vendimin e Kuvendit nr. 113/2017, datë 4 dhjetor 2017, u miratua ngritja e ***nënkomisionit "Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas"***, pranë Komisionit të përhershëm për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Ky nënkomision në kuadrin e procesit të kontrollit parlamentar kërkon informacion të vazhdueshëm për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, raportim për situatën e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, shtrirjen dhe funksionimin e mekanizmave të Koordinuar të Referimit të rasteve të dhunës në familje (MKR-ve), raportim për çështje të diskriminimit ndaj grave, si dhe zhvillon seanca dëgjimore me grupet e interesit dhe institucionet.

Aleanca e Grave Deputete (AGD), e cila e ka fillesën e organizimit të saj në vitin 2013, është rezultati i një lëvizjeje lobingu të filluar nga gratë deputete, me synim nxitjen e barazisë gjinore në Parlament dhe avokimin për përfshirjen e perspektivës gjinore në ligje.

Aleanca Kombëtare e Këshilltareve (AKK) e krijuar fillimisht në vitin 2017 me mbështetjen e UN Women dhe e fuqizuar me pas në kuadër të projektit Bashki të Forta synon, gjithashtu, zbatimin e politikave mbrojtëse dhe gjithëpërfshirëse për gratë në nevojë, si dhe arritjen e barazisë gjinore në nivel vendor.

2.3. Lidhja e SKBGJ 2021–2030 me dokumentet strategjike

a) Lidhja me SKZHI-në

SKBGJ 2021–2030 lidhet dhe harmonizohet me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim II, më konkretisht me shtyllën 3 të kësaj strategjie: "Investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezionin social". Burimi më i rëndësishëm në Shqipëri janë burimet njerëzore, për rrjedhojë shoqëria dhe kultura e saj. Pikërisht në këto segmente të shtetit qëndrojnë të gjitha ato vlera themelore për lirinë, barazinë, mirëqenien dhe sigurinë e personit dhe pronës. Së bashku me sistemet e mirëqeverisjes, demokracisë dhe shtetit ligjor janë dimensionet njerëzore dhe sociale të Shqipërisë ato që qëndrojnë në themel të rritjes ekonomike. Në mënyrë më specifike SKBGJ 2021–2030 lidhet me pikën 11.8, "Garantimi i barazisë gjinore", të shtyllës 3 të SKZHI II.

b) Lidhja me Programin e Qeverisë

SKBGJ 2021–2030 lidhet me Programin Qeverisës 2017–2020[13], konkretisht me **prioritetin 3 "Shërbimet publike"** të këtij programi. Nën këtë prioritet, në mënyrë specifike SKBGJ 2021–2030 lidhet me fushat 3.1, "Shteti ligjor dhe

[13] https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2017/11/PROGRAMI.pdf

drejtësia"; 3.2, "Arsimi, rinia dhe sportet" dhe 3.3, "Shëndetësia dhe kujdesi social".

c) Lidhja me Planin Kombëtar të Integrimit Evropian (PKIE) dhe *Acquis* të BE-së

SKBGJ 2021–2030 lidhet me dy kapituj kryesorë të PKIE 2019-2021[14], konkretisht me ***kapitullin 19 "Politika sociale dhe punësimi"***, si dhe me ***kapitullin 23: "Drejtësia dhe të Drejtat Themelore"***. Acquis në fushën e politikës sociale përfshin standarde minimale në fusha si, ligji i punësimit, trajtimi i barabartë i grave dhe burrave në punësim dhe politika sociale, shëndeti dhe siguria nëpunë, mosdiskriminimi në punësim dhe politika sociale, gjithashtu në përfshirje sociale dhe mbrojtje. Mbrojtja e të drejtave themelore përfshin të drejtat tradicionale civile, si e drejta për jetë, e drejta për dinjitet dhe integritet, ndalimi i torturës dhe trajtimi degradues, e drejta për liri dhe siguri, e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, liria e feja, liria e fjalës, liria e asociimit dhe e kuvendit, liria e edukimit, e drejta e pronësisë etj.

d) Lidhja me Marrëveshjen *e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre anëtare* (MSA). SKBGJ 2021–2030 lidhet me MSA-në, konkretisht me nenin 99, "Bashkëpunimi social"[15]. Sipas këtij neni, palët bashkëpunojnë për të lehtësuar reformat e politikave shqiptare të punësimit, në kontekstin e forcimit të reformave ekonomike dhe të integrimit. Bashkëpunimi synon të mbështetë përshtatjen e sistemit shqiptar të sigurimeve shoqërore me kërkesat e reja ekonomike dhe sociale dhe përfshin përshtatjen e legjislacionit shqiptar për sa u përket kushteve të punës dhe mundësive të barabarta për gratë, ashtu si dhe përmirësimin e nivelit të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë në punë për punëtoret/punëtorët, duke iu referuar nivelit ekzistues të mbrojtjes në Komunitet. Bashkëpunimi merr parasysh fushat prioritare që lidhen me *acquis* e Komunitetit në këtë fushë.

e) Lidhja me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (OZHQ)

SKBGJ 2021–2030 ka një lidhje të ngushtë me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm[16]. Në mënyrë specifike, ajo lidhet me **OZHQ 5, "Barazia Gjinore" - Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.**

5.1 T'i jepet fund kudo të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe vajzave.

5.2 Të eliminohen të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe vajzave në sferën publike dhe private, përfshirë trafikimin dhe shfrytëzimin seksual dhe llojet e tjera të shfrytëzimit.

5.3 Të eliminohen të gjitha praktikat e dëmshme, siç janë martesat e fëmijëve, martesat në moshë të hershme, martesat e detyruara dhe gjymtimi gjenital femëror.

5.4 Të njihet dhe të vlerësohet kujdesi dhe puna shtëpiake pa pagesë, përmes dhënies së shërbimeve publike, infrastrukturës dhe politikave të mbrojtjes sociale dhe përkrahjes së përgjegjësive të përbashkëta brenda shtëpisë dhe familjes, në përputhje me praktikat kombëtare.

5.5 Të sigurohet pjesëmarrja e plotë dhe efektive e grave dhe dhënia e mundësive të barabarta për udhëheqjen e tyre në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në jetën politike, ekonomike dhe publike.

5.6 Të sigurohet qasja e gjithanshme në shëndetin seksual dhe atë riprodhues dhe në të drejtat riprodhuese, siç është rënë dakord, në përputhje me Programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe me Platformën për Veprim të Pekinit, si dhe dokumentet e tjera, rezultat i konferencave të zhvilluara.

5.a Të ndërmerren reforma për t'i dhënë grave të drejta të barabarta mbi burimet ekonomike, të drejta pronësie dhe kontrolli mbi tokën dhe forma të tjera të pronësisë, të shërbimeve financiare, të trashëgimisë dhe burimeve natyrore, në përputhje me ligjet kombëtare.

5.b Të përkrahet fuqizimi i grave, duke rritur përdorimin e teknologjisë, në veçanti teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit.

5.c Të miratohen dhe të forcohen politikat e shëndosha dhe legjislacioni i zbatueshëm në përkrahjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave në të gjitha nivelet.

Gjithashtu, SKBGJ 2021–2030 lidhet edhe me OZHQ 1, "Pa varfëri" - Eliminimi i të gjitha formave të varfërisë; OZHQ 2, "Zero uri" - Eliminimi i urisë, arritja e sigurisë ushqimore dhe e përmirësimit të ushqyerjes, si dhe nxitja e bujqësisë

[14] http://integrimi-ne-be.punetejashtme.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/PKIE-2019-2021.pdf

[15] http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/61-marreveshja-e-stabilizim-asociimit

[16] http://www.senior-a.al/docs/17SDGs_Shqip.pdf

së qëndrueshme; OZHQ 3, "Shëndet i mirë dhe mirëqenie" - Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe nxitja e mirëqenies për të gjithë njerëzit e çdo moshe; OZHQ 4, "Arsimi cilësor" - Sigurimi i arsimit cilësor, gjithëpërfshirës dhe të barabartë, si dhe mundësi për aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës; OZHQ 8, "Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike" - Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë; OZHQ 10, "Zvogëlimi i pabarazive" - Zvogëlimi i pabarazisë brenda çdo vendi dhe ndërmjet shteteve; OZHQ 11, "Qytete dhe komunitete të qëndrueshme" - Ndërtimi i qyteteve dhe i vendbanimeve gjithëpërfshirës, të parrezikshëm, rezistentë dhe të qëndrueshëm; OZHQ 13, "Veprim për klimën" - Marrja e masave urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe efektet e tyre; OZHQ 16, "Paqe, drejtësi, institucione të forta" - Promovimi i shoqërive në paqe dhe gjithëpërfshirëse për një zhvillim të qëndrueshëm, siguria e qasjes në drejtësi për të gjithë, dhe ndërtimi i institucioneve gjithëpërfshirëse, llogaridhënëse e efektive në të gjitha nivelet; si dhe OZHQ 17, "Partneritet për objektivat" - Fuqizimi i mjeteve të zbatimit dhe të rigjallërimit të partneritetit global për një zhvillim të qëndrueshëm.

f) Lidhja me Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020–2025 të Bashkimit Evropian dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021–2025.

SKBGJ 2021–2030 lidhet, gjithashtu, edhe me Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020–2025 të Bashkimit Evropian dhe bazohet veçanërisht në objektivat dhe masat e parashikuar në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III i BE) 2021–2025. Gjatë formulimit të planit të veprimit të SKBGJ 2021–2030 është synuar harmonizimi me GAP III të BE-së, sidomos në drejtim të qëllimeve strategjike, objektivave specifikë, si dhe treguesve të matjes së progresit. Tri parimet e para kryesore që udhëheqin "SKBGJ 2021–2030", konkretisht: i. përparimi drejt një qasjeje transformuese gjinore, ii. adresimi i ndërthurjes së diskriminimit gjinor me forma të tjera të diskriminimit, si dhe iii. ndjekja e një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut, janë parimet tek të cilat bazohet edhe GAP III i BE[17]. Në mënyrë të ngjashme, masat dhe veprimet e parashikuara nën katër qëllimet strategjike të SKBGJ 2021–2030 harmonizohen me fushat tematike të ndërhyrjes dhe objektivat specifikë të GAP III të BE. **Qëllimi strategjik I** i SKBGJ 2021–2030 përmban objektiva dhe masa të lidhura me fushat tematike të GAP III të BE-së, siç janë: "Promovimi i të drejtave ekonomike dhe sociale dhe fuqizimi i vajzave dhe i grave", si dhe "Adresimi i sfidave dhe shfrytëzimi i mundësive të ofruara nga tranzicioni drejt ekonomisë së gjelbër, transformimi digjital, ndryshimi i klimës dhe mjedisi". Më konkretisht, nën këtë qëllim strategjik janë planifikuar veprime që lidhen me: objektivin specifik tematik 1, "Rritja e aksesit për gratë nga të gjitha grupet, për punë të denjë në sektorët jotradicionalë, në veçanti shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë, si dhe në sektorët e dominuar nga gratë, përfshirë tranzicionin e grave drejt ekonomisë formale dhe mbulimin e tyre nga sistemet e mbrojtjes sociale jodiskriminuese dhe gjithëpërfshirëse"; objektivin specifik tematik 2, "Përmirësimi i politikave, kuadrit ligjor dhe aksesit në shërbimet e kujdesit shoqëror, duke mundësuar ndarjen e barabartë të punës dhe kujdesit familjar ndërmjet grave dhe burrave", objektivin specifik 3, "Përdorimi në mënyrë të barabartë i mjeteve digjitale publike nga gratë, burrat, vajzat dhe djemtë", objektivin specifik 4, "Pjesëmarrja plotësisht dhe në mënyrë të barabartë në ekonominë digjitale e grave, burrave, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet" etj. **Qëllimi strategjik II** i SKBGJ 2021–2030 përmban objektiva dhe masa të lidhura me fushën tematike të GAP III të BE "Nxitja e pjesëmarrjes dhe udhëheqjes së barabartë" dhe veçanërisht me objektivin specifik 1 "Krijimi i kushteve që mundësojnë pjesëmarrje të barabartë të grave, burrave, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet, në vendimmarrje". **Qëllimi strategjik III** i SKBGJ 2021–2030 është harmonizuar gjithashtu me fushat tematike të GAP III të BE "Sigurimi i lirisë nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore" si dhe me "Promovimi i shëndetit dhe të drejtave seksuale dhe riprodhuese". Në mënyrë të veçantë këtu mund të përmendim lidhjen me: objektivin specifik 1 "Mbrojtja më e mirë e grave,

[17] Shiko: https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/join-2020-17-final_en.pdf fq.4

burrave, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet, nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore në sferën publike dhe private, në vendin e punës dhe në internet, përmes legjislacionit dhe zbatimit efektiv të tij"; objektivin specifik 3, "Rritja e mbrojtjes dhe aksesit në shërbimet mbështetëse të specializuara për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë nga të gjitha grupet, të cilët përjetojnë dhunë seksuale dhe dhunë me bazë gjinore"; objektivin specifik 4 "Promovimi dhe mbrojtja më e mirë e të drejtave të çdo individi për të pasur kontroll të plotë dhe për të vendosur të lirë dhe me përgjegjësi për çështjet që lidhen me seksualitetin e tyre dhe shëndetin seksual e riprodhues, pa diskriminim, detyrim dhe dhunë"; objektivin specifik 8, "Mbledhja dhe përdorimi i të dhënave cilësore, të disagreguara dhe të krahasueshme globalisht për forma të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe praktikave të dëmshme, për të informuar ligjet, politikat dhe programet" etj. Ndërsa **Qëllimi strategjik IV** i SKBGJ 2021–2030 është kryesisht në përputhje dhe i harmonizuar me shtyllën 5 të Strategjisë së BE-së për Barazinë Gjinore 2020–2025, "Raportimi dhe komunikimi mbi rezultatet, duke vendosur një sistem monitorimi sasior, cilësor dhe gjithëpërfshirës për të rritur llogaridhënien publike, për të siguruar transparencën dhe qasjen në informacion dhe për të arritur shtrirje më të mirë të BE-së për ndikimin e punës së saj në të gjithë botën", por e përshtatur në nivel vendi.

3. Arritjet, analiza dhe sfidat.

Me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia midis grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Gratë dhe burrat, të rejat dhe të rinjtë, vajzat dhe djemtë nuk gëzojnë të drejta të njëjta në praktikë. Ende vazhdojnë të ekzistojnë pabarazitë shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore. Këto pabarazi janë rezultat i disa nocioneve shoqërore të ndërtuara mbi bazën e stereotipave të shumtë të pranishëm në familje, arsim, kulturë, mjetet e komunikimit, në botën e punës, në organizimin e shoqërisë etj.

Për adresimin e këtyre pabarazive në disa drejtime kryesore u përgatit dhe miratua në tetor të vitit 2016, "Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i saj i Veprimit 2016–2020"[18] (SKBGJ 2016–2020). Kjo strategji përmbante katër qëllime strategjike dhe trembëdhjetë objektiva specifikë.

Nga vlerësimi i realizuar mbi zbatimin e kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit, rezulton se SKBGJ 2016–2020 në tërësinë e saj është realizuar në masën 80%, duke evidentuar arritje të shumta në drejtim të fuqizimit të gruas, avancimit drejt barazisë gjinore dhe zvogëlimit të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Zbatimi i kësaj strategjie dhe masave të parashikuara në të ka një ndikim të rëndësishëm, gjithashtu, në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, sidomos të OZHQ 5, "Barazia gjinore". Më konkretisht:

Qëllimi strategjik 1: Fuqizimi ekonomik i grave dhe i burrave është realizuar në masën 74.7%. Nga vlerësimi u evidentua, se:

- Ka rritje të pjesëmarrjes së grave dhe të vajzave në tregun e punës;
- Ka rritje të aksesit të grave dhe burrave në programet e punësimit;
- Hendeku gjinor në paga, sipas të dhënave zyrtare është 10,1%. Pra burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 10,1% më të lartë se sa gratë. Krahasuar me vitin e mëparshëm, në vitin 2019 vihet re një ulje e hendekut gjinor në paga me 0,6 pikë përqindjeje.
- Ka vijuar zbatimi me efektivitet i objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit për Gratë Sipërmarrëse 2014–2020.
- Ka rritje të përfshirjes së vajzave e të rejave në fushat e studimit të lidhura me shkencën dhe inovacionin, por kjo rritje nuk duket të jetë konstante dhe e qëndrueshme për çdo vit akademik. Njëlloj dhe kur flitet për punësimin e grave në bujqësi dhe industritë nxjerrëse etj., ku përqindja e punësimit të tyre bie nga viti 2016 në vitin 2019.
- Evidentohet një reduktim me rreth 8% i punës së papaguar të grave, megjithatë ripërsëritja e Anketës së Studimit të Përdorimit të Kohës do të jepte të dhëna të sakta në këtë drejtim.
- Njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) janë përgjegjëse për përmbushjen e 41 funksioneve të grupuara në shtatë fusha, përfshi infrastrukturën

[18] Miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 733, datë 20.10.2016.

dhe shërbimet publike, shërbimet sociale, kulturën, sportin dhe argëtimin, mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin bujqësor e rural dhe pyjet, zhvillimin ekonomik vendor dhe sigurinë publike. Në planin e përgjithshëm, kënaqësia me shërbimet publike për vitin 2020, është vlerësuar "mirë". Qasja e barabartë gjinore në shërbime është treguesi me vlerësimin më të lartë, 98 pikë, ndjekur nga qasja në shërbimet bashkiake, me 75 pikë. Në rastin e qasjes në ofrimin e shërbimeve bashkiake shumica dërrmuese e bashkive (87%) janë vlerësuar me "mirë" ose "shumë mirë".

- Ka përmirësim në numrin e grave që përfitojnë nga shërbimet e ekstensionit dhe të subvencioneve.

- Ka përmirësim në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për gratë e zonave rurale, por ende nevojiten përpjekje për të përmirësuar dukshëm aksesin e tyre në këtë drejtim.

- Ka përmirësime ligjore, për të drejtat pronësore mbi tokën bujqësore, por duhet të monitorohet me kujdes zbatimi i tyre dhe ndikimi në praktikë.



Qëllimi strategjik 2: Garantimi i pjesëmarrjes dhe i angazhimit faktik dhe të barabartë të grave në vendimmarrjen politike e publike është realizuar në masën 75.57%.

Kështu, nga vlerësimi u evidentua, se:

- Ka zhvillime pozitive në drejtim të përfaqësimit të grave në vendimmarrjen politike, qendrore dhe vendore, zhvillime këto që duhet të jenë afatgjata dhe të qëndrueshme.



Qëllimi strategjik 3: Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe i dhunës në familje, është realizuar në masën 84.8%.

Të rëndësishme nën këtë qëllim strategjik:

- U arrit ngritja e mekanizmave të koordinuar të referimit (MKR) të rasteve të dhunës në familje në mbarë vendin (61 bashki), por nevojitet vijimi i mbështetjes për t'i bërë të gjitha këto MKR efektive dhe të qëndrueshme.

- Numri i shërbimeve mbështetëse të specializuara për trajtimin e viktimave/të të mbijetuarave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore është rritur. Megjithatë duhet të merret parasysh fakti që një pjesë e këtyre shërbimeve janë të varura nga donatorët dhe, ndërkohë kanë kufizime në burime njerëzore e financiare, infrastrukturë, aplikim në mënyrën e duhur të standardeve ndërkombëtare etj.
- Ende ka nevojë për përmirësime të legjislacionit në fushën penale.
- Ka rritje të përqindjes së dhunuesve të ndëshkuar e më pas të rehabilituar, por duhet të bëhet një vlerësim i plotë i shërbimit ekzistues, që të shërbejë si bazë krahasimore për shtrirje të mëtejshme të këtij shërbimi.



Qëllimi strategjik 4: Fuqizimi i rolit koordinues dhe monitorues të Mekanizmit Kombëtar të Barazisë Gjinore, si dhe ndërgjegjësimi i shoqërisë për avancimin e barazisë gjinore, është realizuar në masën 81.25%.

- MSHMS-ja, përveçse për shëndetësinë është përgjegjëse dhe për zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore, abuzimit ndaj fëmijëve, grave dhe grupeve të tjera, barazinë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, mosdiskriminimin, për shkak të orientimit seksual, aftësisë së kufizuar, etnicitetit dhe minoritetit etj. Këto përgjegjësi përmbushen nëpërmjet sektorit të politikave dhe strategjive për përfshirjen sociale dhe barazinë gjinore, brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
- Në nivelin qendror një specialiste/specialist me kohë të plotë, ka edhe përgjegjësinë dhe detyrimet e pozicionit të nëpunëses/nëpunësit të barazisë gjinore (NBGJ), pra këta persona kryejnë edhe detyra të tjera. Megjithatë në përshkrimet e tyre të punës janë shtuar detyrimet dhe përgjegjësitë e NBGJ-së, në përputhje me ligjin për barazinë gjinore. Përveç 11 NBGJ-ve në ministritë e linjës, edhe Policia e Shtetit dhe Avokati i Popullit kanë të caktuar nga një person kontakti në pozicionin e NBGJ-së (ndonëse nuk e kanë detyrim ligjor).
- 58 nga 61 bashki kanë përcjellë pranë MSHMS-së të dhënat mbi personin me kohë të plotë të caktuar për të mbuluar detyrat e NBGJ-së, por edhe të koordinatores/koordinatorit vendor kundër dhunës në familje (KVDHF) apo të specialistes/specialistit të mbrojtjes së fëmijëve. Tri bashki kanë tentuar t'i ndajnë këto pozicione, megjithatë momentalisht, në kushtet në të cilat ndodhet vendi dhe nisur edhe nga problematikat për sa u takon fondeve të NJVV-së, shihet si e pamundur ndarja e mëtejshme e këtyre pozicioneve.
- Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor (BPGJ) është pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020. BPGJ-së është përfshirë edhe në menaxhimin e sistemit buxhetor përmes ndryshimeve të ligjit përkatës (2016). Ligji për financat e vetëqeverisjes vendore (2017) ka krijuar mundësitë për përfshirjen e efektshme të BPGJ-së në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi) nga NJVV-ja. Në mënyrë të detyrueshme, NJVV-ve u ngarkohet që të paktën në një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojnë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit gjinorë. NJVV-të gjatë raportimit

duhet të përfshijnë detyrimisht si tregues financiar shpenzimet për politikat që mbështesin barazinë gjinore krahasuar me shpenzimet e përgjithshme. Aktualisht, në nivel qendror, për vitin 2020 rezultojnë 37 programe buxhetore që përfshijnë në mënyre efektive BPGJ-në.

- Bazuar në ndërhyrjet e vazhdueshme përmes aktiviteteve informuese e fushatave të ndërgjegjësimit, numri i individëve të shoqërisë sonë të cilët besojnë se barazia gjinore është kusht i domosdoshëm për zhvillimin e vendit është rritur, por nuk është realizuar një studim bazë dhe një krahasues mbarëkombëtar, që të përcaktojnë se sa % është rritur ky numër gjatë zbatimit të SKBGJ 2016–2020.

Qëllimi Strategjik 4



Disa nga sfidat kryesore të evidentuara gjatë vlerësimit të SKBGJ 2016–2020:

- Pamundësia e shtimit të specialisteve dhe specialistëve në një sërë institucionesh qendrore e vendore, në respektim të një tërësie ligjesh në fuqi. Këtu për shembull mund të veçojmë domosdoshmërinë e pasjes së punonjëseve e punonjësve të kualifikuar, me kohë të plotë e të dedikuar vetëm për një pozicion të caktuar pune. Në plotësim të detyrimit që rrjedh nga ligji për barazinë gjinore duhet të kemi të emëruar nëpunëse/nëpunës të barazisë gjinore me kohë të plotë e të dedikuar vetëm për zbatimin e këtij ligji apo të integrimit të perspektivës gjinore në të gjitha veprimet e politikat e institucioneve të caktuara, si në nivel qendror dhe në atë të vetëqeverisjes vendore. Ky detyrim u konstatua si një sfidë dhe nuk u realizua dot në mënyrën e duhur në këto katër vite. Në të gjitha ministritë e linjës dhe në bashkitë në vend ka punonjëse apo punonjës të kualifikuar e të punësuar me kohë të plotë, të cilat/cilët kanë këtë përgjegjësi por edhe përgjegjësi të tjera në përshkrimet e tyre të punës.

- Ngjashmërisht, plotësimi i detyrimit të njësive të vetëqeverisjes vendore për të emëruar punonjëse/punonjës me kohë të plotë në pozicionin vetëm të koordinatores/koordinatorit vendor kundër dhunës në familje, në zbatim të detyrimit që rrjedh nga legjislacioni në fuqi, mund të evidentohet si një tjetër sfidë e paadresuar në mënyrën e duhur, në këtë periudhë kohore.

- Plotësimi i strukturës në nivel qendror që është pjesë e mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore (referohu Sektorit të Politikave e Strategjive të Përfshirjes Sociale e Barazisë Gjinore) me specialiste/specialistë të dedikuar vetëm për çështjet e barazisë gjinore dhe të zvogëlimit të dhunës ndaj grave e dhunës në familje, si dhe shtimi i përvitshëm i burimeve financiare në dispozicion të këtij sektori, mund të renditet, gjithashtu, si një nga sfidat e paadresuara në mënyrën e duhur, gjatë këtyre katër viteve.

- Marrja e masave për shtimin e gamës së përfitueseve dhe përfituesve nga shërbimet mbështetëse të specializuara ekzistuese, si dhe shtimi i shërbimeve të reja në përputhje me nevojat dhe specifikat e grupeve të ndryshme të cenueshme, është gjithashtu një sfidë. Ngritja e një shërbimi është vetëm fillimi i ofrimit të mbështetjes së duhur. Që ky shërbim të jetë eficient dhe efektiv, duhet të mbështetet me burimet e duhura njerëzore e financiare, duhet të funksionojë në bazë të standardeve, protokolleve të dedikuara, duhet të respektojë diversitetin e individëve apo grupeve për

të cilat ngrihet, si dhe të vetë nevojave të ndryshme të tyre, duhet të monitorohet, vlerësohet e përmirësohet vazhdimisht, si dhe duhet të ketë mbështetje afatgjatë që të fitojë qëndrueshmëri. Marrja e eksperiencës së OJF-ve ofruese të shërbimeve të cilat kanë vite tashmë që ofrojnë shërbime të konsoliduara, është gjithashtu domosdoshmëri.

- Hapja e debateve publike dhe adresimi në formën e duhur i një sërë steriotipash gjinorë, praktikash të dëmshme patriarkale e formash të dhunës ndaj grave, është një tjetër sfidë, e cila nuk mund të kapërcehet pa një mirëkoordinimin veprimesh dhe dedikim të burimeve e mjeteve të duhura. Të ndryshosh mentalitetin dhe të përpiqesh të matësh progres në këtë drejtim, është e vështirë dhe rezultatet e punës shpesh janë të padukshme.

- Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe përafrimi i tij vazhdimisht me instrumentet ndërkombëtare është domosdoshmëri. Por mbi këto përpjekje, një sfidë e madhe mbetet zbatimi në realitet dhe gëzimi i këtyre të drejtave *de facto* nga të gjitha grupet e interesit. Niveli i angazhimit dhe i përgjegjshmërisë së institucioneve të caktuara, luan një rol tepër të madh në këtë drejtim.

- Mbledhja e të dhënave të disagreguara dhe analiza e situatës së grupeve të caktuara të grave e vajzave, në mënyrë sistematike, është një tjetër sfidë për vetë angazhimin dhe qëndrueshmërinë që kërkon ky proces nga një tërësi institucionesh.

- Adresimi i çështjeve të pronësisë mbi tokën apo të sigurimit të një game të gjerë shërbimesh për gratë, të rejat dhe vajzat në zonat rurale, mbetet gjithashtu një sfidë.

- Pozicionimi i duhur i grave, i të rejave dhe i vajzave në vendimmarrjen publike është një sfidë e cila del më në pah nëse flasim për adresimin e kësaj çështjeve në grupe apo komunitete të caktuara.

- Trajtimi në mënyrën e duhur, sipas standardeve e me shërbime të dedikuara për rastet e dhunës seksuale të ndeshur te të miturat/miturit apo të rriturat/rriturit, si në marrëdhëniet familjare edhe jashtë tyre, është gjithashtu një tjetër sfidë.

- Në matjen e impaktit të veprimeve të caktuara për adresimin e pabarazive apo diskriminimit gjinor, pasja e të dhënave sasiore e cilësore është tepër e nevojshme. Shpesh nevojitet realizimi i një studimi të parë (që shërben si studim bazë) dhe ripërsëritja e tij në mënyrë të vazhdueshme e periodike, duke ruajtur dhe përmirësuar parametra të caktuar. Vetë realizimi i studimeve të tilla të vazhdueshme përbën një sfidë, siç u pa dhe nga vlerësimi i zbatimit të SKBGJ 2016–2020 etj.

4. Vizioni dhe misioni i dokumentit

Vizioni

"Një shoqëri e cila vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të domosdoshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik e politik të vendit, fuqizon të gjithë individët për të gëzuar të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon që askush të mbetet pas, si dhe që mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe duke mbrojtur, rehabilituar e riintegruar personat e dhunuar".

Misioni

SKBGJ 2021–2030 ka një kohëzgjatje dhjetëvjeçare, brenda së cilës synohet të arrihet jo vetëm sukses por dhe qëndrueshmëri në veprimet e planifikuara e të realizuara. Në tërësinë e saj SKBGJ 2021–2030 përbëhet nga katër qëllime strategjike kryesore, ku zënë vend edhe objektiva specifikë që reflektojnë nevojën për ndryshim apo shtimin e dimensioneve të reja drejt të cilave duhet të fokusohet vëmendja për adresimin e duhur të çështjeve të barazisë gjinore, bazuar dhe në zhvillimet më të fundit, si dhe duke konsideruar çështje të lidhura me emergjencat civile, fatkeqësitë natyrore apo fushat e reja deri tani të paadresuara apo shumë pak të adresuara në lidhje me barazinë gjinore (mjedisi dhe ndryshimet klimatike, digjitalizimi, ekonomia e gjelbër etj.).

Parimet kryesore që udhëheqin SKBGJ 2021–2030 janë[19]:

- **Përparimi drejt një qasjeje transformuese gjinore**: ekzaminimi, gjetja e shkaqeve dhe ndryshimi i normave të ngurta gjinore e pabarazive të pushtetit që dëmtojnë gratë, të rejat dhe vajzat dhe gjenerojnë diskriminim në të gjitha moshat, duke filluar nga fëmijëria e hershme, në shoqëri; promovimi i ndryshimeve në qëndrimet shoqërore, përfshirë këtu angazhimin në mënyrë aktive të burrave, të rinjve dhe djemve, duke u përqendruar

[19] Tri parimet e para janë parimet tek të cilat bazohet edhe GAP III i BE-së (f. 4). https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/join-2020-17-final_en.pdf

tek të rejat/të rinjtë si nxitës të ndryshimit; të punuarit në një mënyrë që është e ndjeshme ndaj kontekstit, të krijuarit e partneriteteve të forta dhe dialogut me aktorët vendorë, shoqërinë civile dhe komunitetet vendore, duke mbështetur edhe organizatat e grave.

- **Adresimi i ndërthurjes së diskriminimit gjinor me forma të tjera të diskriminimit:** fokusi duhet të jetë, gjithashtu, te gratë, të rejat dhe vajzat më të pafavorizuara, për shembull gra, të reja dhe vajza rome dhe egjiptiane, gra, të reja dhe vajza me aftësi të kufizuara, gra, të reja dhe vajza të privuara ekonomikisht dhe shoqërisht, gra, të reja dhe vajza që jetojnë në fshat, gra, të reja dhe vajza të dhunuara apo trafikuara, nëna të vetme, gra, të reja dhe vajza migrante dhe azilkërkuese, gra, të reja dhe vajza LBTI+, gra të moshuara etj., pasi ato përballen me diskriminim të shumëfishtë.

- **Ndjekja e një qasjeje të bazuar në të drejtat e njeriut**: e cila vendos parimet e mosdiskriminimit dhe të kundërveprimit për pabarazitë në qendër të të gjitha veprimeve. Kjo përfshin ndihmën për çdo qenie njerëzore për të ushtruar të drejtat e tyre njerëzore, për të marrë pjesë në vendimet që kanë të bëjnë me to dhe për të kërkuar dëmshpërblim kur u shkelen të drejtat.

- **Barazia dhe drejtësia gjinore, kushte për një shoqëri të drejtë e socio-ekonomikisht të zhvilluar**: njohja dhe respektimi i barazisë dhe drejtësisë gjinore; përmirësimi i statusit social, ekonomik dhe shëndetësor i vajzave/të rejave/grave dhe sidomos i vajzave/të rejave/grave të cilat pësojnë diskriminim të shumëfishtë; edukimi, përparimi dhe angazhimi politik i tyre, duke u ofruar mundësi të barabarta njëlloj si dhe djemve/të rinjve/burrave, nga të gjitha grupet etnike e shoqërore, janë parakushte për zhvillimin e gjithanshëm të vendit.

- **Ndjeshmëri dhe trajtim i barabartë ndaj nevojave të veçanta të të dyja gjinive:** vajzat/ të rejat/gratë dhe djemtë/të rinjtë/burrat kanë nevoja të ndryshme dhe përballen me forma të ndryshme të dhunës e diskriminimit. Prandaj dhe veprimet e parashikuara duhet të ofrojnë mundësi për trajtimin në përshtatje me këto nevoja dhe përvoja – barazia nuk duhet ngatërruar me njëtrajtshmërinë: jemi të ndryshëm, por duhet të jemi të barabartë, jo të ngjashëm.

- **Njohja, vlerësimi dhe respektimi i diversitetit**: ndërmjet vajzave, të rejave dhe grave, djemve, të rinjve dhe burrave, për sa i përket moshës, aftësisë, orientimit seksual, shprehjes së identitetit gjinor, origjinës etnike dhe shoqërore, praktikave fetare dhe zgjedhjeve jetësore etj.

- **Tolerancë zero kundrejt dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje**: mbrojtja e jetës, dinjitetit dhe integritetit njerëzor është parakusht për zhvillimin e një vendi; çdo formë dhune është sulm mbi dinjitetin njerëzor dhe shkelje e të drejtave të njeriut, ndaj nuk duhet të tolerohet.

- **Koordinimi dhe bashkëpunimi ndërinstitucional**: nisur nga karakteristikat dhe natyra ndërsektoriale e çështjeve që përbëjnë qëllimet kryesore të kësaj strategjie, institucionet shtetërore, organizatat e shoqërisë civile, media, sektori privat, institucionet fetare, organizatat ndërkombëtare, si dhe të gjithë aktorët dhe partnerët e interesuar, duhet të punojnë së bashku duke koordinuar veprimet për të adresuar sa më efektivisht pabarazitë dhe padrejtësitë me bazë gjinore për gratë/të rejat/vajzat dhe burrat/të rinjtë/djemtë.

- **Matja e përparimit dhe buxhetimi për zbatimin e strategjisë dhe të planit të saj të veprimit**: si në çdo dokument politik të hartuar, në SKBGJ 2021–2030 nuk mund të mungojnë treguesit të cilët janë të formuluar qartësisht, të matshëm, me gjuhë të kuptueshme, si dhe që shërbejnë për matjen e përparimit gjatë periudhave kohore të zbatimit të strategjisë. Po kështu, që gjatë hartimit të strategjisë u bë dhe një parashikim buxhetor ku u përllogaritën kostot e domosdoshme për zbatimin e saj, të ndara në periudha të caktuara, e sipas llojit (kosto korrente apo investime), ku u evidentuan edhe ato masa apo aktivitete të cilat nuk mund të mbulohen nga buxheti i shtetit dhe që kanë nevojë për mbulim të plotë apo bashkëfinancim nga donatorët. Garantimi i buxhetimit dhe alokimit të përvitshëm të fondeve bazuar në kostimin që përmban dokumenti, është një prej treguesve kryesorë të përparimit dhe të rritjes së përgjegjshmërisë institucionale në nivel qendror e të vetëqeverisjes vendore, që çon padyshim drejt arritjes së rezultateve të dëshiruara.

5. Metodologjia

Siç është shpjeguar në nënkapitullin 2, kuadri ligjor dhe institucional në fuqi që udhëheq përgatitjen e këtij dokumenti, përputhet plotësisht me dokumentet strategjike në nivel ndërkombëtar e kombëtar të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, për rrjedhojë edhe vizioni, qëllimet strategjike dhe objektivat specifikë të parashikuar në SKBGJ 2021–2030 përputhen plotësisht me këta dokumente strategjike.

Nisma për hartimin e këtij dokumenti strategjik u ndërmor nga autoriteti shtetëror kryesor përgjegjës në nivel qendror, pra Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila punoi ngushtësisht me Grupin Ndërinstitucional të Punës (GNP) të përbërë nga përfaqësuese dhe përfaqësues të ministrive kryesore të linjës. Mbështetja dhe orientimi bazuar te raporti i vlerësimit të zbatimit të SKBGJ 2016–2020 ka qenë tepër ndihmuese. Gjithashtu, vlen të përmendet dhe mbështetja e veçantë e ofruar nga UN Women Shqipëri përmes një grupi ekspertesh[20], të cilat lehtësuan punën e GNP-së në përgatitjen e këtij dokumenti strategjik, që nga momenti i hartimit deri te kostimi dhe përgatitja e pasaportave të treguesve.

Gjatë punës për përgatitjen e dokumentit janë realizuar një sërë konsultimesh me aktorë dhe bashkëpunëtorë të rëndësishëm në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore (kryesisht me nëpunëset/nëpunësit e barazisë gjinore në nivel qendror dhe të vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, Aleancën Kombëtare të Këshilltarëve, Grupin Koordinues Gjinor të Partnerëve për Zhvillim, Grupin Tematik Ndërinstitucional të Përfshirjes dhe Mbrojtjes Sociale, Këshillin Konsultativ Qeveri Qendrore–Vetëqeverisje Vendore, si dhe me komunitetin e organizatave ndërkombëtare të cilat kanë në fokus çështjet e barazisë gjinore, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje).

Gjithashtu, ky dokument është publikuar për konsultim publik në datën **23 mars 2021** në adresën: https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/347 .

[20] Grupi i eksperteve përmes të cilave UN Women i ofroi mbështetje dhe asistencë teknike MSHMS gjatë gjithë procesit të hartimit të SKBGJ 2021–2030 përbëhej nga: Monika Kocaqi, Rajmonda Duka, Ani Plaku dhe Blerina Xhani.

PJESA II
QËLLIMI I POLITIKAVE, OBJEKTIVAT SPECIFIKË DHE MASAT PRIORITARE TË ZBATIMIT TË STRATEGJISË

Shënim i rëndësishëm: përgjatë leximit të tekstit të këtij dokumenti strategjik këtu e në vijim, përfshirë dhe në matricën e planit të veprimit, tërheqim vëmendjen që me termin "**nga të gjitha grupet**" nënkuptohet: nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj. Kjo nënkupton që kudo në tekst, në formulimin e qëllimeve strategjike, objektivave specifikë, veprimeve, aktiviteteve dhe treguesve ku mund të hasni me formulimin "**nga të gjitha grupet**", do të mbahet në konsideratë që aktiviteti, veprimi, treguesi, objektivi apo qëllimi synojnë të shtrihen dhe të mbulojnë individët e të gjitha grupeve të sipërcituara.

SKBGJ 2021–2030 përbëhet nga katër qëllime strategjike:

I. Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet, duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.

II. Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.

III. Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

IV. Aplikimi i integrimit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri.

Arritja e këtyre qëllimeve kërkon përpjekje të gjithanshme nga të gjitha ministritë, institucionet qendrore e vendore, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, organizatat ndërkombëtare, medias, akademisë, si dhe të të gjithë aktorëve të

tjerë që zbatojnë politika të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në fuqizimin e grave, të rejave dhe vajzave, arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore dhe zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Një nevojë e domosdoshme dhe e vazhdueshme është gjetja e mekanizmave të duhur dhe të përshtatshëm që sigurojnë një bashkëpunim të fortë dhe efektiv ndërinstitucional, si në drejtimin horizontal ashtu dhe atë vertikal.

Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, kanë gjithashtu rëndësi themelore, pasi ato mund të ndikojnë ndjeshëm në ndërgjegjësimin rreth barazisë gjinore, drejtësisë gjinore, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si dhe ofrimin e ekspertizës për zhvillimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara në mbrojtje, trajtim, rehabilitim e riintegrim të viktimave/të mbijetuarave, apo dhe programeve të rehabilitimit të dhunuesve.

Politika I

Qëllimi strategjik I - Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet, duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.

I bazuar në qëllimin strategjik të SKBGJ 2016–2020, "Fuqizimi ekonomik i grave dhe i burrave", ky qëllim strategjik është zgjeruar më tej, duke synuar jo vetëm fuqizimin socioekonomik të grave, të të rejave e të vajzave nga të gjitha grupet (pra, nga zonat rurale, nga minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit etj.), por edhe avancimin drejt ekonomisë mjedisore dhe digjitalizimit.

Treguesit kryesorë të impaktit nën këtë qëllim strategjik janë:

- Shkalla e punësimit sipas gjinisë;
- Punësimi joformal si një përqindje e totalit të punësimit jobujqësor, sipas gjinisë (OZHQ 8.3.1);
- Numri mesatar i orëve të shpenzuara në punët shtëpiake dhe kujdesin shtëpiak sipas gjinisë (OZHQ 5.4.1).

Për arritjen e këtij qëllimi strategjik, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifikë:

Objektivi specifik I.1	Zbatimi i kuadrit ligjor dhe i politikave të përmirësuara, që mundësojnë ndarje të barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.
Objektivi specifik I.2	Rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe tëvajzave, nga të gjitha grupet (në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet produktive.
Objektivi specifik I.3	Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, për punë të denjë edhe në sektorët jotradicionalë të punësimit (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë).

Përmbushja e këtyre objektivave do të sjellë një rritje të dukshme të informacionit e për rrjedhojë të kërkesës për zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi, në lidhje me të gjitha parashikimet që ndikojnë në balancimin dhe ndarjen e punëve të papaguara të përkujdesjes në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave e të rinjve, vajzave dhe djemve. Gjithashtu, do të krijojë mundësinë që edhe vetë burrat, duke u angazhuar më shumë në rritjen dhe edukimin e fëmijëve të tyre, të fillojnë të sjellin modele pozitive të prindërimit të mirë. Fuqizimi ekonomik i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet, mbetet një ndër aspektet kyçe, për arritjen e të cilit janë parashikuar një tërësi masash e aktivitetesh nën objektivin specifik përkatës. Synimi është që të mundësohet avancimi drejt ekonomisë mjedisore e digjitalizimit. Padyshim zvogëlimi i barrierave të grave, të rejave e vajzave në lidhje me tregun e punës, është një tjetër aspekt kyç që çon në fuqizimin ekonomik të tyre dhe orientimi drejt profesioneve dikur të konsideruara si "mashkullore" do të ndihmojë në thyerjen e një sërë tabush, si dhe në dhënien e mundësive të tjera për gratë, të rejat dhe vajzat. Mbështetja e sipërmarrjes së grave, të të rejave dhe të vajzave

dhe krijimi i lehtësirave fiskale do të jenë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim.

Kështu, më konkretisht, nën **objektivin specifik I.1**, **"Zbatimi i kuadrit ligjor dhe i politikave të përmirësuara, që mundësojnë ndarje të barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve",** janë parashikuar:

Rezultatet e arritshme:

i. Kuadri ligjor dhe i politikave që lejon marrjen e lejes së paguar të lindjes së fëmijës, lejes prindërore dhe lejes së përkujdesjes ndaj fëmijës, nga të dy prindërit, i njohur dhe i zbatueshëm në institucionet shtetërore dhe ato private.

ii. Politika të përmirësuara, që mundësojnë zbatimin e së drejtës për marrjen e lejeve të paguara nga secili prind, sipas legjislacionit në fuqi, pavarësisht situatave të emergjencave civile e fatkeqësive natyrore.

iii. Punëdhënëse dhe punëdhënës publikë e privatë që nxitin balancimin e angazhimit të të dy prindërve në punën dhe kujdesin e papaguar në familje, duke aplikuar rregullisht dhënien e lejeve të paguara të lejueshme për secilin prind në legjislacionin shqiptar, përfshirë dhe në situata të emergjencave civile e fatkeqësive natyrore.

Treguesit:

I.1.a) Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi legjislacionin në fuqi në lidhje me format e lejeve të paguara të lejueshme për secilin prind në legjislacionin shqiptar.

I.1.b) Numri i prindërve që aplikojnë dhe përfitojnë marrjen e secilës formë të lejes së paguar, në vit, i disagreguar sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, aftësisë së kufizuar etj. dhe sipas institucioneve apo bizneseve që e mundësojnë dhënien e saj.

Masat:

I.1.1 Informimi i punëdhënëseve/ punëdhënësve publikë e privatë, punëmarrëseve/ punëmarrësve dhe shoqërisë në tërësi, mbi format e lejeve të paguara, të lejueshme për secilin prind në legjislacionin shqiptar.

I.1.2 Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe i politikave që mundësojnë ndarje të barabartë të punës dhe të kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve (si: fleksibiliteti i të punuarit nga shtëpia, zgjatja e kohës së lejeve të paguara për të dy prindërit), bazuar në modele të suksesshme ndërkombëtare.

I.1.3 Monitorimi i zbatimit të kuadrit ligjor dhe i politikave, që mundësojnë ndarje të barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.

Nën **objektivin specifik I.2, "Rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave, nga të gjitha grupet në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet produktive",** janë parashikuar:

Rezultatet e arritshme:

i. Kuadri ligjor dhe i politikave që garanton gëzimin e së drejtës së pronësisë për gratë, të rejat dhe vajzat nga të gjitha grupet, përfshirë dhe pronësinë mbi tokën bujqësore, i njohur, zbatuar dhe monitoruar.

ii. Praktika të përmirësuara që mundësojnë fuqizimin ekonomik të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, nëpërmjet krijimit të lehtësirave fiskale dhe mbështetjes ekonomike me grante, që synojnë orientimin drejt ekonomisë mjedisore (të gjelbër) dhe digjitalizimit.

Treguesit:

I.2.a) Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese në zonat rurale dhe urbane mbi legjislacionin e përmirësuar, në lidhje me të drejtat pronësore të grave, të të rejave dhe të vajzave, me fokus të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore.

I.2.b) Përqindja e grave, e të rejave dhe e vajzave, të cilat gëzojnë pronësinë, si dhe kanë akses e kontroll mbi tokën bujqësore.

I.2.c) Numri i praktikave të miratuara për krijimin e lehtësirave fiskale dhe mbështetjes së grave, të të rejave dhe të vajzave për fillimin e bizneseve të tyre fokusuar tek ekonomia mjedisore dhe digjitalizimi, në nivel qendror e vendor.

I.2.d) Numri i grave, i të rejave dhe i vajzave të subvencionuara për të filluar bizneset e tyre lidhur me ekonominë mjedisore dhe digjitalizimin, disagreguar sipas moshës, vendbanimit, etnisë etj.

Masat:

I.2.1 Informimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet, mbi legjislacionin e përmirësuar në lidhje me të drejtat pronësore të tyre, me fokus të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore, si dhe fuqizimi i kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve për të mundësuar ushtrimin e këtyre të drejtave.

I.2.2 Nxitja dhe mbështetja e sipërmarrjes së grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit etj.), përfshirë dhe idetë inovatore që synojnë drejt ekonomisë mjedisore dhe digjitalizimit.

I.2.3 Fuqizimi i kapaciteteve të shërbimeve këshilluese në nivel vendor dhe institucioneve përgjegjëse në nivel qendror, për ofrimin e shërbimeve të përgjigjshme gjinore për turizmin rural, agrobiznesin dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerës.

I.2.4 Ndërtimi i kapaciteteve të grupeve të grave, të të rejave dhe të vajzave rurale për zhvillimin e aftësive të biznesit, qasjen në financim, si dhe veprime specifike të përbashkëta (siç janë blerja, kontrolli i cilësisë, tregtimi, marka, përpunimi dhe ruajtja e ushqimit).

Nën **objektivin specifik I.3** "**Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, për punë të denjë edhe në sektorët jotradicionalë të punësimit, (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë)",** janë parashikuar:

Rezultatet e arritshme:

i. Programet e nxitjes së punësimit të zbatuara me efektivitet në të gjithë vendin, duke u dhënë prioritet grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet, sidomos nga grupet që pësojnë diskriminim të shumëfishtë, dhunë me bazë gjinore, dhunë në familje apo praktika të dëmshme.

ii. Numri i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet, të cilat punojnë në sektorë jo tradicionalë, apo studiojnë në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë, i rritur në mënyrë të përvitshme.

iii. Konventa e ILO C190 mbi "Eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës" e njohur dhe e zbatueshme në Shqipëri.

iv. Integrimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet, në tregun e punës në nivel vendor i përmirësuar ndjeshëm si rrjedhojë e aplikimit të skemave të mbështetjes financiare të mbrojtjes sociale.

Treguesit:

I.3.a) Përqindja e punëkërkueseve të papuna, të punësuara nëpërmjet ndërmjetësimeve të zyrave të punësimit ndaj totalit të punëkërkuesve të papunë të punësuar nga këto zyra punësimi, në shkallë vendi, disagreguar sipas moshës, grupeve të caktuara.

I.3.b) Përqindja e grave, e të rejave dhe e vajzave nga të gjitha grupet, të punësuara në sektorë jo-tradicionalë (prodhim, ndërtim, industri nxjerrëse, energji, gaz dhe furnizimi me ujë).

I.3.c) Numri i vajzave dhe të rejave nga të gjitha grupet, të cilat studiojnë në Biologji, Biokimi, Mjediset natyrore dhe kafshët e egra, Kimi, Fizikë, Matematikë, Përdorim kompjuteri, Databazë dhe disenjim rrjeti dhe administrim, Zhvillimi i *Software*-eve dhe aplikacioneve dhe analiza, inxhinieri kimike dhe proceset, elektriciteti dhe energjia, elektronikë dhe automatizim, mekanikë dhe tregtimi i metaleve, automjetet motorike, anijet dhe avionët, minierat dhe nxjerrja, arkitektura dhe planifikimi i qytetit, ndërtimi dhe inxhinieria civile, peshkim, veterinari, terapia dhe rehabilitimi dhe farmaci, në raport me totalin e vajzave që janë studente.

I.3.d) Numri i të punësuarave/punësuarve nga të gjitha grupet, që denoncojnë dhunë apo ngacmim në vendin e punës, disagreguar sipas gjinisë, moshës dhe shumë faktorëve të tjerë individualë, si dhe sipas sektorit të punësimit.

I.3.e) Numri i bashkive që shtojnë shërbimet sociale përmes mbështetjes nga fondi social.

Masat:

I.3.1. Krijimi i mjedisit lehtësues dhe nxitës për përfshirjen e grave, e të rejave dhe e vajzave nga të gjitha grupet, në punë të denjë edhe në sektorët jotradicionalë, në përputhje dhe me veprimet e parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022.

I.3.2. Zbatimi i Konventës C190 të ONP mbi "Eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës", pas ratifikimit të saj, si dhe i direktivave përkatëse të BE-së për barazinë dhe mosdiskriminimin në botën e punës.

I.3.3. Mbulimi më i mirë me shërbime sociale, nëpërmjet Fondit Social, për të lehtësuar integrimin e grave, e të rejave dhe e vajzave nga të gjitha grupet, në vendin e punës.

I.3.4. Përmirësimi i aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave rurale në tregun e punës përmes financimit të ndërmarrjeve sociale.

Politika II

Qëllimi strategjik II - Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.

Bazuar në gjetjet nga vlerësimi i SKBGJ 2016–2020, në lidhje me përmbushjen e qëllimit strategjik 2 të saj "Garantimi i pjesëmarrjes dhe angazhimit faktik dhe të barabartë të grave në vendimmarrjen politike e publike", në këtë strategji është vënë theksi kryesisht në vendimmarrjen në nivel vendor.

Si strategji me kohëzgjatje dhjetëvjeçare, përmbushja e objektivave specifikë të parashikuar nën këtë qëllim strategjik, fare mirë ua lë vendin objektivave të tjerë që mund të planifikohen mbi vendimmarrjen, në varësi të ecurisë dhe arritjeve në zbatimin e strategjisë në tërësi.

Treguesi kryesor i impaktit nën këtë qëllim strategjik është:

- Përqindja e vendeve të mbajtura nga gratë, në: a) parlamentin kombëtar; dhe b) në vetëqeverisjen vendore (SDG 5.5.1).

Për arritjen e këtij qëllimi strategjik, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifikë:

Objektivi specifik II.1:	Krijimi i kushteve që mundësojnë pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë të grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, në vendimmarrjen politike e publike, në nivel vendor.
Objektivi specifik II.2:	Përforcimi i qëndrimeve dhe i sjelljeve shoqërore që nxisin pjesëmarrjen, përfaqësimin dhe udhëheqjen e barabartë të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, në vendimmarrjen në nivel vendor.

Përmbushja e këtyre objektivave specifikë do të rezultojë në respektimin e kuotave të barazisë gjinore që, për rrjedhojë, sjellin rritjen e pjesëmarrjes e përfaqësimit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet në vendimmarrjen politike dhe publike në nivel vendor, si dhe krijimin e një shoqërie të hapur ndaj modeleve pozitive të grave, të të rejave dhe të vajzave që përfshihen, përfaqësohen dhe udhëheqin në mënyrë të barabartë me burrat, të rinjtë dhe djemtë, apo dhe në çështje të lidhura me vendimmarrjen politike e publike, kryesisht në nivel vendor.

Kështu më konkretisht, nën **objektivin specifik II.1**, "**Krijimi i kushteve që mundësojnë pjesëmarrje dhe përfshirje të barabartë të grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, në vendimmarrjen politike e publike, në nivel vendor",** janë parashikuar:

Rezultat i arritshëm:

i. Kuota të respektuara të barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes e përfaqësimit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, në postet politike dhe publike vendore.

Tregues:

II.1.a) Përqindja e grave, e të rejave dhe e vajzave nga të gjitha grupet, e përfshirë dhe përfaqësuar në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.

Masat:

II.1.1. Zbatimi i kuadrit ligjor që mundëson pjesëmarrjen dhe përfshirjen e barabartë të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.

II.1.2. Studimi dhe monitorimi i fenomenit të dhunës ndaj grave, të rejave e vajzave në zgjedhje dhe politikë në nivelin vendor.

II.1.3. Përmirësimi i kuadrit ligjor për adresimin në mënyrën e duhur të seksizimit dhe dhunës ndaj grave, të rejave dhe vajzave në zgjedhje dhe politikë.

II.1.4. Fuqizimi i kapaciteteve të Aleancave të Grave Këshilltare dhe Komisioneve të Barazisë Gjinore për të zbatuar iniciativa që zvogëlojnë seksizmin dhe dhunën ndaj grave, të rejave dhe vajzave në politikë dhe gjatë proceseve zgjedhore, në bashkëpunim dhe me mbështetjen edhe të Aleancës së Grave Deputete.

II.1.5. Fuqizimi i kapaciteteve të medies, për të paraqitur modele pozitive të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, lidere në politikë dhe vendimmarrjen publike vendore.

Nën **objektivin specifik II.2,** "**Përforcimi i qëndrimeve dhe i sjelljeve shoqërore që nxisin pjesëmarrjen, përfaqësimin dhe udhëheqjen e**

barabartë të grave dhe të burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor", janë parashikuar:

Rezultat i arritshëm:

i. Shoqëri e hapur ndaj modeleve pozitive të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, të cilat përfshihen, përfaqësohen dhe udhëheqin në mënyrë të barabartë çështje të lidhura me vendimmarrjen politike e publike vendore.

Tregues:

II.2.a) Përqindja e popullsisë që mbështet modelet e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të barabartë të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, në vendimmarrjen politike e publike vendore.

Masa:

II.2.1. Krijimi i mjedisit lehtësues për pranimin e modeleve të pjesëmarrjes dhe të përfaqësimit të barabartë të grave dhe të burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.

Politika III

Qëllimi strategjik III - Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Edhe për përmbushjen e këtij qëllimi strategjik janë parashikuar objektiva specifikë të bazuar në SKBGJ 2016–2020, duke shtuar dhe theksuar domosdoshmërinë e ndëshkimit dhe rehabilitimit të dhunuesve, shtimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbështetjen e të mbijetuarave deri në riintegrimin e tyre, ndërgjegjësimin e shoqërisë për të mos e toleruar dhunën ndaj grave e dhunën në familje etj.

Treguesit e impaktit në këtë qëllim strategjik janë:

- Përqindja e grave, e të rejave dhe e vajzave të moshës 15+ nënshtruar dhunës fizike, seksuale ose psikologjike nga partneri aktual ose ish-partneri intim të 12 muajve të mëparshëm (OZHQ 5.2.1).
- Përqindja e të rejave të moshës 20–24 vjeç të cilat janë martuar ose hyjnë në një marrëdhënie bashkëjetese para moshës 18 vjeç (OZHQ 5.3.1).

Për arritjen e këtij qëllimi strategjik, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifikë:

Objektivi specifik III.1:	Mbrojtja më e mirë e grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, nga të gjitha format e praktikave të dëmshme, seksizmit, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes përmirësimit të legjislacionit, zbatimit efektiv të tij, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për personat e dhunuar, ndëshkimin e dhunuesve dhe vënien në funksionim të programeve rehabilituese.
Objektivi specifik III.2:	Rritja e aksesit në shërbimet mbështetëse të specializuara për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë nga të gjitha grupet, të cilët përjetojnë praktika të dëmshme, dhunë seksuale dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si në situata normale ashtu dhe në situata të krizave humanitare e gjendjeve të fatkeqësive natyrore.
Objektivi specifik III.3:	Përmirësimi i qasjes në drejtësi të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, për të mbrojtur të drejtat e tyre.
Objektivi specifik III.4:	Përgatitja e një brezi të ri të barazisë ku gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë nga të gjitha grupet, janë agjentë të ndryshimit, në lidhje me normat diskriminuese shoqërore, steriotipat gjinorë dhe parandalimin e luftimin e seksizmit.
Objektivi specifik III.5:	Fuqizimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet, për të pasur kontroll të plotë, për të vendosur lirshëm dhe me përgjegjësi për çështjet që lidhen me shëndetin seksual e riprodhues.

Zbatimi i kuadrit ligjor si dhe përmirësimi i disa aspekteve të tjera të tij në përputhje dhe me rekomandimet e dhëna nga institucionet ndërkombëtare, do t'u hapë rrugën një tërësie veprimesh të tjera të planifikuara, për të mundësuar arritjen e rezultateve të dëshiruara, të cilat synojnë avancimin drejt një shoqërie të lirë nga dhuna me bazë gjinore e dhuna në familje.

Po kështu, zgjerimi i gamës së shërbimeve mbështetëse të specializuara për trajtimin deri në rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave/të mbijetuarave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, si dhe shtimi i shërbimeve të munguara për të gjitha grupet e grave, të rejave dhe vajzave, janë planifikuar si masa që përmirësojnë ndjeshëm situatën në këtë drejtim.

Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, i ngritur tashmë në 61 bashkitë në vend, ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme, me qëllim rritjen e efektivitetit të funksionimit të tij dhe avancimit drejt qëndrueshmërisë së këtij mekanizmi. Për rrjedhojë janë planifikuar një tërësi masash dhe veprimesh që konsistojnë në formalizimin e mëtejshëm të punës së këtij mekanizmi përmes procedurave standarde të veprimit e protokolleve specifike, si dhe fuqizimi i kapaciteteve të anëtarëve të MKR-së për të adresuar në mënyrë shumëdisiplinare rastet e ndeshura në praktikë, si dhe për të ndërhyrë më ndjeshëm në parandalim, informim e ndërgjegjësim. Mbledhja e rregullt e të dhënave mbi menaxhimin e rasteve në mënyrë shumëdisiplinare të koordinuar, si dhe pasqyrimi i përditësuar i tyre në sistemin REVALB, do të jetë, gjithashtu, pjesë e veprimeve për fuqizimin dhe rritjen e efektivitetit të MKR-së në vend.

Për herë të parë në këtë strategji theksohet me një objektiv specifik më vete edhe edukimi mbi të drejtat seksuale e riprodhuese, si një tjetër mjet për fuqizimin e grave, e të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet (në strategjitë e mëparshme të barazisë gjinore, ka pasur masa në këtë drejtim, por jo objektiv specifik më vete).

Zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje dhe avancimi drejt eliminimit të tyre nuk mund të realizohet pa një shoqëri me mendësi të hapur, që lufton steriotipat gjinore e praktikat e dëmshme si dhe që nuk e toleron ushtrimin e dhunës. Prandaj një sërë masash e veprimesh nën këtë qëllim strategjik fokusohen pikërisht tek informimi, ndërgjegjësimi dhe krijimi i brezit të barazisë.

Më konkretisht, nën **objektivin specifik III.1, "Mbrojtja më e mirë e grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, nga të gjitha format e praktikave të dëmshme, seksizmit, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes përmirësimit të legjislacionit, zbatimit efektiv të tij, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për personat e dhunuar, ndëshkimin e dhunuesve dhe vënien në funksionim të programeve rehabilituese",** janë parashikuar:

Rezultatet e arritshme:

i. Legjislacion i përmirësuar, veçanërisht për të siguruar ndalimin e të gjitha praktikave të dëmshme, seksizmit dhe formave të dhunës me bazë gjinore të papërfshira apo pasaktësuara ende, i cili zbatohet efektivisht.

ii. Të gjitha llojet e programeve rehabilituese për dhunuesit të shtrira në të 12 qarqet e vendit.

Treguesit:

III.1.a) Numri i propozimeve të paraqitura dhe miratuara në Kuvend, në lidhje me përmirësimin e legjislacionit ekzistues penal dhe civil, për sa i takon ndalimit të praktikave të dëmshme dhe saktësimit apo përfshirjes së masave ndëshkuese për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në përputhje me rekomandimet e GREVIO-s dhe CEDAW-t.

III.1.b) Numri i programeve rehabilituese për dhunuesit të ngritura dhe funksionale sipas standardeve të miratuara.

Masat:

III.1.1. Përmirësimi i legjislacionit për mbrojtje nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje, seksizmit e gjuhës së urrejtjes.

III.1.2. Mbështetja për zbatimin e duhur dhe efektiv të kuadrit ligjor të përmirësuar, duke filluar nga ndryshimet e vitit 2020 e në vazhdimësi.

III.1.3. Krijimi i mundësive për rehabilitimin e dhunuesve, bazuar në standardet e Konventës së Stambollit dhe modelet pozitive ndërkombëtare.

Nën objektivin **specifik III.2, "Rritja e aksesit në shërbimet mbështetëse të specializuara për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë nga të gjitha grupet, të cilët përjetojnë praktika të dëmshme, dhunë seksuale dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si në situatë**

normale ashtu dhe në situatë të krizave humanitare e gjendjeve të fatkeqësive natyrore", janë parashikuar:

Rezultatet e arritshme:

i. Shërbimet mbështetëse të specializuara që mundësojnë qasje për të gjitha grupet e grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, të shtrira në të gjithë vendin.

ii. Mekanizmat e koordinuar të referimit në mbarë vendin të specializuar për trajtimin efektiv të të gjitha rasteve të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

Treguesit:

III.2.a) Numri i shërbimeve mbështetëse të specializuara për të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës/trafikimit, të ngritura apo zgjeruara, disagreguar, sipas llojit të shërbimit, grupit të synuar dhe karakteristikave të këtij grupi.

III.2.b) Përqindja e buxhetit të shërbimeve sociale dedikuar funksionimit të qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të gjitha format e dhunës, e disagreguar, sipas situatës: në situatë normale dhe në situata të krizave humanitare e gjendjeve të fatkeqësive natyrore.

III.2.c) Numri i MKR-së në vend, të cilët kanë të emëruar një ose më shumë koordinatore/koordinatorë vendorë me kohë të plotë, dedikuar vetëm për këtë funksion.

III.2.d) Përqindja e rasteve të referuara të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale ndaj grave, të rejave e vajzave, të cilat janë hetuar dhe dënuar.

Masat:

III.2.1. Shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për të mbijetuarat/ mbijetuarit e sulmeve seksuale dhe trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual, nga të gjitha grupet.

III.2.2. Shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara të strehimit emergjent.

III.2.3. Shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara të strehimit afatgjatë.

III.2.4. Mbështetja financiare e OJF-j të cilat ofrojnë shërbime të specializuara të formave të ndryshme, për rastet e dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje e trafikimit.

III.2.5. Përmirësimi i funksionimit të MKR në nivel vendor.

III.2.6. Krijimi i mundësive për riintegrimin e të mbijetuarave të dhunës/trafikimit nëpërmjet sigurimit të strehimit afatgjatë, përmes lehtësimit të praktikave të përfitimit të strehimit social.

Nën **objektivin specifik III.3,** "**Përmirësimi i qasjes në drejtësi të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, për të mbrojtur të drejtat e tyre",** janë parashikuar:

Rezultati i arritshëm:

i. Kuadri ligjor i përmirësuar, i njohur dhe i zbatueshëm përmes sigurimit të fondeve të duhura për shtrirjen e ndihmës ligjore falas në të gjithë vendin.

Treguesi:

III.3.a) Numri i qendrave të ndihmës ligjore falas të ngritura në vend.

Masa:

III.3.1. Mbështetja e subjekteve që ofrojnë shërbim ligjor falas parësor dhe dytësor për viktimat e dhunës në familje, viktimat në gjini, fëmijët viktima dhe dëshmitarë, viktimat e trafikimit dhe viktimat e abuzuara seksualisht, si dhe rritja e kapaciteteve të profesionisteve/ profesionistëve të këtyre subjekteve për trajtimin e çështjeve me ndjeshmërinë dhe profesionalizmin e duhur.

Nën **objektivin specifik III. 4 "Përgatitja e një brezi të ri të barazizë ku gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë nga të gjitha grupet, janë agjentë të ndryshimit në lidhje me normat diskriminuese shoqërore, steriotipat gjinore dhe parandalimin e luftimin e seksizmit",** janë parashikuar:

Rezultati i arritshëm:

i. Një brez i ri i grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve, të cilët nuk e pranojnë dhe nuk e tolerojnë ushtrimin e dhunës, seksizimit dhe pabarazinë gjinore në familje e shoqëri.

Treguesi:

III.4.a) Numri i të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve të trajnuar dhe angazhuar si agjentë ndryshimi në lëvizjen kombëtare të brezit të barazisë.

Masat:

III.4.1. Edukimi i shoqërisë me parimet e barazisë gjinore.

III.4.2. Investimi në prindërimin pozitiv.

Nën **objektivin specifik III.5,** "**Fuqizimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet, për të pasur kontroll të plotë, për të vendosur lirshëm dhe me përgjegjësi për**

çështjet që lidhen me shëndetin seksual e riprodhues", janë parashikuar:

Rezultati i arritshëm:

i. Situata shëndetësore, aksesi në informacionin dhe shërbimet shëndetësore për gratë, të rejat dhe vajzat e djemtë adoleshentë të të gjitha grupeve, për të gëzuar të drejtat dhe shëndetin e tyre seksual e riprodhues, e përmirësuar.

Treguesit:

III.5.a) Përqindja e grave dhe e burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve të të gjitha grupeve, që marrin informacion gjithëpërfshirës mbi shëndetin e tyre seksual e riprodhues, disagreguar sipas seksit, moshës dhe karakteristikave të tjera personale.

III.5.b) Përqindja e kontraceptivëve në mesin e grave që janë të martuara ose në një marrëdhënie, mosha 15–49 vjeç (OZHQ 3.7.1).

Masat:

III.5.1. Përmirësimi i kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve të shëndetësisë për ofrimin e shërbimeve cilësore mbi shëndetin seksual e riprodhues për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë nga të gjitha grupet, përfshirë dhe në situata të emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.

III.5.2. Krijimi i mjedisit lehtësues për vajzat, të rejat dhe gratë nga të gjitha grupet, që të marrin vendime të informuara mbi jetën e tyre, marrëdhëniet seksuale, përdorimin e një metode kontraceptive dhe kujdesin për shëndetin e tyre seksual e riprodhues.

Politika IV

Qëllimi strategjik IV - Aplikimi i integrimit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri.

Prej vitesh tashmë në Shqipëri janë hedhur një sërë hapash në drejtim të aplikimit të integrimit gjinor, si mjet kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore, por duket se fokusi kryesor ka qenë buxhetimi i përgjigjshëm gjinor dhe zbatimi i tij kryesisht në nivelin qendror. Tashmë është menduar të hidhen hapa në drejtim të fuqizimit të këtyre arritjeve, matjes së rezultateve të dëshiruara, fuqizimit të mekanizmit kombëtar për barazinë gjinore, si dhe aplikimin e mëtejshëm të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në njësitë e vetëqeverisjes vendore etj.

Për këtë arsye, nën këtë qëllim strategjik janë formuluar këta objektiva specifikë:

Objektivi specifik IV.1:	Fuqizimi i mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore.
Objektivi specifik IV.2:	Monitorimi i zbatimit të programeve në të cilat është aplikuar buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, në nivel qendror.
Objektivi specifik IV.3:	Mbështetja e njësive të vetëqeverisjes vendore për njohjen dhe zbatimin e detyrimit ligjor për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Nën objektivin specifik IV.1, "**Fuqizimi i mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore"**, janë parashikuar:

Rezultati i arritshëm:

i. Mekanizmi kombëtar i barazisë gjinore i fuqizuar me burime të shtuara njerëzore, financiare e infrastrukturore.

Treguesi:

IV.1.a) Përqindja e buxhetit dedikuar strukturës shtetërore kryesore përgjegjëse qendrore të Barazisë Gjinore.

Masat:

IV.1.1. Fuqizimi i rolit të KKBGJ-së dhe krijimi i grupit ndërinstitucional të punës për statistikat gjinore.

IV.1.2. Fuqizimi i strukturës shtetërore kryesore përgjegjëse qendrore të barazisë gjinore.

Nën **objektivin specifik IV.2, "Monitorimi i zbatimit të programeve në të cilat është aplikuar buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, në nivel qendror"**, janë parashikuar:

Rezultati i arritshëm:

i. Buxheti i alokuar dhe i shpenzuar, në lidhje me programet buxhetore të raportuara si programe të ndjeshme gjinore, në nivel qendror, i monitoruar dhe i raportuar.

Treguesi:

IV.2.a) Numri i ministrive të linjës që publikojnë në faqet e tyre të dhëna mbi monitorimin e zbatimit të programeve në të cilat kanë aplikuar buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

IV.2.b) Numri i strategjive të reja që kanë të integruar perspektivën gjinore.

Masa:

IV.2.1. Rritja e transparencës në përdorimin e fondeve.

Nën **objektivin specifik IV.3, "Mbështetja e njësive të vetëqeverisjes vendore për njohjen dhe zbatimin e detyrimit ligjor për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor"**, janë parashikuar:

Rezultati i arritshëm:

i. Buxhetet e NJVV-ve reflektojnë zbatimin korrekt të legjislacionit mbi aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Treguesi:

IV.3.a) Numri i bashkive që kryejnë rregullisht analizën gjinore dhe monitorimin e buxhetit nga këndvështrimi gjinor.

Masa:

IV.3.1. Zbatimi i BPGJ-së në nivel vendor, në të gjitha bashkitë në vend

PJESA III
ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Përgjegjësia e institucioneve

Për zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021–2030 do të angazhohen një tërësi institucionesh, duke filluar nga ministritë e linjës, institucionet e pavarura, njësitë e vetëqeverisjes vendore, akademia, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Strategjia përcakton Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucionin përgjegjës kryesor të raportimit për progresin e saj edhe pse pjesa më e madhe e veprimtarive do të kërkojë bashkëpunim ndërmjet aktorëve të ndryshëm, duke përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile, kryesisht në mbrojtje të të drejtave të grave, të rejave e vajzave nga të gjitha grupet dhe të fokusuara te fuqizimi i tyre, si dhe tek arritja e barazisë gjinore dhe zvogëlimi i dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje. Institucionet përgjegjëse për çdo masë, sipas objektivave specifikë dhe fushave të politikës janë të përcaktuar në matricën e logjikës së ndërhyrjes në aneksin 4 të këtij dokumenti.

Llogaridhënia, monitorimi dhe raportimi

Llogaridhënia

Kuadri monitorues do të ushqejë orientimin e politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e burimeve të vendit. Ai do të furnizojë me raporte monitoruese dhe vlerësuese Grupin Tematik Ndërinstitucional të Përfshirjes dhe Mbrojtjes Sociale ngritur me Urdhrin nr. 157, datë 22.10.2018, të Kryeministrit, "Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen e funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar". Përqasja dhe rishikimi i dokumentit strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM-së nr. 290, datë 11.4.2020, "Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me sistemin IPSIS".

Ndërsa për përcaktimin e bazës së treguesve për masat e reja të propozuara, sugjerohet që të ndërmerren veprimet e vlerësimit të situatës dhe përcaktimit të kësaj bazepërmes sondazheve e studimeve dhe vendosja një sistemi të mirë organizuar në mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit e statistikave gjinore, për të gjitha programet dhe aktivitetet që do të zbatohen në kuadër të kësaj strategjie.

Monitorimi

Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të kësaj strategjie dhe planit të saj të veprimit do të paraqitet në mënyrë periodike edhe në Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore. MSHMS në bashkëpunim dhe me Ministrinë e Brendshme e Agjencinë e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore, do të udhëzojë dhe mbështesë, gjithashtu, bashkitë në zbërthimin e Planit Kombëtar të Veprimit në plane të zbatueshme në nivelin vendor, e në mënyrë të veçantë në përgatitjen e planeve përkatëse, në përputhje dhe me Kartën Evropiane për Barazi të grave dhe burrave në jetën vendore.

Gjatë punës së përditshme, përgjegjësia për monitorimin e zbatimit të Planit të Veprimit qëndron te nëpunëset/nëpunësit e barazisë gjinore dhe koordinatoret/koordinatorët vendorë për trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

MSHMS-ja ka rol koordinues dhe raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit vjetor.

Organizatat e shoqërisë civile luajnë gjithashtu një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin rreth problemeve, në zbatimin dhe në mbështetjen e proceseve të mbledhjes së të dhënave, ofrimit të shërbimeve dhe zbatimit të legjislacionit e politikave në tërësi, për avancimin drejt barazisë gjinore.

Krahas zbatimit të masave të përcaktuara në Strategji dhe Planin e Veprimit, monitorimi i vazhdueshëm i strukturave të angazhuara për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ky dokument, konsiderohet i nevojshëm për të analizuar gjendjen reale gjatë zbatimit të tij, me qëllim përmbushjen e objektivave në mënyrë sa më efektive.

Më konkretisht do të ndërmerren këto masa:

- do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;
- do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe rreziqet, si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet e progresraporteve të Bashkimit Evropian dhe të dokumenteve të tjera ndërkombëtare;
- do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;
- do të kryhet monitorim dhe do të hartohen raporte vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planit të veprimit.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioriteteve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikat e vendit të lidhura me avancimin drejt barazisë gjinore dhe zvogëlimin e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

Vlerësimi

Për shkak të kohëzgjatjes dhjetëvjeçare të zbatimit të strategjisë kombëtare dhe përputhjes së saj me OZHQ-të, është menduar, që përveç monitorimeve vjetore të zbatimit të kësaj strategjie, të ketë edhe një proces vlerësimi të përgjithshëm në vitin e pestë të zbatimit të saj. Bazuar mbi këtë vlerësim mund të ndryshohen/hiqen (nëse janë realizuar plotësisht) dhe shtohen jo vetëm veprime e masa, por edhe objektiva specifikë nën qëllimet strategjike bazë të dokumentit.

Raportimi

Të gjitha institucionet e ngarkuara me zbatimin e SKBGJ 2021–2030 do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe njëvjeçare, në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në këtë strategji dhe të zbërthyera në planin e saj të veprimit, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS.

MSHMS-ja do të jetë institucioni udhëheqës, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse.

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6-mujor, përmes të dhënave të raportuara në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatin Teknik Ndërinstitucional.

PJESA IV
ANALIZA BUXHETORE

4.1 Analiza e buxhetit për zbatimin e SKBGJ 2021–2023

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen e kostove indikative dhe burimeve financiare që financojnë masat e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021–2030. Efektet financiare janë përllogaritur për çdo masë bazuar në aktivitetet që janë të parashikuar në Planin e Veprimit të zbatimit të kësaj strategjie dhe mbështetur në analizën e bërë për nevojat për burime për secilin aktivitet. Efektet financiare parashikohet të përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e një pjesë të masave.

Procesi i kostimit është mbështetur në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu Programi Buxhetor Afatmesëm 2021–2023, si dhe konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira, në kostot historike nga zbatimi i strategjisë pararendëse. Plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili është mbështetur nga detajimi i hollësishëm i çdo aktiviteti.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e SKBGJ 2021–2030 është **3,358,697,259 lekë** ose **27,086,268 euro**. Kursi mesatar për

referencë është përllogaritur me 124 lekë për 1 euro. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 10 vjetëve të zbatimit të SKBGJ 2021–2030.

Nevojat (në Lek)

Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale 2021-2030	Kostot e Planifikuara PBA 2021-2023/ Burime të tjera dhe Donatoret	Kosto për tu Planifikuar në Buxhetin 2024-2030	Hendeku Financiar 2021-2030
P1: Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë,të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të	Korente	695,834,518	435,418,581	189,638,980	*72,329,457*
	Kapitale	20,010,000	6,900,000	11,557,500	
P2: Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave,të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet përpjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në	Korente	98,284,272	32,277,760	11,988,480	*54,018,032*
	Kapitale	0	0	0	
P3: Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Korente	1,495,565,465	770,164,420	423,441,572	*366,879,473*
	Kapitale	648,945,000	271,870,000	312,155,000	
P4: Aplikimi i integrimit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri	Korente	399,793,504	115,505,108	252,962,424	*31,325,972*
	Kapitale	264,500	264,500	0	
TOTALI [Leke]		**3,358,697,259**	**1,632,400,369**	**1,201,743,956**	***524,552,934***
TOTALI [Euro] *1 euro 124 Leke*		**27,086,268**	**13,164,519**	**9,691,484**	***4,230,266***

Financimi i planit të veprimit të zbatimit të kësaj strategjie do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit, fondet e NJVV-së dhe mbështetja financiare e donatorëve mbeten burimet kryesore. Për periudhën 2021–2030, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 50.5% të financimit të nevojshëm, 33.9% pritet të financohet nga burime të tjera dhe donatorët, ndërsa 15.6% është hendek financiar.



Kostot korrente zënë rreth 80.1% të shpenzimeve totale, ndërsa pjesa tjetër (19.9%) është e parashikuar për kosto kapitale.



Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë. Qëllimi i politikës III, pritet të ketë në terma financiarë peshën më të madhe në zbatimin e strategjisë, përkatësisht 63.8%. Qëllimi i politikës I arrin në vlerën 21.3%, ndërsa Qëllimet e politikës IV dhe II arrijnë respektivisht 11.9% dhe 2.9 % të kostos së përgjithshme të strategjisë.

Strategjia do të rishikohet pas 5 vjetësh (në vitin 2025) për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform nevojave dhe programeve buxhetore afatmesme 2026–2028, të çdo institucioni. Për masa të strategjisë që janë të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.



ANEKS
MATRICA E QËLLIMEVE TË POLITIKËS DHE TREGUESIT

1	2	3	4	5	6	7
Lloji i treguesit	**Emërtimi i indikatorit**	**Lidhja me nr. e shtyllës së SKZHI**	**Qëllimi/objektivi strategjik në SKZHI**	**Qëllimi i politikës**	**Objektivi specifik me të cilin lidhet indikatori/treguesi**	**Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës**
Impakti	Shkalla e punësimit sipas gjinisë	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomik	Sigurimi i barazisë gjinore	Qëllimi strategjik I - Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.	INSTAT/LFS
Impakti	Punësimi joformal, si një përqindje e totalit të punësimit jobujqësor, sipas gjinisë (SDG 8.3.1)	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomik	Sigurimi i barazisë gjinore	Qëllimi strategjik I - Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.	INSTAT/LFS

Impakti	Numri mesatar i orëve të shpenzuara në punët shtëpiake dhe kujdesin shtëpiak sipas gjinisë (SDG 5.4.1)	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Qëllimi strategjik I - Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.	INSTAT/TUS
Impakti	Përqindja e vendeve të mbajtura nga gratë në: a) parlamentin kombëtar; dhe b) qeverisjen vendore (SDG 5.5.1)	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje	Sigurimi i barazisë gjinore	Qëllimi strategjik II - Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.	KQZ
Impakti	Përqindja e grave dhe e vajzave të moshës 15+ nënshtruar dhunës fizike, seksuale ose psikologjike nga partneri aktual ose ish-partneri intim gjatë të 12 muajve të mëparshëm (SDG 5.2.1)	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Qëllimi strategjik III - Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	INSTAT

Impakti	Përqindja e femrave të moshës 20–24 vjeç, që janë martuar ose hynë në një marrëdhënie para moshës 18 vjeç (SDG 5.3.1)	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik -Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Qëllimi strategjik III - Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	INSTAT/ISHP

ANEKS 2
MATRICA E OBJEKTIVAVE SPECIFIKË DHE TREGUESIT

1	2	3	4	5	6	7
Lloji i treguesit	**Emërtimi i indikatorit**	**Lidhja me nr. e shtyllës së SKZHI**	**Qëllimi/objektivi strategjik në SKZHI**	**Qëllimi i politikës**	**Objektivi specifik me të cilin lidhet indikatori/treguesi**	**Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës**
Rezultati	I.2.a) Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese në zonat rurale dhe urbane mbi legjislacionin e përmirësuar, në lidhje me të drejtat pronësore të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, me fokus të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.2: Rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza mbi 16 vjeç, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet produktive.	MSHMS/MBZHR
Rezultati	I.2.b) Përqindja e grave, e të rejave dhe e vajzave, të cilat gëzojnë pronësinë, si dhe kanë akses e kontroll mbi tokën bujqësore.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.2: Rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza mbi 16 vjeç, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet produktive.	Kadastra dhe INSTAT

Rezultati	I.3.a) Përqindja e punëkërkueseve të papuna, të punësuara nëpërmjet ndërmjetësimeve të zyrave të punësimit ndaj totalit të punëkërkuesve të papunë të punësuar nga këto zyra punësimi, në shkallë vendi, disagreguar sipas moshës, grupeve të caktuara.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.3: Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), për punë të denjë edhe në sektorët jotradicionalë të punësimit, (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë).	AKPA
Rezultati	I.3.b) Përqindja e grave, e të rejave dhe e vajzave nga të gjitha grupet, të punësuara në sektorë jotradicionalë (prodhim, ndërtim, industri nxjerrëse, energji, gaz dhe furnizimi me ujë).	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.3: Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), për punë të denjë edhe në sektorët jotradicionalë të punësimit (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë).	INSTAT/LFS
Rezultati	I.3.c) Numri i vajzave dhe të rejave, nga të gjitha grupet, të cilat studiojnë në Biologji, Biokimi, Mjediset natyrore dhe kafshët e egra, Kimi, Fizikë, Matematikë, Përdorim kompjuteri, *database* dhe disenjim rrjeti dhe administrim, Zhvillimi i *Software*-eve dhe aplikacioneve dhe analiza, Inxhinieri kimike dhe proceset, elektriciteti dhe energjia, elektronikë dhe automatizim, mekanikë dhe tregtimi i metaleve, automjetet motorike,	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.3: Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), për	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë -INSTAT

	anijet dhe avionët, minierat dhe nxjerrja, arkitektura dhe planifikimi i qytetit, ndërtimi dhe inxhinieria civile, peshkim, veterinari, terapia dhe rehabilitimi dhe farmaci				punë të denjë edhe në sektorët jotradicionalë të punësimit (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë).	
Rezultati	II.1.a) Përqindja e grave, e të rejave dhe e vajzave nga të gjitha grupet e përfshirë dhe përfaqësuar në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik II.1: Krijimi i kushteve që mundësojnë pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë të grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuar/moshuara, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), në vendimmarrjen politike e publike, në nivel vendor.	INSTAT/SILC
Rezultati	II.2.a) Përqindja e popullsisë që mbështet modelet e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, në vendimmarrjen politike e publike vendore.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Rritja e përfaqësimit të grave në politikë dhe vendimmarrje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik II.2: Përforcimi i qëndrimeve dhe i sjelljeve shoqërore që nxisin pjesëmarrjen, përfaqësimin dhe udhëheqjen e barabartë të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.	INSTAT/SILC

Rezultati	III.2.b) Numri i shërbimeve sociale dedikuar funksionimit të qendrave të shërbimeve mbështetëse të specializuara për të gjitha format e dhunës, e disagreguar sipas situatës: në situatë normale dhe në situata të krizave humanitare e gjendjeve të fatkeqësive natyrore.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik III.2: Rritja e aksesit në shërbimet mbështetëse të specializuara për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të varur nga substancat, të moshuara/moshuar, me probleme të shëndetit mendor, azilkërkuese, të dhunuara/trafikuara etj.), të cilët përjetojnë praktika të dëmshme, dhunë seksuale dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si në situata normale ashtu dhe në situata të krizave humanitare e gjendjeve të fatkeqësive natyrore.	MSHMS&MFE
Rezultati	III.2.d) Përqindja e rasteve të referuara të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës seksuale ndaj grave, të rejave e vajzave, të cilat janë hetuar dhe dënuar.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik III.2: Rritja e aksesit në shërbimet mbështetëse të specializuara për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të varur nga substancat, të moshuara/moshuar, me probleme të shëndetit mendor, azilkërkuese, të dhunuara/trafikuara etj.), të cilët përjetojnë praktika të dëmshme, dhunë seksuale dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si në situata normale ashtu dhe në situata të krizave humanitare e gjendjeve të fatkeqësive natyrore.	Ministria e Drejtësisë/Gjykata/Prokuroria

Rezultati	III.4.a) Numri i të rejave dhe i të rinjve, vajzave dhe djemve, të trajnuar dhe angazhuar si agjentë ndryshimi në lëvizjen kombëtare të brezit të barazisë.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik III.4: Përgatitja e një brezi të ri të barazisë ku gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), janë agjentë të ndryshimit në lidhje me normat diskriminuese shoqërore, steriotipat gjinore dhe parandalimin e luftimin e seksizmit.	MSHMS
Rezultati	III.5.a) Përqindja e grave dhe e burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, që marrin informacion gjithëpërfshirës mbi shëndetin e tyre seksual e riprodhues, disagreguar sipas seksit, moshës dhe karakteristikave të tjera personale.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik III.5: Fuqizimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) për të pasur kontroll të plotë, për të vendosur lirshëm dhe me përgjegjësi për çështjet që lidhen me shëndetin seksual e riprodhues.	INSTAT/ISHP
Rezultati	III.5.b) Përqindja e kontraceptivëve në mesin e grave që janë të martuara ose në një marrëdhënie, mosha 15–49 vjeç (SDG 3.7.1)	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik III.5: Fuqizimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) për të pasur kontroll të plotë, për të vendosur lirshëm dhe me përgjegjësi për çështjet që lidhen me shëndetin seksual e riprodhues.	ISHP&INSTAT

Rezultati	IV.1.a) Përqindja e buxhetit dedikuar strukturës shtetërore kryesore qendrore përgjegjëse të barazisë gjinore.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Aplikimi i integrimit gjinor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik IV.1: Fuqizimi i mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore	MFE
Rezultati	IV.2.b) Numri i strategjive të reja që kanë të integruar perspektivën gjinore.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Aplikimi i integrimit gjinor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik IV.2: Monitorimi i zbatimit të programeve në të cilat është aplikuar buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, në nivel qendror.	MSHMS

ANEKS 3
MATRICA E MASAVE DHE TREGUESIT

1	2	3	4	5	6	7
Lloji i treguesit	**Emërtimi i indikatorit**	**Lidhja me nr. e shtyllës së SKZHI-së**	**Qëllimi/objektivi strategjik në SKZHI**	**Qëllimi i politikës**	**Objektivi specifik me të cilin lidhet indikatori/treguesi**	**Burimi i të dhënave për monitorimin e treguesit të performancës**
Masa	I.1.a) Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi legjislacionin në fuqi në lidhje me format e lejeve të paguara të lejueshme për secilin prind në legjislacionin shqiptar.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.1: Zbatimi i kuadrit ligjor dhe i politikave të përmirësuara, që mundësojnë ndarje të barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.	MSHMS
Masa	I.1.b) Numri i prindërve që aplikojnë dhe përfitojnë marrjen e secilës formë të lejes së paguar, në vit, i disagreguar sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, aftësisë së kufizuar etj. dhe sipas institucioneve apo bizneseve që e mundësojnë dhënien e saj.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.1: Zbatimi i kuadrit ligjor dhe i politikave të përmirësuara, që mundësojnë ndarje të barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.	ISSH
Masa	I.2.c) Numri i praktikave të miratuara për krijimin e lehtësirave fiskale dhe mbështetjes së grave, të të rejave dhe të vajzave për fillimin e bizneseve të tyre fokusuar tek ekonomia mjedisore dhe digjitalizimi, në nivel qendror e vendor.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.2: Rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza mbi 16 vjeç, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet produktive.	MFE & AIDA&Bashkia
Masa	I.2.d) Numri i grave, i të rejave dhe i vajzave të subvencionuara për të filluar bizneset e tyre lidhur me ekonominë mjedisore dhe	3. INVESTIMI NË	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.2: Rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet	MFE & AIDA&Bashkia

	digjitalizimin, disagreguar sipas moshës, vendbanimit, etnisë etj.	KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike		etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza mbi 16 vjeç, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet produktive.	
Masa	I.3.d) Numri i të punësuarave/punësuarve, nga të gjitha grupet, që denoncojnë dhunë apo ngacmim në vendin e punës, disagreguar sipas gjinisë, moshës, dhe shumë faktorëve të tjerë individualë, si dhe sipas sektorit të punësimit.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.3: Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), për punë të denjë edhe në sektorët jo-tradicionalë të punësimit, (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë).	MSHMS
Masa	I.3.e) Numri i bashkive që shtojnë shërbimet sociale përmes mbështetjes nga Fondi Social	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Fuqizimi ekonomik i grave dhe promovimi i pavarësisë së tyre ekonomike	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik I.3: Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), për punë të denjë edhe në sektorët jotradicionalë të punësimit (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë).	MSHMS

Masa	III.1.a) Numri i propozimeve të paraqitura dhe miratuara në Kuvend, në lidhje me përmirësimin e legjislacionit ekzistues penal dhe civil, për sa i takon ndalimit të praktikave të dëmshme dhe saktësimit apo përfshirjes së masave ndëshkuese për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në përputhje me rekomandimet e GREVIO-s dhe CEDAW-t.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi I dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik III.1: Mbrojtja më e mirë e grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), nga të gjitha format e praktikave të dëmshme, seksizmit, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes përmirësimit të legjislacionit, zbatimit efektiv të tij, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për personat e dhunuar, ndëshkimin e dhunuesve dhe vënien në funksionim të programeve rehabilituese.	Ministria e Drejtësisë
Masa	III.1.b) Numri i programeve rehabilituese për dhunuesit të ngritura dhe funksionale sipas standardeve të miratuara.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi I dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik III.1: Mbrojtja më e mirë e grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), nga të gjitha format e praktikave të dëmshme, seksizmit, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes përmirësimit të legjislacionit, zbatimit efektiv të tij, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për personat e dhunuar, ndëshkimin e dhunuesve dhe vënien në funksionim të programeve rehabilituese.	MSHMS

Masa	III.2.a) Numri i shërbimeve mbështetëse të specializuara për të mbijetuarat/mbijetuarit e dhunës/trafikimit, të ngritura apo zgjeruara, disagreguar sipas llojit të shërbimit, grupit të synuar dhe karakteristikave të këtij grupi.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi I dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik III.2: Rritja e aksesit në shërbimet mbështetëse të specializuara për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të varur nga substancat, të moshuara/moshuar, me probleme të shëndetit mendor, azilkërkuese, të dhunuara/trafikuara etj.), të cilët përjetojnë praktika të dëmshme, dhunë seksuale dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si në situata normale ashtu dhe në situata të krizave humanitare e gjendjeve të fatkeqësive natyrore.	MSHMS
Masa	III.2.c) Numri i MKR në vend të cilët kanë të emëruar një ose më shumë Koordinatore/Koordinatorë Vendorë me kohë të plotë, dedikuar vetëm për këtë funksion.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi I dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik III.2: Rritja e aksesit në shërbimet mbështetëse të specializuara për gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të varur nga substancat, të moshuara/moshuar, me probleme të shëndetit mendor, azilkërkuese, të dhunuara/trafikuara etj.), të cilët përjetojnë praktika të dëmshme, dhunë seksuale dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, si në situata normale ashtu dhe në situata të krizave humanitare e gjendjeve të fatkeqësive natyrore.	Bashkitë
Masa	III.3.a) Numri i qendrave të ndihmës ligjore falas të ngritura në vend	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Reduktimi i dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik III.3: Përmirësimi i qasjes në drejtësi të grave, të të rejave dhe të vajzave, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, nëna të vetme, të moshuara, azilkërkuese, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), për të mbrojtur të drejtat e tyre.	MSHMS

Masa	IV.2.a) Numri i ministrive të linjës që publikojnë në faqet e tyre të dhëna mbi monitorimin e zbatimit të programeve në të cilat kanë aplikuar buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Aplikimi i integrimit gjinor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik IV.2: Monitorimi i zbatimit të programeve në të cilat është aplikuar buxhetimi i përgjigjshëm gjinor, në nivel qendror.	MSHMS
Masa	IV.3.a) Numri i bashkive që kryejnë rregullisht analizën gjinore dhe monitorimin e buxhetit nga këndvështrimi gjinor	3. INVESTIMI NË KAPITAL NJERËZOR DHE KOHEZION SOCIAL	11.8 Sigurimi i barazisë gjinore - Qëllimi strategjik - Aplikimi i integrimit gjinor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore	Sigurimi i barazisë gjinore	Objektivi specifik IV.3: Mbështetja e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për njohjen dhe zbatimin e detyrimit ligjor për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.	MSHMS

ANEKS 4
LOGJIKA E NDËRHYRJES, INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE, AFATET KOHORE

LOGJIKA E NDËRHYRJES			
Qëllimi strategjik I:	**Përmbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale për gratë, të rejat, vajzat dhe burrat, të rinjtë, djemtë në shoqëri dhe fuqizimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), duke synuar një rritje dhe qëndrueshmëri të ekonomisë mjedisore (së gjelbër), si dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.**		
Objektivi specifik I.1:	**Zbatimi i kuadrit ligjor dhe politikave të përmirësuara, që mundësojnë ndarje të barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.**		
Rezultatet e pritshme:	i. Kuadri ligjor dhe i politikave që lejon marrjen e lejes së paguar të lindjes së fëmijës, lejes prindërore dhe lejes së përkujdesjes ndaj fëmijës, nga të dy prindërit, i njohur dhe i zbatueshëm në institucionet shtetërore dhe ato private. ii. Politika të përmirësuara, që mundësojnë zbatimin e së drejtës për marrjen e lejeve të paguara nga secili prind, sipas legjislacionit në fuqi, pavarësisht situatave të emergjencave civile e fatkeqësive natyrore. iii. Punëdhënëse dhe punëdhënës publikë e privatë që nxitin balancimin e angazhimit të të dy prindërve në punën dhe kujdesin e papaguar në familje, duke aplikuar rregullisht dhënien e lejeve të paguara të lejueshme për secilin prind në legjislacionin shqiptar, përfshirë dhe në situata të emergjencave civile e fatkeqësive natyrore.		
Treguesit:	I.1.a) Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese mbi legjislacionin në fuqi në lidhje me format e lejeve të paguara të lejueshme për secilin prind në legjislacionin shqiptar. I.1.b) Numri i prindërve që aplikojnë dhe përfitojnë marrjen e secilës formë të lejes së paguar, në vit, i disagreguar sipas seksit, moshës, etnisë, vendbanimit, aftësisë së kufizuar etj. dhe sipas institucioneve apo bizneseve që e mundësojnë dhënien e saj.	*Baseline:* 1 (2020) Do përcaktohet më 2022-shin (studim)	*Target* 10 aktivitete në vit duke filluar nga 2022 Të rritet me 2pp çdo vit

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
I.1.1 Informimi i punëdhënëseve/punëdhënësve, punëmarrëseve/punëmarrësve publikë e privatë dhe shoqërisë në tërësi, mbi format e lejeve të paguara, të lejueshme për secilin prind në legjislacionin shqiptar.		**MFE**	**MSHMS, ISHPSHSH, ISSH, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare**	**6M-II- 2021 – 6M-II- 2025**
I.1.1.a) Përgatitja e fletëpalosjeve / broshurave informuese mbi parashikimet në kuadrin ligjor në lidhje me format e lejeve të paguesshme të lejuara për secilin prind në Shqipëri.	*10,000 fletëpalosje të prodhuara dhe shpërndara në të gjithë vendin*	*MFE*	*ISHPSHSH, ISSH, org. ndërkombëtare*	6M-II- 2021 - 6M-I-2022
I.1.1.b) Takime informuese (online) me stafet drejtuese të institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe vendor për respektimin e të drejtave të punonjëseve/punonjësve për dhënien e lejeve të paguara.	*1 takim i organizuar me ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura 12 takime të organizuara në nivel qarku*	*MFE*	*ISHPSHSH, ISSH, MSHMS, qarku, NJVV,org. ndërkombëtare*	6M-II- 2021 - 6M-II-2022
I.1.1.c) Takime informuese (online) me punonjëset dhe punonjësit e institucioneve shtetërore në nivel qendror	*1 takim i organizuar me*	*MFE*	*ISHPSHSH, ISSH, MSHMS,*	6M-II- 2021

dhe vendor për të nxitur kërkimin e së drejtës për marrjen e lejeve të paguara.	*ministritë e linjës dhe institucionet e pavarura 12 takime të organizuara në nivel qarku*		*qarku, NJVV, org. ndërkombëtare*	- 6M-II-2022
I.1.1.d) Takime informuese (ballë për ballë) me stafet drejtuese të institucioneve private / bizneseve në mbarë vendin për respektimin e të drejtave të punonjëseve/punonjësve për dhënien e lejeve të paguara.	*61 takime të realizuara në mbarë vendin*	*MFE*	*ISHPSHSH, ISSH, NJVV, bizneset, org. ndërkombëtare*	6M-I-2022 - 6M-II-2025
I.1.1.e) Takime informuese (ballë për ballë) me punonjëset dhe punonjësit e institucioneve private / bizneseve në mbarë vendin për të nxitur kërkimin e së drejtës për marrjen e lejeve të paguara.	*61 takime të realizuara në mbarë vendin*	*MFE*	*ISHPSHSH, ISSH, NJVV, bizneset, org. ndërkombëtare*	6M-I-2022 - 6M-II-2025
I.1.1.f) Emisione televizive mbi format e lejeve të paguara, të lejueshme për secilin prind në legjislacionin shqiptar.	*5 emisione televizive të zhvilluara*	*MFE*	*ISHPSHSH, ISSH, MSHMS, NJVV, TVSH, mediat private, org. ndërkombëtare*	6M-II-2021 - 6M-II-2025
I.1.1.g) Publikimi i informacioneve të nevojshme në internet dhe mediat sociale.	*1 link i hapur në faqen zyrtare të ministrisë dhe informacione të publikuara në mediat sociale*	*MFE*	*MSHMS, ISHPSHSH, ISSH, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	6M-II-2021 - 6M-II-2025
I.1.2. Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe i politikave që mundësojnë ndarje të barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve (si: fleksibiliteti i të punuarit nga shtëpia, zgjatja e kohës së lejeve të paguara për të dy prindërit), bazuar në modele të suksesshme ndërkombëtare.		**MFE**	**MD, MSHMS, KMD, ISSH, Avokati i Popullit, KMD, org. ndërkombëtare**	**6M-I-2022 - 6M-II-2023**
I.1.2.a) Analizë e kuadrit ligjor dhe politikave mbi lejet e paguara, përllogaritjen e pagesave të tyre, kohëzgjatjen, si dhe mbi fleksibilitetin e të punuarit nga shtëpia, për të evidentuar nevojën për përmirësim, bazuar dhe në modelet më të suksesshme ndërkombëtare.	*1 raport i përgatitur me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse*	***MFE***	*ISSH MD, MSHMS, KMD, Avokati i Popullit, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2022*
I.1.2.b) Takim online për lancimin e gjetjeve nga analiza e kuadrit ligjor dhe të politikave.	*1 takim konsultues i realizuar*	***MFE***	*ISSH MD, MSHMS, KMD, Avokati i Popullit, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2022 - 6M-II-2022*
I.1.2.c) Përgatitja e projekt propozimeve mbi ndryshimet legjislative dhe ose të politikave, bazuar në gjetjet nga analiza e kuadrit ligjor dhe politikave.	*Draft projekt propozim/et e përgatitur/a*	***MFE***	*ISSH MD, MSHMS, KMD, Avokati i Popullit, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2023 - 6M-I-2023*
I.1.2.d) Konsultimi i projekt propozimeve me grupet e interesit dhe përmirësimi i tyre bazuar në këto konsultime.	*5 takime konsultuese të zhvilluara me grupet e interesit*	***MFE***	*ISSH MD, MSHMS, KMD, Avokati i Popullit, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2023 - 6M-I-2023*
I.1.2.e) Paraqitja në Kuvend dhe miratimi i projekt propozimeve të përgatitura.	*VKM me propozimin e miratuar*	*Kuvendi*	*MFE, ISSH MD, MSHMS, KMD, Avokati i Popullit, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2023 - 6M-II-2023*
I.1.3. Monitorimi i zbatimit të kuadrit ligjor dhe i politikave, që mundësojnë ndarje të barabartë të punës		**MFE**	**MSHMS, ISSH, NJVV,**	**6M-I-2022**

dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.			**org. ndërkombëtare**	**- 6M-II-2025**
I.1.3.a) Sondazh mbi numrin e punëmarrëseve dhe punëmarrësve të cilat/cilët kanë aplikuar dhe marrë secilën formë të lejes së paguar (baseline për vitet 2019–2021), duke evidentuar dhe ndikimin që patën situatat e emergjencave civile dhe fatkeqësive natyrore.	*1 raport vlerësimi i përgatitur*	***MFE***	*ISSH, MSHMS, ISSH, NJVV, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2022*
I.1.3.b) Tryezë online për lancimin e gjetjeve të studimit për vitet 2019–2021.	*1 takim konsultues i zhvilluar*	***MFE***	*MSHMS, ISSH, NJVV, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2022*
I.1.3.c) Sondazh mbi numrin e punëmarrëseve dhe punëmarrësve të cilat/cilët kanë aplikuar dhe marrë secilën formë të lejes së paguar (monitorim për vitet 2022–2024).	*1 raport vlerësimi i përgatitur*	***MFE***	*MSHMS, ISSH, NJVV, org. ndërkombëtare*	6M-I-2025 - 6M-II-2025
I.1.3.d) Tryezë online për lancimin e gjetjeve të studimit për vitet 2022–2024.	*1 takim konsultues i zhvilluar*	***MFE***	*MSHMS, ISSH, NJVV, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2025 - 6M-II-2025*
I.1.3.e) Realizimi i studimit mbarëkombëtar për përdorimin e kohës së punës (TUS).	*1 raport studimi i përgatitur*	***INSTAT***	*MSHMS, ministritë e linjës, NJVV, akademia, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2023 - 6M-II-2024*
I.1.3.f) Tryezë online për lancimin e gjetjeve të studimit për përdorimin e kohës së punës (TUS).	*1 takim konsultues i zhvilluar*	***INSTAT***	*MFE, MSHMS, ISSH, NJVV, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2024 - 6M-II-2024*
I.1.3.g) Mbledhja/Prodhimi i statistikave gjinore për monitorimin e treguesve për secilin objektiv specifik nën qëllimin strategjik I, duke bërë dhe koordinimin me institucionet përgjegjëse për mbledhjen dhe standardizimin e të dhënave administrative.	*Statistika gjinore të prodhuara rregullisht Tregues të monitoruar*	***INSTAT***	*Të gjitha ministritë e linjës, institucionet e pavarura, NJVV-të, OSHC, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2025*
I.1.3.h) Aktivitete informuese mbi rëndësinë e ndarjes së barabartë të punës dhe kujdesit të papaguar në familje, ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve.	*976 aktivitete informuese të realizuara (4 takime në vit në 61 bashki për 4 vjet)*	***NJVV***	*MASR/DRAP/ZVAP, MSHMS, OSHC, BtF, Aleanca e Grave Këshilltare, org ndërkombëtare*	*6M-I-2022 – 6M-II-2025*

Objektivi specifik I.2:	**Rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza mbi 16 vjeç, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet produktive.**		
Rezultatet e pritshme:	i. Kuadri ligjor dhe i politikave që garanton gëzimin e së drejtës së pronësisë për gratë, të rejat dhe vajzat nga të gjitha grupet, përfshirë dhe pronësinë mbi tokën bujqësore, i njohur, zbatuar dhe monitoruar. i. Praktika të përmirësuara që mundësojnë fuqizimin ekonomik të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, nëpërmjet krijimit të lehtësirave fiskale dhe mbështetjes ekonomike me grante që synojnë orientimin drejt ekonomisë mjedisore (të gjelbër) dhe digjitalizimit.		
Treguesit:	I.2.a) Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuese në zonat rurale dhe urbane mbi legjislacionin e përmirësuar në	*Baseline*:	*Target*:

	lidhje me të drejtat pronësore të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, me fokus të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore.	0 në 2021	10 aktivitete në vit, duke filluar nga 2022
	I.2.b) Përqindja e grave, e të rejave dhe e vajzave të cilat gëzojnë pronësinë, si dhe kanë akses e kontroll mbi tokën bujqësore.	Do përcaktohet	të rritet me 2pp çdo vit
	I.2.c) Numri i praktikave të miratuara për krijimin e lehtësirave fiskale dhe mbështetjes së grave, të të rejave dhe të vajzave për fillimin e bizneseve të tyre fokusuar tek ekonomia mjedisore dhe digjitalizimi, në nivel qendror e vendor.	Do përcaktohet	5 – 10 praktika të miratuara duke filluar nga viti 2022
	I.2.d) Numri i grave, i të rejave dhe i vajzave të subvencionuara për të filluar bizneset e tyre lidhur me ekonominë mjedisore dhe digjitalizimin, disagreguar sipas moshës, vendbanimit, etnisë etj.	Do përcaktohet	100 gra dhe vajza çdo vit, duke filluar nga 2022

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
I.2.1 Informimi i grave, i të rejave dhe i vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza mbi 16 vjeç, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) mbi legjislacionin e përmirësuar në lidhje me të drejtat pronësore të tyre, me fokus të drejtën e pronësisë mbi tokën bujqësore, si dhe fuqizimi i kapaciteteve të profesionisteve e profesionistëve për të mundësuar ushtrimin e këtyre të drejtave.		**MSHMS**	**Agjencia Shtetërore e Kadastrës, NJVV, IAL, OJF, org. ndërkombëtare**	**6M-I- 2022 – 6M-II- 2025**
I.2.1.a) Përgatitja e fletëpalosjeve / broshurave informuese mbi të drejtat pronësore të grave, të të rejave dhe të vajzave, regjistrimin dhe transferimin e pronësisë sipas regjimit martesor apo në bashkëjetesë, legjislacionin fiskal dhe incentivat, përfshirë dhe pronësinë mbi tokën bujqësore.	*10,000 fletëpalosje të prodhuara dhe shpërndara në të gjithë vendin*	***MSHMS***	*Agjencia Shtetërore e Kadastrës, MBZHR, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I- 2022 – 6M-II- 2022*
*I.2.1.b) Takime (ballë për ballë) me gra, të reja dhe vajza nga të gjitha grupet (*nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.)*, në mbarë vendin.*	*180 takime të zhvilluara në mbarë vendin*	***MSHMS***	*Agjencia Shtetërore e Kadastrës, MBZHR, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2022 – 6M-II- 2025*
I.2.1.c) Emisione televizive të zhvilluara në TVSH dhe TV private me tematikë të drejtat pronësore të grave, të të rejave dhe të vajzave.	*10 emisione televizive të zhvilluara*	***MSHMS***	*Agjencia Shtetërore e Kadastrës, MBZHR, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2022 – 6M-II- 2025*
I.2.1.d) Publikimi i informacioneve në internet dhe në mediat sociale.	*1 link i hapur në faqen zyrtare të ministrisë dhe informacione të publikuara në mediat sociale*	***MD /Drejtoria e Ndihmës JuridikeFalas***	*Klinikat e ligjit, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I- 2022 – 6M-II- 2025*
I.2.1.e) Fuqizimi i kapaciteteve të studenteve e studentëve të Fakultetit të Drejtësisë mbi aksesin në drejtësi	*160 leksione online të*	***IAL (Fakultetet e***	*, MBZHR, OJF, org.*	*6M-I- 2022*

dhe të drejtat pronësore të grave, përfshirë dhe pronësinë mbi tokën bujqësore.	*zhvilluara (40 në vit) në vit në 10 fakultete të drejtësisë*	***Drejtësisë)***	*ndërkombëtare*	*– 6M-II- 2025*
I.2.1.f) Fuqizimi i kapaciteteve të punonjëseve dhe punonjësve të Qendrave të Ndihmës Ligjore Falas, për trajtimin e çështjeve që lidhen me të drejtat pronësore të grave, të rejave e vajzave, përfshirë pronësinë mbi tokën bujqësore, si dhe të drejtat martesore e regjimet pasurore.	*12 trajnime online të zhvilluara*	***ASPA***	*MSHMS, OJF, Org ndërkombëtare*	*6M-I- 2022 – 6M-II- 2025*
I.2.2. Nxitja dhe mbështetja e sipërmarrjes së grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj. etj), përfshirë dhe idetë inovatore që synojnë drejt ekonomisë mjedisore dhe digjitalizimit.		**MFE**	**Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, MBZHR, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë institucionet financiare qendrore, org. ndërkombëtare**	**6M-II-2021 - 6M-II-2025**
I.2.2.a) Analiza dhe vlerësimi i kuadrit ligjor dhe politikave fiskale që mundësojnë nxitjen e sipërmarrjeve të grave, të të rejave dhe të vajzave, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), përfshirë dhe sipërmarrjet me fokus tek teknologjia e informimit dhe ekonomia mjedisore, duke pasqyruar dhe ndikimin që kanë krizat si Covid – 19 tek sipërmarrjet e grave, të rejave dhe vajzave.	*1 raport i përgatitur, me gjetjet dhe rekomandimet*	***MFE***	*Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, MBZHR, MIE, institucionet financiare qendrore, Akademia, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2021 - 6M-I-2022*
I.2.2.b) Takim online për lancimin e gjetjeve nga analiza e kuadrit ligjor dhe të politikave.	*1 takim i zhvilluar*	***MFE***	*Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, MBZHR, MIE, institucionet financiare qendrore, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-I-2022*
I.2.2.c) Miratimi i masave/politikave që përmirësojnë situatën e grave dhe të rejave sipërmarrëse, i orientojnë në sektorët ku duhet të fokusohen bizneset e tyre, si dhe i ndihmojnë ato në rikuperimin e humbjeve nga COVID-19, apo nga situata të tjera të emergjencave civile e fatkeqësive natyrore.	*Lista me masa të propozuara dhe paraqitura për miratim Masat e miratuara*	***MFE***	*Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, MBZHR, MIE, institucionet financiare qendrore, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2025*
I.2.2.d) Sondazh mbi të drejtat pronësore të grave, të të rejave dhe të vajzave në zonat rurale dhe evidentimi i numrit të grave, të të rejave dhe të vajzave që gëzojnë pronësi mbi tokën bujqësore (baseline 2019-2021).	*1 raport i përgatitur me të dhënat përkatëse*	***MSHMS***	*INSTAT, MBZHR, ZRPP, NJVV, org. ndërkombëtarë*	*6M-II-2021 - 6M-I-2022*
I.2.2.e) Takim online për prezantimin e gjetjeve nga studimi mbi të drejtat pronësore të grave, të të rejave dhe të vajzave në zonat rurale.	*1 takim i zhvilluar*	***MSHMS***	*INSTAT, MBZHR, ZRPP, NJVV, org. ndërkombëtarë*	*6M-I-2022 - 6M-I-2022*
I.2.2.f) Subvencionimi i sipërmarrjeve të grave, të të rejave dhe të vajzave në zonat rurale dhe të grave, të rejave e vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), që zbatojnë ide inovatore me fokus tek digjitalizimi dhe ekonomia mjedisore.	*Grantet dhe kreditë e dhëna për të paktën 100 gra, të reja e vajza në vit*	***MFE***	*MBZHR, Min Shtet. Mbrojtjen e Sipërm, MIE Institucionet financiare qendrore, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2022 - 6M-II-2025*

I.2.2.g) Heqja e tarifave vendore për dy vitet e fillimit, për sipërmarrjet e grave, e të rejave dhe e vajzave në zonat rurale (përfshirë dhe heqjen e tarifës për ujin vaditës, drutë e zjarrit etj.), si dhe për sipërmarrjet e grave, e të rejave dhe e vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), në fushën e digjitalizimit dhe ekonomisë mjedisore.	*VKB e miratuar për heqjen e tarifave vendore në 15 bashki çdo vit dhe % e shtuar në buxhet*	***NJVV***	*Aleancat e Grave Këshilltare, MFE, Min Shtet. Mbrojtjen e Sipërm, MIE org. ndërkombëtarë*	*6M-II- 2022 – 6M-II- 2025*
I.2.2.h) Alokimi i fondeve, mbështetja dhe mentorimi (online dhe ballë për ballë) i grave, i të rejave dhe i vajzave, përfshirë dhe ato nga grupet e marxhinalizuara, në zonat suburbane dhe rurale, me qëllim që të mundësohen tek këto gra, të reja dhe vajza risitë teknologjike.	*% e fondeve e parashikuar për këtë qëllim dhe e rritur me 1% çdo vit*	***MFE***	*MBZHR, Min Shtet.Mbrojtjen e Sipërm, MIE MSHMS,NJVV, org. ndërkombëtarë*	*6M-I-2022 - 6M-II-2025*
I.2.2.i) Sondazh mbi të drejtat pronësore të grave, të të rejave dhe të vajzave në zonat rurale dhe evidentimi i numrit të grave, të të rejave dhe të vajzave që gëzojnë pronësi mbi tokën bujqësore (monitorim 2022 – 2024).	*1 raport monitorimi i përgatitur, me të dhënat përkatëse*	***MSHMS***	*INSTAT, MBZHR, ZRPP, NJVV, org. ndërkombëtarë*	*6M-I-2025 - 6M-II-2025*
I.2.2.j) Takim online për prezantimin e gjetjeve nga studimi mbi të drejtat pronësore të grave, të të rejave dhe të vajzave në zonat rurale.	*1 tryezë e zhvilluar*	***MSHMS***	*INSTAT, MBZHR, ZRPP, NJVV, org. ndërkombëtarë*	*6M-II-2025 - 6M-II-2025*
I.2.2.k) Mbledhja e të dhënave periodike mbi numrin e sipërmarrjeve të subvencionuara të grave, të të rejave dhe të vajzave në zonat rurale dhe të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), që zbatojnë ide inovatore me fokus tek digjitalizimi dhe ekonomia mjedisore.	*Të dhënat e publikuara periodikisht*	***MFE***	*MBZHR, INSTAT, MSHMS, ZRPP, NJVV, org. ndërkombëtarë*	*6M-II-2022 - 6M-II-2025*
I.2.2.l) Krijimi i mundësisë dhe nxitja e bashkëpunimit (apo iniciativave binjakëzuese) ndërmjet komunitetit të grave, të të rejave dhe të vajzave sipërmarrëse në Shqipëri dhe grave, të rejave e vajzave sipërmarrëse të Diasporës (në përputhje dhe me masat nr. 37, 38, 39, 44, 46, 47 dhe 50 të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Diasporës 2021 – 2025)	*Rrjeti i grave sipërmarrëse të diasporës i krijuar dhe të dhënat e kontaktimit lehtësisht të arritshme; Fuqizimi ekonomik i grave si temë e përfshirë në Samitin e Grave të Diasporës etj.*	***MEPJ***	*MSHD, MFE,MIE, MBZHR, MTM, MSHMS, Ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, NJVV, organizatat ndërkombëtare*	*6M-II-2021 – 6M-II-2025*
I.2.2.m) Përfshirja në strategjitë dhe planet e veprimit për mjedisin, i objektivave specifikë për barazinë gjinore, në përputhje me Konventat e RIOs, Marrëveshjet Shumëpalëshe Mjedisore, si dhe përfshirja e perspektivës gjinore në të gjitha fushat e projekteve që përgatiten (p.sh. në kuadër të IPA III).	*Komunikimet mjedisore, apo propozimet për investimet ndërkombëtare me perspektivën gjinore të integruar*	***MTM***	*OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2021 - 6M-II-2025*
I.2.3 Fuqizimi i kapaciteteve të shërbimeve këshilluese në nivel vendor dhe institucioneve përgjegjëse në nivel qendror, për ofrimin e shërbimeve të përgjigjshme gjinore për turizmin rural, agrobiznesin dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerës.		***MBZHR***	***AIDA, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare***	***6M-I-2022 - 6M-II-2023***
I.2.3.a) Trajnimi i shërbimeve këshilluese rurale dhe autoriteteve vendore përgjegjëse për shërbime të përgjigjshme gjinore lidhur me turizmin rural, agrobiznesin dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerës.	*Stafet e shërbimeve këshilluese rurale të*	***MBZHR***	*AIDA, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2021 -*

	trajnuar			*6M-II-2023*
I.2.3.b) Trajnimi i stafit përgjegjës për planifikimin, i stafit të financës dhe NBGJ në nivel vendor, mbi planifikimin nëpërmjet buxhetimit të përgjigjshëm gjinor të shërbimeve për turizmin rural dhe agrobiznesin, si dhe përfshirjen e tyre në PBA.	*Stafet e tri bashkive të pilotuara në këtë drejtim, të trajnuar*	***MBZHR***	*AIDA, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2022*
I.2.3.c) Fuqizimi i kapaciteteve të këshillave bashkiakë dhe Aleancave të Grave Këshilltare mbi problemet gjinore të grave rurale dhe adresimin e tyre në proceset vendore të buxhetimit.	*KB dhe AGK në tri bashkitë e synuara të trajnuar*	***MBZHR***	*AIDA, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2022*
I.2.4 Ndërtimi i kapaciteteve të grupeve të grave, të rejave e vajzave rurale për zhvillimin e aftësive të biznesit, qasjen në financim, si dhe veprime specifike të përbashkëta (siç janë blerja, kontrolli i cilësisë, tregtimi, marka, përpunimi dhe ruajtja e ushqimit).		**MBZHR**	***AIDA, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare***	***6M-I-2022 - 6M-II-2023***
I.2.4.a) Trajnime me grupet e grave, të rejave e vajzave rurale të identifikuara në tri bashki, për aftësimin e tyre në drejtim të biznesit.	*Grupet e grave të trajnuara*	**MBZHR**	*AIDA, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2023*

Objektivi specifik I.3:	**Zvogëlimi i barrierave që i mbajnë gratë, të rejat dhe vajzat larg tregut të punës, si dhe rritja e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), për punë të denjë edhe në sektorët jo-tradicionalë të punësimit, (në veçanti në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë).**		
Rezultatet e pritshme:	i. Programet e nxitjes së punësimit të zbatuara me efektivitet në të gjithë vendin, duke u dhënë prioritet grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet, sidomos nga grupet që pësojnë diskriminim të shumëfishtë, dhunë me bazë gjinore, dhunë në familje, trafikim apo praktika të dëmshme. ii. Numri i grave, i të rejave dhe i vajzave, nga të gjitha grupet, të cilat punojnë në sektorë jo tradicionalë, apo studiojnë në shkencë, teknologji, inxhinieri, matematikë, i rritur në mënyrë të përvitshme. iii. Konventa e ILO C190 mbi "Eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës" e njohur dhe e zbatueshme në Shqipëri. iv. Integrimi i grave, i të rejave dhe i vajzave, nga të gjitha grupet, në tregun e punës në nivel vendor i përmirësuar ndjeshëm si rrjedhojë e aplikimit të skemave të mbështetjes financiare të mbrojtjes sociale.		
Treguesit:	I.3.a) Përqindja e punëkërkueseve të papuna, të punësuara nëpërmjet ndërmjetësimeve të zyrave të punësimit ndaj totalit të punëkërkuesve të papunë të punësuar nga këto zyra punësimi, në shkallë vendi, disagreguar sipas moshës, grupeve të caktuara.	Baseline: 23,167 të punësuar nga ZP nga të cilat 58.4% gra në vitin 2020	Target: 0.5% me ndarje 60% gra dhe 40% burra
	I.3.b) Përqindja e grave, e të rejave dhe e vajzave nga të gjitha grupet, të punësuara në sektorë jo-tradicionalë (prodhim, ndërtim, industri nxjerrëse, energji, gaz dhe furnizimi me ujë).	Më 2019: (F) 16.2 % (M) 23.3 %	2% më shumë çdo vit, duke filluar nga viti 2023
	I.3.c) Numri i vajzave dhe të rejave, nga të gjitha grupet, të cilat studiojnë në Biologji, Biokimi, Mjediset natyrore dhe kafshët e egra, Kimi, Fizikë, Matematikë, Përdorim kompjuteri, *database* dhe disenjim rrjeti dhe administrim, Zhvillimi i *Software*-eve dhe aplikacioneve dhe analiza, Inxhinieri kimike dhe proceset, Elektriciteti dhe energjia, Elektronikë dhe automatizim, Mekanikë dhe tregtimi i metaleve, Automjetet motorike, anijet dhe avionët, Minierat dhe nxjerrja,	Për 2020: (F) 41.9% (M) 58.1 %	2% më shumë çdo vit duke filluar nga viti 2023 2% më shumë çdo

	Arkitektura dhe planifikimi i qytetit, Ndërtimi dhe inxhinieria civile, Peshkim, Veterinari, Terapia dhe rehabilitimi dhe Farmaci, në raport me totalin e vajzave që janë studente. I.3.d) Numri i të punësuarave/punësuarve, nga të gjitha grupet, që denoncojnë dhunë apo ngacmim në vendin e punës, disagreguar sipas gjinisë, moshës, dhe shumë faktorëve të tjerë individualë, si dhe sipas sektorit të punësimit. I.3.e) Numri i bashkive që shtojnë shërbimet sociale përmes mbështetjes nga Fondi Social.	Do të përcaktohet më 2022 16 bashki në vitet 2019-2020	vit 40 bashki në vitin 2025

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
I.3.1 Krijimi i mjedisit lehtësues dhe nxitës për përfshirjen e grave, të rejave dhe vajzave, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), në punë të denjë edhe në sektorët jo-tradicionalë, në përputhje dhe me veprimet e parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019 – 2022		**MFE**	**AKPA, AKAFP, AIDA, BDHTI, NJVV, MASR, DRAP/ZVAP, biznesi, OJF, org. ndërkombëtare**	*6M-II- 2021 – 6M-II- 2025*
I.3.1.a) Analiza e nevojave, kërkesave dhe trendit të tregut të punës për identifikimin e kushteve aktuale, pengesave për pjesëmarrjen e vajzave, të rejave dhe grave në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë, si dhe mbi mundësinë e përparimit drejt ekonomisë mjedisore dhe digjitalizmit.	*1 raport i përgatitur me gjetje dhe rekomandime*	***AKPA***	*MFE,ministritë e linjës, AIDA, BDHTI,Akademia, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2021 – 6M-I- 2022*
I.3.1.b) Takim online për lancimin e gjetjeve nga analiza e nevojave dhe trendit të tregut të punës.	*1 takim i organizuar*	***AKPA***	*AKAFP, MFE,ministritë e linjës, AIDA, BDHTI,OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I- 2022 – 6M-I- 2022*
I.3.1.c) Shtimi i stafit adekuat dhe kurseve të reja që ofrohen në Qendrat e Formimit Profesional, të përshtatura me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës, me fokus të veçantë gratë, të rejat dhe vajzat nga grupe të disavantazhuara, përfshirë dhe kurse / module falas për gratë, të rejat dhe vajzat me të ardhura të pamjaftueshme, që kanë të bëjnë me teknologjinë, digjitalizimin, të punuarit online etj.	*Staf adekuat për grupe të disavantazhuara dhe kurset e reja të shtuara në QFP*	***AKPA***	*MFE, AIDA, BDHTI, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2025*
I.3.1.d) Përgatitja e fletëpalosjeve/broshurave informuese mbi rëndësinë dhe mundësitë e ofruara nga AFP dhe të nxënit gjatë gjithë jetës për vajzat, djemtë, të rejat, të rinjtë, gratë dhe burrat në zonat urbane dhe rurale (siç parashikohet edhe në SKP 2019-2022, tek masat nën B6)	*10,000 fletëpalosje / broshura të përgatitura*	***AKPA***	*AKAFP, AIDA, BDHTI, MFE,OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2022 – 6M-II- 2022*
I.3.1.e) Takime informuese dhe orientuese me edukatoret, mësueset dhe mësuesit, si dhe me nxënëset dhe nxënësit e shkollave të mesme mbi rëndësinë e zgjedhjes së profesioneve jo tradicionale, si dhe rëndësinë e pjesëmarrjes së vajzave e të rejave në shkencë, teknologji, inxhinieri e matematikë, duke theksuar dhe mundësitë që ofrohen në këtë drejtim nëpërmjet AKPA.	*300 takime në vit zhvilluara në 61 bashki Më shumë edukatore, mësuese, mësues dhe nxënëse e nxënës të informuar*	***NJVV***	*AKPA, MFE, AIDA, BDHTI, MASR, DRAP/ZVAP, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2022 – 6M-II- 2025*
I.3.1.f) Vendosja e transportit për në qendrat e punës për gratë, të rejat dhe vajzat në zonat suburbane dhe rurale.	*10 biznese në vit sigurojnë transportin e grave dhe vajzave*	***NJVV***	*MFE, AIDA, BDHTI, Biznesi privat OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2022 - 6M-II-2025*

I.3.1.g) Ngritja e shërbimeve të kujdesit parashkollor (çerdhe/kopsht) për fëmijët e vegjël pranë qendrave të punës së prindërve, si dhe e alternativave të kujdesit pasdite për fëmijët e nënave të vetme, si shërbime pilote për t'u vlerësuar dhe shtrirë më pas në mbarë vendin.	*5 biznese e kanë pilotuar këtë shërbim*	***NJVV***	*MFE, AIDA, BDHTI, Biznesi privat OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2023 - 6M-II-2025*
I.3.2 Zbatimi i Konventës C190 të ONP mbi "Eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës", pas ratifikimit të saj, si dhe i direktivave përkatëse të BE për barazinë dhe mosdiskriminimin në botën e punës.		**MFE**	***KMD,* MSHMS, *Shkolla e Magjistraturës,* OJF, org. ndërkombëtare**	**6M-I- 2022 – 6M-II- 2025**
I.3.2.a) Përgatitja e fletëpalosjeve / broshurave mbi përmbajtjen e Konventës C190 të ONP mbi "Eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës".	*10,000 fletëpalosje / broshura të përgatitura*	***MFE***	*MSHMS, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I- 2022 – 6M-I- 2022*
I.3.2.b) Takime informuese me punëdhënëse / punëdhënës publikë e privatë dhe punëmarrëse/punëmarrës mbi përmbajtjen e Konventës C190 të ONP mbi "Eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës".	*120 takime në vit të organizuara*	***MFE***	*MSHMS, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2022 – 6M-II- 2025*
I.3.2.c) Trajnime me gjyqtare e gjyqtarë për të trajtuar çështje që lidhen me rastet e ngacmimit dhe dhunës seksuale, si dhe të diskriminimit gjinor në vendin e punës, bazuar në detyrimet që rrjedhin nga Konventa C-190, si dhe nga direktiva të tjera përkatëse të BE (p.sh. Direktiva 2006/54/KE etj.).	*5 trajnime në vit të organizuara*	***Shkolla e Magjistraturës,***	*MD, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2022 - 6M-II-2025*
I.3.2.d) Monitorimi vjetor i trajtimit gjyqësor të çështjeve me objekt "ngacmimin apo dhunën seksuale në vendin *e punës, si dhe diskriminimin gjinor në punësim".*	*1 raport monitorimi i përgatitur çdo vit*	***KMD***	*KLD AP, MSHMS, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II-2022 - 6M-II-2025*
I.3.3 Mbulimi më i mirë me shërbime sociale, nëpërmjet Fondit Social, për të lehtësuar integrimin e grave, të rejave dhe vajzave, nga të gjitha grupet, në vendin e punës.		**MSHMS**	**NJVV, Org. ndërkombëtare**	**6M-I- 2021 – 6M-II- 2025**
I.3.3.a) Rishikimi i Planeve Sociale të hartuara nga bashkitë, duke u thelluar tek analiza e nevojave dhe integrimi në to i perspektivës gjinore.	*61 bashki me plane sociale të rishikuara*	**MSHMS**	NJVV	6M-I- 2021 – 6M-II- 2025
I.3.3.b) Rishikimi i udhëzimeve për Fondin Social, për të përfshirë në propozime perspektivën gjinore dhe shënuesin Gender (G-marker).	*Udhëzimet e rishikuara*	**MSHMS**	Org. ndërkombëtare	6M-II- 2021 – 6M-I- 2022
I.3.3.c) Trajnimi i stafit të Drejtorisë/Sektorit të Shërbimit Social dhe Drejtorisë/Sektorit të Financës në bashki për shkrim projektesh duke përfshirë perspektivën gjinore dhe shënuesin Gender (G-marker).	*61 bashki me stafe të trajnuara*	**MSHMS**	NJVV	6M-I- 2021 – 6M-II- 2025
I.3.3.d) Zbatimi dhe monitorimi i projekteve të mbështetura nga Fondi Social.	*40 bashki ofrojnë më shumë shërbime sociale*	**MSHMS**	NJVV	6M-I- 2021 – 6M-II- 2025
I.3.3.e) Vlerësimi i ndikimit të ngritjes së shërbimeve të reja (të mbështetura nga Fondi Social) në rritjen e aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet në tregun e punës.	*Më shumë gra, të reja dhe vajza, nga të gjitha grupet, të punësuara, si rrjedhojë e shërbimeve sociale të ngritura*	**MSHMS**	NJVV	6M-I- 2021 – 6M-II- 2025

I.3.4 Përmirësimi i aksesit të grave, të të rejave dhe të vajzave rurale në tregun e punës përmes financimit të ndërmarrjeve sociale.		**MSHMS**	**SHSSH/DRSHS, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare**	**6M-I- 2021 – 6M-II- 2025**
I.3.4.a) Asistimi i organizatave që kërkojnë të aplikojnë për të fituar statusin e Ndërmarrjeve Sociale.	*OJF-të që aplikojnë për statusin e ndërmarrjeve sociale, të asistuara dhe të sqaruara*	***MSHMS***	*SHSSH/DRSHS, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I- 2021 – 6M-II- 2025*
I.3.4.b) Mbështetja financiare e OJF që kanë përfituar statusin e ndërmarrjeve sociale për krijimin e vendeve të reja të punës për gratë, të rejat dhe vajzat, kryesisht në zonat rurale.	*Më shumë ndërmarrje sociale të financuara* *Më shumë gra, të reja dhe vajza të papuna për një kohë të gjatë në zonat rurale, të punësuara në këto ndërmarrje sociale*	***MSHMS***	*SHSSH/DRSHS, NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I- 2021 – 6M-II- 2025*
Qëllimi strategjik II:	**Përmbushja e të drejtave të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.) për pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje të barabartë në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.**			
Objektivi specifik II.1:	**Krijimi i kushteve që mundësojnë pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë të grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTI+, të moshuar/moshuara, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), në vendimmarrjen politike e publike, në nivel vendor.**			
Rezultati i pritshëm:	i. Kuota të respektuara të barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes e përfaqësimit të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet në postet politike dhe publike.			
Treguesi	II.1.a) Përqindja e grave, e të rejave dhe e vajzave nga të gjitha grupet e përfshirë dhe përfaqësuar në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.		Baseline: Do përcaktohet 2021	Target: Rritur me 3% çdo dy vjet
MASAT DHE AKTIVITETET	**PRODUKTET**	**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS**	**INSTITUCIONET PARTNERE**	**AFATI KOHOR**
II.1.1 Zbatimi i kuadrit ligjor që mundëson pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e barabartë të grave, të të rejave dhe të vajzave, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.		**NJVV**	**MASR/DRAP/ZVAP, Aleanca e Grave Këshilltare, BtF, OJF, org. ndërkombëtare**	**6M-II- 2021 – 6M-II- 2030**
II.1.1.a) Takime informuese me vajza dhe djem, të reja e të rinj nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), për rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrjen politike e publike, duke promovuar dhe modelet pozitive të grave, të rejave e vajzave në vendimmarrje në të gjitha fushat.	*300 takime në vit të realizuara*	***MASR***	*DRAP/ZVAP, AKR NJVV, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2021 – 6M-I- 2025*

II.1.1.b)Trajnimi i punonjëseve dhe punonjësve të administratës shtetërore vendore përgjegjës për përfshirjen në dëgjesat publike të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), duke promovuar dhe modelet pozitive të grave, të rejave e vajzave në vendimmarrje në të gjitha fushat.	*60 trajnime në vit tërealizuara*	***NJVV***	*Aleanca e Grave Këshilltare, BtFOJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I- 2022 – 6M-II- 2022*
II.1.1.c) Mbledhja e të dhënave periodike për pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave dhe vajzave, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.	*Të dhëna mbi pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, të mbledhura periodikisht*	***INSTAT***	*NJVV, Aleanca e Këshilltareve, KQZ, BtF OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2022 – 6M-II- 2025*
II.1.1.d) Mbledhja/Prodhimi i statistikave gjinore për monitorimin e treguesve për secilin objektiv specifik nën qëllimin strategjik II, duke bërë dhe koordinimin me institucionet përgjegjëse për mbledhjen dhe standardizimin e të dhënave administrative.	*Statistika gjinore të prodhuara rregullisht Tregues të monitoruar*	***INSTAT***	*Të gjitha ministritë e linjës, institucionet e pavarura, NJVV-të, OSHC, Org. ndërkombëtare*	*6M-II-2021 - 6M-II-2025*
II.1.2 Studimi dhe monitorimi i fenomenit të dhunës ndaj grave, të rejave e vajzave në zgjedhje dhe politikë në nivelin vendor.		**NJVV**	*MB/AMVV, OSHC, Org. ndërkombëtare*	*6M-I-2023 - 6M-II-2023*
II.1.2.a) Studimi i pozicionimit të grave, të rejave e vajzave në listat zgjedhore dhe pjesëmarrjes e përfaqësimit të tyre në strukturat politike.	*Raporti i përgatitur me gjetje dhe rekomandime*	***NJVV***	*MB/AMVV, OSHC, Org. ndërkombëtare*	*6M-I-2023 - 6M-II-2023*
II.1.2.b) Prezantim i gjetjeve nga studimi.	*1 takim online i zhvilluar*	***NJVV***	*MB/AMVV, OSHC, Org. ndërkombëtare*	*6M-II-2023 - 6M-II-2023*
II.1.3 Përmirësimi i kuadrit ligjor për adresimin në mënyrën e duhur të seksizimit dhe dhunës ndaj grave, të rejave e vajzave në zgjedhje dhe politikë.		**MSHMS**	**AGD, Aleanca e Grave Këshilltare, AP, KMD, MSHMS, OSHC, Org. ndërkombëtare**	**6M-II-2023 - 6M-I-2025**
II.1.3.a) Analiza e kuadrit ligjor mbi pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e grave, të rejave e vajzave në politikë dhe evidentimi i nevojës për ndryshim, për adresimin siç duhet të seksizmit dhe dhunës ndaj tyre në zgjedhje dhe politikë	*Raporti i përfunduar me gjetje dhe rekomandime*	***MSHMS***	*AGD, AKK, AP, KMD, MSHMS, OSHC, Org. ndërkombëtare*	*6M-II-2023 - 6M-I-2024*
II.1.3.b) Përgatitja e draft projektligjit me ndryshimet përkatëse.	*Draft propozimet e përgatitura*	***MSHMS***	*AGD, AKK, AP, KMD, MSHMS, OSHC, Org. ndërkombëtare*	*6M-II-2024 - 6M-II-2024*
II.1.3.c) Miratimi i tyre në Kuvend.	*Ndryshimet e propozuara, të miratuara*	***Kuvendi***	*MD, AGD, AKK, AP, KMD, MSHMS, OSHC, Org. ndërkombëtare*	*6M-I-2025 - 6M-I-2025*
II.1.4 Fuqizimi i kapaciteteve të Aleancave të Grave Këshilltare dhe Komisioneve të Barazisë Gjinore për të zbatuar iniciativa që zvogëlojnë seksizmin dhe dhunën ndaj grave, të rejave e vajzave në politikë dhe gjatë proceseve zgjedhore, në bashkëpunim dhe me mbështetjen edhe të Aleancës së Grave Deputete.		**NJVV**	**Aleanca e Grave Deputete, AKK, AP, KMD, MSHMS, OSHC, Org.**	**6M-I-2025 - 6M-II-2030**

			ndërkombëtare	
II.1.4.a) Trajnime me AGK dhe Komisionet për Barazinë Gjinore në të gjithë vendin për të fuqizuar kapacitetet e tyre për ndërhyrje të tilla, në bashkëpunim dhe me mbështetjen edhe të Aleancës së Grave Deputete	*61 trajnime online të realizuara*	**NJVV**	*Aleanca e Grave Deputete, AKK, AP, AKK, KMD, MSHMS, OSHC, Org. ndërkombëtare*	*6M-I-2025 - 6M-II-2030*
II.1.5. Fuqizimi i kapaciteteteve të medias, për të paraqitur modele pozitive të grave, të të rejave dhe të vajzave lidere nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), në politikë dhe vendimmarrjen publike vendore.		***AMA***	**Fakulteti i gazetarisë, MSHMS, AP, KMD, MSHMS, OSHC, Org. ndërkombëtare**	**6M-I-2022 - 6M-II-2030**
II.1.5.a) Trajnime të vazhdueshme me gazetaret e gazetarët në lidhje me mënyrën e paraqitjes së modeleve pozitive të grave, të rejave e vajzave në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.	*90 trajnime online të zhvilluara (10 trajnime në vit)*	***AMA***	*Fakulteti i gazetarisë, MSHMS, AP, KMD, MSHMS, OSHC, Org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2030*
Objektivi specifik II.2:	**Përforcimi i qëndrimeve dhe sjelljeve shoqërore që nxisin pjesëmarrjen, përfaqësimin dhe udhëheqjen e barabartë të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.**				
Rezultati i pritshëm:	i. Shoqëri e hapur ndaj modeleve pozitive të grave, të të rejave dhe të vajzave nga të gjitha grupet, të cilat përfshihen, përfaqësohen dhe udhëheqin në mënyrë të barabartë çështje të lidhura me vendimmarrjen politike e publike vendore.			
Treguesi	II.2.a) Përqindja e popullsisë që mbështet modelet e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet, në vendimmarrjen politike e publike vendore.		Baseline: Do përcaktohet në 2021	Target Rritur me 2%çdo vit
MASAT DHE AKTIVITETET	**PRODUKTET**	**INSTITUCIONI PËRGJEGJËS**	**INSTITUCIONET PARTNERE**	**AFATI KOHOR**
II.2.1. Krijimi i mjedisit lehtësues për pranimin e modeleve të pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), në vendimmarrjen politike e publike në nivel vendor.		**NJVV**	**MB/AMVV, OJF, Aleanca e Grave Këshilltare, BtF, Akademia, DRAP/ZVAP, org. ndërkombëtare**	**6M-II- 2021 – 6M-II - 2025**
II.2.1.a) Publikimi i modeleve të grave, të të rejave dhe të vajzave, nga të gjitha fushat, të cilat kanë bërë histori ndër vite, duke evidentuar ndryshimet pozitive të sjella prej tyre.	*Publikim i botuar në 15 bashki në vit*	***NJVV***	MB/AMVV, *Aleanca e Grave Këshilltare, BtF, OJF, Akademia, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2021 – 6M-II- 2025*
II.2.1.b) Takime informuese me nxënëset dhe nxënësit në shkolla rreth historive të grave, të të rejave dhe të vajzave të cilat evidentohen si modele pozitive në publikimet e përgatitura, me pjesëmarrjen edhe të vetë grave të evidentuara si modele pozitive, në kuadër të ditëve të aktiviteteve mbi barazinë gjinore.	*45 takime të organizuara në vit në bashkitë ku është bërë publikimi*	***NJVV***	*Aleanca e Grave Këshilltare, BtF, DRAP/ZVAP OJF, Akademia, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2022 – 6M-II- 2025*
II.2.1.c) Emisione TV në mediat lokale mbi modelet e grave, e të rejave dhe e vajzave nga të gjitha fushat, të cilat kanë bërë histori ndër vite.	*15 emisione në vit të realizuara*	***NJVV***	MB/AMVV, *AKK BtF, Akademia, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I-2022 - 6M-II-2022*
Qëllimi strategjik III:	**Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje**			

Objektivi specifik III.1:	**Mbrojtja më e mirë e grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LBTI+, të moshuara, nëna të vetme, të mbijetuara të dhunës/trafikimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese etj.), nga të gjitha format e praktikave të dëmshme, seksizmit, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes përmirësimit të legjislacionit, zbatimit efektiv të tij, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për personat e dhunuar, ndëshkimin e dhunuesve dhe vënien në funksionim të programeve rehabilituese.**		
Rezultatet e pritshme:	i. Legjislacion i përmirësuar, veçanërisht për të siguruar ndalimin e të gjitha praktikave të dëmshme, seksizmit dhe formave të dhunës me bazë gjinore të papërfshira apo pasaktësuara ende, i cili zbatohet efektivisht. ii. Të gjithë llojet e programeve rehabilituese për dhunuesit të shtrira në të 12 qarqet e vendit.		
Treguesit:	III.1.a) Numri i propozimeve të paraqitura dhe miratuara në Kuvend në lidhje me përmirësimin e legjislacionit ekzistues penal dhe civil, për sa i takon ndalimit të praktikave të dëmshme dhe saktësimit apo përfshirjes së masave ndëshkuese për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, në përputhje me rekomandimet e GREVIO dhe CEDAW. III.1.b Numri i programeve rehabilituese për dhunuesit të ngritura dhe funksionale sipas standardeve të miratuara.	Baseline: Do përcaktohet në 2021 1 (2021)	Target: Të paktën 1 çdo 2 vjet 6 (2025)

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTET	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
III.1.1 Përmirësimi i legjislacionit për mbrojtje nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje, seksizmit e gjuhës së urrejtjes.		**MSHMS**	**MD, Nënkomisioni Parlamentar për BGJ&DHnG, AP, KMD, SHM, OJF, org. ndërkombëtare**	**6M-I- 2022 – 6M-II- 2030**
III.1.1.a) Analiza e kuadrit ligjor civil dhe penal mbi dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje, seksizmin dhe evidentimi i parashikimeve të cilat nuk ndalojnë apo favorizojnë praktika të dëmshme dhe steriotipa gjinore, si dhe masave që duhet të ndërmerren.	*Raporti i përgatitur me gjetje dhe rekomandime*	***MSHMS***	*MD, AP, KMD, SHM, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I- 2022 – 6M-II- 2022*
III.1.1.b) Takim online për prezantimin e gjetjeve nga analiza e kuadrit ligjor.	*1 takim i realizuar*	***MSHMS***	*MD, AP, KMD, SHM, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I- 2023 – 6M-I- 2023*
III.1.1.c) Përgatitja e projekt propozimeve për përmirësimin e legjislacionit ekzistues penal dhe civil, për sa i takon ndalimit të praktikave të dëmshme, seksizmit dhe saktësimit apo përfshirjes së masave ndëshkuese për të gjitha format e dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.	*Projekt propozimet e përgatitura të konsultuara*	***MSHMS***	*MSHMS, Nënkomisioni Parlamentar për BGJ&DHnG, AP, KMD, SHM, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-I- 2023 – 6M-II- 2023*
III.1.1.d) Paraqitja dhe miratimi në Kuvend.	*Rekomandimi A 12 i Komitetit të Palëve i realizuar*	***Kuvendi***	*Nënkomisioni Parlamentar për BGJ&DHnG, MSHMS, AP, KMD, SHM, OJF, org. ndërkombëtare*	*6M-II- 2023 – 6M-II- 2023*

Paketa e 8 (tetë) vendimeve të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave teknike e të kritereve të sigurisë, për kërkesat minimale të projektimit teknik, ndërtimit dhe operimit të sistemeve të transmetimit e të shpërndarjes së gazit natyror, të instalimeve të gazit natyror të lëngshëm, hapësirave të depozitimit dhe të linjave direkte".

KREU II

KRITERET DHE KËRKESAT PËR ROLIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TEKNIK DHE INDUSTRIAL (ISHTI) NË SEKTORIN E GAZIT NATYROR

Neni 4

Kërkesat për rrjetet e transmetimit, shpërndarjes, hapësirave të depozitimit nëntokësor, instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe linjave direkte të gazit natyror

1. Rrjetet e transmetimit, shpërndarjes, hapësirave të depozitimit nëntokësor, instalimeve

të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe linjave direkte të gazit natyror duhet të garantojnë sigurinë dhe efikasitetin energjetik të transportit të gazit natyror për parametrat e presionit dhe transmetimit, të përcaktuara nga dokumentacioni i projektit dhe kushtet e punës.

2. Projektimi, ndërtimi, rindërtimi, instalimi, operimi i rrjeteve të transmetimit, shpërndarjes, hapësirave të depozitimit nëntokësor, instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe linjave direkte të gazit natyror, të vendosura në zona me kushte të veçanta, duhet të kryhen duke marrë parasysh efektet në transmetimin, shpërndarjen, hapësirat e depozitimit nëntokësor, instalimet e gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe linjat direkte të gazit natyror, lidhur me terrenin, strukturën gjeologjike të tokës, praninë e minierave nëntokësore, kushtet sizmike, si dhe duke marrë parasysh madhësinë e këtyre efekteve me ndryshimet e kohës.

3. Në dokumentacionin e projektit duhet të vendosen kufijtë e zonave mbrojtëse të rrjeteve të transmetimit, të shpërndarjes, të hapësirave të depozitimit nëntokësor, të instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe të linjave direkte të gazit natyror, të cilat duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e rregullave teknike në fuqi për sektorin e gazit natyror, sikurse ato janë miratuar me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

4. Kërkesa të përgjithshme që duhet të merren parasysh gjatë projektimit të rrjeteve për transmetimin, shpërndarjen, hapësirat e depozitimit nëntokësor, instalimet e gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe linjat direkte të gazit natyror:

a) dokumentacioni i projektimit për rrjetet e transmetimit, shpërndarjes, hapësirave të depozitimit nëntokësor, instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe linjave direkte të gazit natyror duhet të jetë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për planifikimin e territorit dhe aktivitetet komerciale;

b) projekti duhet të hartohet nga ekspertë/subjekte të pajisur/a me certifikatën përkatëse, në përputhje me kërkesat e vendimit nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale, për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese, për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure", të ndryshuar, duke marrë parasysh vlerësimin e rrezikut të aksidenteve, rrezikun e zjarrit, situatat emergjente të lidhura dhe efektet e tjera të pafavorshme mbi njerëzit, pronësinë e individëve dhe personave juridikë, si dhe mjedisit, gjatë operimit të rrjetit të transmetimit, shpërndarjes, hapësirave të depozitimit nëntokësor, instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe linjave direkte të gazit natyror;

c) përzgjedhja e pajisjeve teknike dhe teknologjike, materialeve dhe ndërtimit të tubave dhe pajisjeve, veshjeve mbrojtëse, llojit dhe mënyrës së vendosjes së tubacioneve duhet të bëhet në përputhje me përcaktimet e rregullave teknike në fuqi për sektorin e gazit natyror, sikurse ato janë miratuar me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, duke marrë parasysh vlerat e presionit dhe temperaturës së gazit primar dhe gazit vendës, të dhënat hidrogjeologjike, kushtet natyrore dhe ndikimet e bëra nga njeriu.

Neni 5

Funksionet e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) në sektorin e gazit natyror

1. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është një institucion shtetëror i autorizuar, për:

a) inspektimin e kërkesave teknike për sistemin e transportimit dhe shpërndarjes, objektin e depozitimit të gazit natyror, instalimin, zhvillimin, operimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e objekteve të GNL-së, kërkesa, të cilat duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e rregullave teknike në fuqi për sektorin e gazit natyror, sikurse ato janë miratuar me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave;

b) respektimin e rregullave për aktivitetet e operimit të gazit natyror sipas licencave përkatëse; pajtueshmëria e tyre me termat dhe kushtet e aktiviteteve të licencuara të operatorëve të sistemit;

c) inspektimin e kritereve të sigurisë teknike për pajtueshmërinë me rregullat e sigurisë dhe besueshmërisë së sistemit të gazit natyror; të cilat duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e rregullave teknike në fuqi për sektorin e gazit natyror, sikurse ato janë miratuar me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, për të siguruar jetën e njerëzve dhe mbrojtjen e pronës, duke

vlerësuar në mënyrë jodiskriminuese të gjithë operatorët që sigurojnë ndërveprimin e sistemit dhe përcaktojnë kërkesat minimale për strukturën dhe operacionin teknik, të cilat zbatohen për lidhjen e objekteve të GNL-së me sistemet e tjera të transmetimit ose shpërndarjes dhe linjat direkte në sistem.

2. Në kryerjen e veprimtarive dhe kryerjen e funksioneve dhe detyrave të tij, ISHTI-ja, kur është e nevojshme, bashkëpunon me institucione dhe organe të tjera në respektim të përcaktimeve të pikës 11, të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 280, datë 1.10.2020, "Për miratimin e formës dhe të praktikave në marrëdhëniet ndërmjet strukturës përgjegjëse, që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror në ministri, dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror", për të arritur objektivat e mëposhtëm:

a) sigurimi i kushteve të përshtatshme për funksionimin efektiv dhe të besueshëm të rrjeteve të gazit natyror; të mbikëqyrë kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes;

b) nxitjen e zhvillimit të sistemeve të sigurta, të besueshme dhe efikase, jodiskriminuese, që janë të orientuara nga konsumatorët;

c) pajtueshmërinë me rregullat e menaxhimit të interkonektorëve dhe shpërndarjen e kapaciteteve të tyre; sigurimin e qasjes në sistemet;

ç) pajtueshmëria me sigurimin e furnizimit me gaz natyror dhe kërkesat e cilësisë së shërbimit;

d) zbatimin e rregullave kombëtare të menaxhimit të rrjetit të transportit të gazit natyror;

dh) monitorimin e kohës së marrë nga operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes për të bërë lidhjet dhe riparimet, dhe kushtet e qasjes për ruajtjen, funksionimin e linjës dhe shërbimet e tjera ndihmëse;

e) inspektimin e treguesve të kapacitetit teknologjik, teknik dhe menaxherial të operatorëve të gazit natyror dhe krijimin e një procedure për vlerësimin e tyre;

ë) lehtësimin e aksesit në sistemin për kapacitetin e ri të depozitimit të gazit natyror;

f) inspektimin e kërkesave standarde për zhvillimin e programeve të bashkërendimit për operatorët e sistemit të shpërndarjes dhe operatorët e sistemit të depozitimit.

3. Njësia përgjegjëse, në kuadër të Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI), që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror është Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK).

KREU III
STRUKTURA DHE DETYRAT FUNKSIONALE TË DREJTORISË SË SISTEMEVE TË GAZIFIKIMIT DHE IMPIANTEVE KOMBËTARE (DSGIK)

Neni 6
Struktura organizative e Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK)

Drejtoria e Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK) është pjesë përbërëse e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial.

1. Struktura e Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare, në zbatim të urdhrit të Kryeministrit nr. 105, datë 13.8.2020, "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial", përbëhet nga:

a) drejtori;

b) përgjegjësit e sektorit;

c) inspektorët.

2. Punonjësit e Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare emërohen dhe shkarkohen nga kryeinspektori, ata janë punonjës të kualifikuar dhe plotësojnë kriteret që përcaktohen në pikën 8, të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 280, datë 1.10.2020, "Për miratimin e formës dhe të praktikave në marrëdhëniet ndërmjet strukturës përgjegjëse, që mbulon aktivitetin e sektorit të gazit natyror në ministri, dhe inspektoratit shtetëror përgjegjës për sektorin e gazit natyror".

3. Veprimtaria funksionale e DSGIK-së ushtrohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, e organizuar në 4 sektorë:

- Sektori i Mbikëqyrjes dhe Ekspertizës Teknike;
- Sektori i Rajonit Qendror Tiranë, Durrës, Elbasan, Korçë;
- Sektori i Rajonit Verior Lezhë, Shkodër, Kukës, Dibër;
- Sektori i Rajonit Jugor Fier, Berat, Vlorë, Gjirokastër.

Neni 7
Detyrat funksionale të DSGIK-së

1. DSGIK-ja përgjigjet për ushtrimin e kontrollit, për:

a) zbatimin dhe respektimin e normave dhe të kushteve teknike në ndërtimin dhe përdorimin e instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse, nga personat fizikë dhe juridikë, që kryejnë veprimtari në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 102/2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, në përputhje me përcaktimet e rregullave teknike në fuqi për sektorin e gazit natyror, sikurse ato janë miratuar me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave;

b) zbatimin e kushteve të përcaktuara në licencat apo autorizimet përkatëse, që u janë dhënë personave fizikë dhe juridikë, që ato të respektojnë normat teknike për mbrojtjen ndaj zjarrit dhe ruajtjen e mjedisit gjatë përdorimit dhe shfrytëzimit të instalimeve, impianteve dhe pajisjeve përkatëse në sektorin e gazit natyror, përfshirë depozitat bregdetare të GNL-së dhe territorin e brendshëm;

c) respektimin e treguesve cilësorë të standardeve apo rregullave shtetërore për cilësinë e gazit natyror, për parandalimin e abuzimeve dhe të falsifikimeve, nëpërmjet marrjes së mostrave të produkteve të gazit që transportohet, depozitohet dhe përdoret në tregun e brendshëm të Republikës së Shqipërisë.

2. DSGIK-ja bashkërendon punën dhe kërkon çdo informacion të nevojshëm me OMVK-në për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet që ushtrojnë veprimtari në sektorin e gazit natyror dhe konsumatorët e mëdhenj industrialë.

Neni 8
Detyrat dhe të drejtat e punonjësve të Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK)

8.1 Drejtori i Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK)

Organizon dhe drejton punën e drejtorisë, për zbatimin e programeve vjetore të hartuara e të miratuara, si edhe të detyrave operative, dhe mban përgjegjësi për funksionimin e DSGIK-së për realizimin e detyrave funksionale, përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

1. Drejtori i Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare emërohet e shkarkohet nga kryeinspektori.

2. Ka në varësi përgjegjësit e sektorëve dhe inspektorët e DSGIK-së.

3. Deri në datën 25 tetor të çdo viti, harton dhe dorëzon te kryeinspektori, për vitin pasardhës:

a) programin e aktivitetit vjetor të kontrollit për standardin e cilësisë së gazit të importuar, të prodhuar në vend dhe që tregtohen në vend;

b) programin e kontroll-inspektimit vjetor në instalimet, impiantet dhe pajisjet përkatëse, të përdorura nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në fushën e transportimit, shpërndarjes dhe tregtimit të gazit natyror dhe për respektimin e normave dhe të rregullave teknike në përdorimin e instalimeve të tyre;

c) planin e nevojave e të shpenzimeve vjetore për veprimtarinë e drejtorisë së tij;

d) planin e të ardhurave vjetore, për çdo burim të tyre, sipas llojit të shërbimeve që kryen;

e) projektet, objektivat dhe aktivitetet e detajuara të veprimtarisë së DSGIK-së për vitin pasardhës;

f) programet vjetore të trajnimit të personelit.

4. Respekton etikën dhe figurën zyrtare për shkak të detyrës.

5. Në fillim të muajit gusht të vitit në vazhdim paraqet para kryeinspektorit Programin Paraprak dhe brenda datës 25 tetor paraqet programin përfundimtar të zhvillimit vjetor të DSGIK-së për vitin pasardhës.

6. Në afatet e kërkuara nga ministria, paraqet para kryeinspektorit, programet e zhvillimit afatmesëm dhe afatgjatë të DSGIK-së.

7. Në muajin korrik të çdo viti dhe në fund të muajit janar të vitit pasardhës paraqet para kryeinspektorit "Raportin e veprimtarisë 6-mujore dhe vjetore të DSGIK-së".

8. Grumbullon informacionet përkatëse nga inspektorët dhe përgjegjësit e sektorëve për realizimin e programeve dhe të detyrave funksionale.

9. Organizon mbajtjen dhe përditësimin e të dhënave statistikore të veprimtarisë së çdo sektori të DSGIK-së.

10. Vetë ose nëpërmjet punonjësve të tjerë të DSGIK-së jep informacione në median e shkruar dhe vizive për aktivitetin e DSGIK-së dhe problemet e tregut të gazit natyror.

11. Miraton programet e punës mujore të përgjegjësve të sektorit dhe sipas rastit të inspektorëve.

12. Organizon grupe kontrolli për evidentimin për respektimin e standardeve, normave dhe kushteve teknike të sigurisë e të MNZ-së, nga operatorët ekonomikë që ushtrojnë veprimtari në rrjetin e transportimit, shpërndarjes, depozitave nëntokësore të gazit natyror, si dhe terminaleve të GNL-së, konform programeve mujore e vjetore të miratuar nga kryeinspektori ose detyrave operative, në respektim të përcaktimeve në kreun II, "Mënyra dhe procedura e inspektimit", të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 279, datë 1.10.2020, "Për përcaktimin e rregullave për ushtrimin e funksionit mbikëqyrës të ministrisë, në aktivitetin e operatorëve të gazit natyror, për koordinimin e operacioneve në terren".

13. Kryeson grupin e këqyrjes për raste të ngjarjeve të renda shkaktuar në sektorin e gazit natyror, me pasoja në jetën e njerëzve, pronën dhe mjedisin, duke iu referuar edhe përcaktimeve të udhëzuesit teknik G 1002, shkurt 2015, "Siguria në furnizimin me gaz, organizimi dhe menaxhimi në një situatë krize" (përfshirë në VKM-në nr. 663, datë 10.10.2019).

14. Me miratim të kryeinspektorit, organizon ekipe kontrolli të befasishme në treg, në zona dhe në prefektura të veçanta për respektimin e kushteve teknike të instalimeve dhe standardeve të cilësisë së gazit natyror me qëllim sondazhi.

15. Organizon dhe bashkërendon punën me OMVK-në për respektimin e normave dhe kushteve teknike në instalimet e sektorit të gazit natyror.

16. Organizon punën dhe pajis me infrastrukturën e nevojshme inspektorët për kryerjen e inspektimeve *online*.

17. Shqyrton shkeljet administrative, në respektim të kërkesave të urdhrit të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 184, datë 17.6.2020, "Për përcaktimin e rregullave për kushtet dhe procedurat e vendosjes së gjobave dhe masën e tyre, për shkeljet në aktivitetet në sektorin e gazit natyror", të sjella nga inspektorët, dhe përgatit dosjen e materialet për komisionin e ankimit pranë ISHTI-t.

18. Kontrollon punën e përgjegjësve të sektorit dhe inspektorëve për mbajtjen dhe plotësimin e dosjeve të subjekteve të gazit natyror në të gjithë vendin.

19. Merr pjesë në hartimin e programeve të bashkëpunimit të ISHTI-t me institucione të tjera dhe ndjek e realizon detyrat e drejtorisë së tij të përfshira në program.

20. Ndjek dhe përgatit korrespondencën përkatëse shkresore.

21. Në bashkëpunim me strukturat e ISHTI-t, përgatit modelet e dokumentacionit teknik, aktet e kontrollit tip dhe çdo dokumentacion tjetër për ushtrimin e kontrolleve e të inspektimeve në të gjithë subjektet që ushtrojnë aktivitet në sistemet e transmetimit, shpërndarjes, hapësirave të depozitimit nëntokësor, instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe linjave direkte të gazit natyror, si dhe kërkon zbatimin e një procedure dhe dokumentimi standard të veprimtarisë së kontrollit të DSGIK-së, në përputhje me ligjin nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

22. Me miratim të kryeinspektorit, merr pjesë në ekipe studimi për hartimin e normave e të rregullave e standardeve të reja teknike për instalimet e gazit natyror, si edhe përdorimin me aromatik të gazit natyror.

23. Ndjek dhe përditëson në mënyrë të vazhdueshme literaturën, me shtesat dhe ndryshimet e standardeve e të rregullave teknike të detyrueshme për zbatim për normat e kushtet teknike të sigurisë, të miratuara me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, si dhe vënien e tyre në dispozicion të strukturave të DSGIK-së.

24. Azhurnohet me literaturën teknike në fushën e projektimeve, ndërtimeve dhe funksionimit të instalimeve për transmetimin, shpërndarjen, hapësirat e depozitimit nëntokësor, instalimet e gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe linjat direkte të gazit natyror, si: impiante përpunimi, tubacione transporti, terminale portuale, shkarkime detare e hekurudhore, depozitime stacionare të gazit natyror, duke kërkuar që këto aktivitete të kryhen në përputhje me kërkesat e vendimit nr. 551, datë 18.6.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure", të ndryshuar.

25. Organizon, rakordon dhe ndjek bashkëpunimin e brendshëm të DSGIK-ut me strukturat e tjera të ISHTI-së, për realizimin e detyrave të përbashkëta, si edhe me organe brenda e jashtë vendit.

26. Ndjek realizimin e të ardhurave nga shërbimet e drejtorisë së tij dhe nëpërmjet përgjegjësve të sektorëve rakordon e bashkëpunon me Sektorin e Financës në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme (DSHB) për realizimin e arkëtimit të shërbimeve të vitit, si edhe nga debitorët.

27. Bën vlerësimin e punës vjetore të përgjegjësve të sektorit, miraton vlerësimin për inspektorët, të përgatitur nga përgjegjësi i sektorit, dhe ia dorëzon kryeinspektorit.

28. Kontrollon dhe miraton shërbimet për dieta të punonjësve të strukturës së tij.

8.2 Përgjegjësi i Sektorit Rajonal pranë Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare

1. Përgjegjësi i sektorit pranë Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK), emërohet e shkarkohet nga kryeinspektori.

2. Ka në varësi inspektorët e DSGIK-së të sektorit të tij.

3. Deri më datë 15 tetor të çdo viti, harton dhe dorëzon te drejtori për vitin pasardhës:

a) projektprogramin e kontroll-inspektimit vjetor të sektorit të tij në instalime, impiante dhe pajisjet përkatëse, të përdorura nga personat juridikë, që kryejnë veprimtari në fushën e gazit natyror, për respektimin e normave dhe të kushteve teknike në përdorimin e tyre;

b) projektplanin e të ardhurave vjetore, për çdo burim të tyre, sipas llojit të shërbimeve që kryen sektori i tij.

4. Organizon, ndjek e kontrollon punën e sektorit për zbatimin e programeve vjetore e mujore të hartuara e të miratuara, si edhe të detyrave operative e të përditshme të ngarkuara në sektorin që mbulon dhe përgjigjet para drejtorit për realizimin me cilësi dhe korrektese të tyre.

5. Respekton etikën dhe figurën zyrtare për shkak të detyrës në ushtrimin e kontrollit në subjekte.

6. Pajis çdo inspektor me një kopje të planit të miratuar nga drejtori për kontrollin në subjektet e sektorit të gazit natyror.

7. Kërkon dhe grumbullon informacionet përkatëse nga inspektorët për realizimin e programeve dhe të detyrave funksionale.

8. Përpunon dhe i dorëzon drejtorit informacionet e shkruara të aktivitetit mujor, tremujor dhe vjetor të sektorit të tij.

9. Hap dhe mban të përditësuara të dhënat statistikore të veprimtarisë së sektorit të tij dhe ia dorëzon drejtorit çdo tre muaj.

10. Ndjek realizimin e të ardhurave nga shërbimet e sektorit të tij dhe rakordon e bashkëpunon me Sektorin e Financës në Drejtorinë e Shërbimeve të Brendshme për realizimin e arkëtimit të shërbimeve të vitit, si edhe të debitorëve.

11. Mban kontakt me inspektorët gjatë ditës së punës, në lidhje me vendndodhjen dhe realizimet e detyrave dhe informon kryeinspektorin dhe drejtorin në çdo rast që i kërkohet.

12. Informon kryeinspektorin dhe drejtorin për çdo konstatim me rendësi të veçantë, në lidhje me sigurinë teknike të instalimeve, impianteve dhe të pajisjeve të këtij tregu në sektorin që mbulon.

13. Dorëzon te drejtori propozimet për shkelje administrative të dhëna nga inspektorët dhe sektori i tij.

14. Hap dhe plotëson sistematikisht dosjen e veçantë për programet e miratuara të kontrollit, të kontrolleve të ushtruara e të masave apo sanksioneve të vendosura për rregullat teknike e të respektimit të masave të MNZ-së në çdo instalim, impiant, depozitë, pajisje e linjë teknologjike që ushtron aktivitet konform ligjit nr. 102/2015, datë 23.9.2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

15. Përgatit për drejtorin dhe mban një kopje të korrespondencës zyrtare me të gjitha subjektet e sektorit për të gjitha çështjet që kanë lidhje me respektimin e ligjshmërisë, normat teknike, cilësinë, sanksionet etj.

16. Harton informacione dhe materiale shkresore të sektorit për organe të ndryshme shtetërore dhe të qeverisjes vendore, caktuar dhe miratuar nga drejtori dhe kryeinspektori.

17. Ndjek, organizon, merr pjesë e përgjigjet për takimet me organe të ndryshme shtetërore e të pushtetit vendor të sektorit, caktuar dhe miratuar nga drejtori dhe kryeinspektori.

18. Merr pjese në ekipe kontrolli të përbashkëta me organe të tjera shtetërore ose të qeverisjes

vendore që lidhen me fushën e sektorit të gazit natyror, të sektorit që drejton të caktuar nga kryeinspektori.

19. Përgjigjet për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vlerave materiale të marra në përdorim (automjetin, pajisjet IT dhe çdo vlere tjetër të marrë në ngarkim).

20. Përgatit material për drejtorin për vlerësimin e punës vjetore të vartësve të tij dhe i propozon atij për masa disiplinore dhe shpërblime për ta.

21. Organizon dhe kontrollon shërbimet me dieta të inspektorëve të sektorit të tij dhe dorëzon te drejtori dokumentet përkatëse për miratim dhe pagesë.

8.3 Inspektori i sektorit rajonal pranë Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare

1. Inspektori i gazit pranë Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare emërohet e shkarkohet nga kryeinspektori.

2. Varet, raporton dhe përgjigjet para përgjegjësit të sektorit dhe drejtorit për veprimtarinë dhe realizimin me cilësi dhe korrektese të detyrave.

3. Respekton etikën dhe figurën zyrtare për shkak të detyrës në ushtrimin e kontrollit në subjekte.

4. Inspektori është i pavarur në kryerjen e detyrave në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj dhe me rregulloret e tjera dhe është personalisht përgjegjës për punën e tij.

5. Inspektori pajiset nga Inspektorati Qendror me Kartën e Identifikimit të Inspektorit për Sektorin e Gazit Natyror sipas urdhrit nr. 170, datë 8.6.2020, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, "Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së kartës së identifikimit për inspektorin që kryen inspektim teknik në sektorin e gazit natyror".

6. Mban kontakt dhe informon përgjegjësin e sektorit gjatë ditës së punës, në lidhje me vendndodhjen dhe realizimin e detyrave, si edhe për çdo konstatim me rëndësi të veçantë, në lidhje me sigurinë teknike të instalimeve, impianteve dhe pajisjeve të subjekteve përkatëse të gazit natyror, si dhe për cilësinë e gazit natyror.

7. Përgatit dhe dorëzon te përgjegjësi i sektorit informacione të shkruara mujore, tremujore dhe vjetore të punës së tij.

8. Ndjek dhe realizon ushtrimin e kontrollit për respektimin e normave dhe rregullave teknike në subjektet e caktuar nga përgjegjësi i sektorit dhe përgjigjet për vlerësimin e situatës, dokumentacionin dhe zbatimin e procedurave përkatëse.

9. Me porosi të përgjegjësit të sektorit përgatit dhe i dorëzon atij informacione dhe materiale shkresore për organe të tjera shtetërore dhe të qeverisjes vendore etj.

10. Ndjek dhe plotëson sistematikisht dosjet e subjekteve sipas detyrës së caktuar nga përgjegjësi i sektorit.

11. Me caktim të përgjegjësit të sektorit ose të drejtorit merr pjesë në takimet me komunitetin, qeverisjen vendore ose organe të tjera shtetërore.

12. Me caktim të përgjegjësit të sektorit ose të drejtorit merr pjesë në ekipe kontrolli të përbashkëta me organe të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore, caktuar nga kryeinspektori, për respektimin e normave e rregullave teknike, si edhe të masave e rregullave për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri në instalimet e gazit natyror.

13. Me caktim të drejtorit merr pjesë në grupe të studimeve për tematikat e normave dhe rregullave teknike dhe të cilësisë së gazit natyror.

14. Për njohje dhe zbatim korrekt të detyrës, grumbullon, sistemon dhe përditëson të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të funksionimit të kontrollit objekteve dhe instalimeve të gazit natyror.

15. Përgjigjet për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vlerave materiale të marra në përdorim (automjetin, pajisjet IT dhe çdo vlerë tjetër të marrë në ngarkim).

8.4 Përgjegjësi i Sektorit të Mbikëqyrjes dhe Ekspertizës Teknike

1. Përgjegjësi i Sektorit të Mbikëqyrjes dhe Ekspertizës Teknike pranë Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK) emërohet e shkarkohet nga kryeinspektori.

2. Ka në varësi inspektorët e DSGIK-së të sektorit të tij.

3. Respekton etikën dhe figurën zyrtare për shkak të detyrës.

4. Deri më datë 15 tetor të çdo viti, harton dhe dorëzon te drejtori për vitin pasardhës:

a) projektprogramin e kontroll-inspektimit vjetor të operatorëve ekonomikë mbi bazë risku në instalime, impiante dhe pajisjet përkatëse, të përdorura nga personat juridikë, që kryejnë

veprimtari në fushën e gazit natyror, për respektimin e normave dhe të kushteve teknike në përdorimin e tyre, bazuar mbi analizimet dhe vlerësimet e kryera;

b) projektplanin e të ardhurave vjetore, për çdo burim të tyre, sipas llojit të shërbimeve që kryen sektori i tij.

5. Koncepton, harton dhe përditëson në mënyrë të vazhdueshme metodologjinë e analizës dhe vlerësimit të operatorëve ekonomikë me risk për qëllime inspektimi.

6. Harton dhe përditëson me transparencë regjistrin total të riskut, në të cilën jepet një përmbledhje e të gjithë operatorëve ekonomikë që inspektohen nga DSGIK-ja.

7. Përcakton bazuar mbi peshën specifike në nivel risku, listën e operatorëve ekonomikë, të cilat duhet të inspektohen nga sektorët rajonalë të DSGIK-së.

8. Përgatit një evidencë përmbledhëse mujore për të gjitha rastet e evidentuara të operatorëve ekonomik, të cilat mund të paraqesin një nivel risku jo të pranueshëm, për miratim te drejtori.

9. Analizon informacione dhe të dhëna për operatorët ekonomikë në bashkëpunim me përgjegjësit e sektorëve rajonalë.

10. Kërkon dhe grumbullon informacionet përkatëse nga inspektorët në varësi të tij për realizimin e detyrave funksionale.

11. Mban të përditësuara të dhënat statistikore të veprimtarisë të sektorit dhe ia dorëzon drejtorit në mënyrë periodike.

12. Mbikëqyr aktivitetin e përditshëm të sektorit që mbulon dhe kërkon përgatitjen e raporteve periodike mujore nga inspektorët në varësi të tij.

13. Organizon, shpërndan dhe kontrollon punën e sektorit për zbatimin e programeve mujore e vjetore të hartuara dhe të miratuara, si dhe të detyrave operative të përditshme të ngarkuara në sektorin që mbulon dhe përgjigjet para drejtorit për realizimin me cilësi, korrektesë dhe në kohe të tyre.

14. Përpunon dhe ia dorëzon drejtorit informacionet e shkruara të aktivitetit mujor, tremujor, gjashtëmujor dhe vjetor të sektorit që mbulon.

15. Me miratim të kryeinspektorit, organizon ekipe kontrolli të befasishme në treg nga sektorët rajonalë të DSGIK-së, në zona dhe prefektura të veçanta për respektimin e kushteve teknike të instalimeve dhe standardeve të cilësisë së gazit natyror me qëllim sondazhi ose verifikim të ankesave dhe informacioneve të konsumatorit e publikut.

16. Mbikëqyr dhe koordinon mbledhjen, analizimin dhe përpunimin e informacioneve dhe të dhënave për subjektet që inspektohen nga sektorët rajonalë dhe orienton zbatimin uniform të metodologjisë së inspektimit, në përputhshmëri me legjislacionin kombëtar.

17. Përgatit udhëzime, procedura, standarde dhe dokumentacione mbi procesin e inspektimit dhe të kontrollit.

18. Ndjek realizimin e inspektimeve *online* të sektorëve rajonalë dhe dërgon te drejtori informacion mujore të inspektimeve të kryera mbi bazë drejtorie.

19. Përmbush çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga drejtori, konform ligjit dhe brenda fushës së detyrave funksionale.

8.5 Inspektori i Sektorit të Mbikëqyrjes dhe Ekspertizës Teknike

1. Inspektori i Sektorit të Mbikëqyrjes dhe Ekspertizës Teknike pranë Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare (DSGIK) emërohet e shkarkohet nga kryeinspektori.

2. Raporton dhe përgjigjet para përgjegjësit të sektorit dhe drejtorit për veprimtarinë dhe realizimin me cilësi dhe me korrektesë të detyrave.

3. Kryen detyrat që i ngarkohen konform legjislacionit në fuqi, në kohë dhe në cilësi, duke respektuar me rigorozitet kërkesat dhe parimet kryesore, si: objektiviteti, korrektësia, konfidencialiteti dhe profesionalizmi.

4. Respekton etikën dhe figurën zyrtare për shkak të detyrës.

5. Evidenton dhe përditëson regjistrin e operatorëve ekonomikë që inspektohen nga inspektorët e sektorëve rajonalë bazuar në indikatorë dhe në identifikimin e niveleve të riskut.

6. Harton dokumente të ndryshme për kërkim informacioni, kthim përgjigje sipas nevojave dhe rasteve të kërkuara nga përgjegjësi i sektorit.

7. Përveç detyrave dhe përgjegjësive të mësipërme, kryen edhe detyra të tjera, të ngarkuara nga drejtori.

8. Përgatit informacione rast pas rasti, në lidhje me punën, analizën, produktivitetin ose shmangiet e planit të inspektimit nga inspektorët e sektorëve

rajonalë, të kërkuara nga drejtori sipas kërkesave dhe legjislacionit në fuqi.

9. Koncepton raportet ku pasqyrohen përfundimet e konstatuara në bazë të procesit të monitorimit.

10. Zbaton metodikën dhe përditëson informacionet e kontrolleve të procesit të inspektimit nga inspektorët e sektorëve rajonalë.

11. Varet, raporton dhe përgjigjet para përgjegjësit të sektorit dhe drejtorit për veprimtarinë dhe realizimin me cilësi dhe korrektese të detyrave.

12. Inspektori është i pavarur në kryerjen e detyrës në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj dhe me rregulloret e tjera dhe është personalisht përgjegjës për punën e tij.

13. Inspektori pajiset nga Inspektorati Qendror me Kartën e Identifikimit të Inspektorit për Sektorin e Gazit Natyror sipas urdhrit nr. 170, datë 8.6.2020, të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, "Për miratimin e formës dhe përmbajtjes së kartës së identifikimit për inspektorin që kryen inspektim teknik në sektorin e gazit natyror".

14. Mban kontakt dhe informon përgjegjësin e sektorit gjatë ditës së punës, në lidhje me vendndodhjen dhe realizimin e detyrave, si edhe për çdo konstatim me rëndësi të veçantë, në lidhje me sigurinë teknike të instalimeve, impianteve dhe pajisjeve të subjekteve përkatëse të gazit natyror, si dhe për cilësinë e gazit natyror.

15. Përgatit dhe dorëzon te përgjegjësi i sektorit informacione të shkruara mujore, tremujore dhe vjetore të punës së tij.

16. Ndjek dhe realizon ushtrimin e kontrollit për respektimin e normave dhe rregullave teknike në subjektet mbi bazë risku të caktuara nga përgjegjësi i sektorit dhe përgjigjet për vlerësimin e situatës, dokumentacionin dhe zbatimin e procedurave përkatëse.

17. Me porosi të përgjegjësit të sektorit përgatit dhe i dorëzon atij informacione dhe materiale shkresore për organe të tjera shtetërore dhe të qeverisjes vendore etj.

18. Ndjek dhe plotëson sistematikisht dosjet e subjekteve sipas detyrës së caktuar nga përgjegjësi i sektorit.

19. Me caktim të përgjegjësit të sektorit ose të drejtorit merr pjesë në takimet me komunitetin, qeverisjen vendore ose organe të tjera shtetërore.

20. Me caktim të përgjegjësit të sektorit ose të drejtorit merr pjesë në ekipe kontrolli të përbashkëta me organe të tjera shtetërore ose të qeverisjes vendore, caktuar nga kryeinspektori, për respektimin e normave e rregullave teknike, si edhe të masave e rregullave për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri në instalimet e gazit natyror.

21. Në rast avarie apo aksidente në pajisjet/instalimet nën presion të operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e gazit natyror, inspekton dhe harton raportin në të cilin përcakton avarinë, shkaqet, përgjegjësitë dhe rekomandimet dhe sipas rastit, ia përcjell atë organeve kompetente.

22. Kryen inspektimin e operatorëve ekonomikë që ushtrojnë veprimtari në fushën e gazit natyror, në rastet e ankimeve dhe informacioneve të konsumatorëve publikë.

23. Me caktim të drejtorit merr pjesë në grupe të studimeve për tematikat e normave dhe rregullave teknike dhe të cilësisë së gazit natyror.

24. Për njohje dhe zbatim korrekt të detyrës, grumbullon, sistemon dhe përditëson të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të funksionimit të kontrollit objekteve dhe instalimeve të gazit natyror.

25. Përgjigjet për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e vlerave materiale të marra në përdorim (automjetin, pajisjet IT dhe çdo vlerë tjetër të marrë në ngarkim).

Neni 9

Të drejtat dhe detyrat e inspektorit rajonal pranë Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare

1. Aktivitetet e një inspektori të gazit natyror mund të kryhen nga individë të cilët kanë kryer studimet e larta pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakultetit të Shkencave të Natyrës që ka minimumi pesë vjet përvojë pune në këtë fushë, i cili është i pajisur me certifikatën e lejes profesionale në fushën e duhur sipas kërkesave të VKM-së nr. 551, datë 18.6.2015, "Për miratimin e kritereve dhe të procedurave për pajisjen me certifikatën e lejes profesionale për veprimtaritë studimore-projektuese dhe zbatuese për kërkimin, prodhimin, përpunimin, transportimin, depozitimin dhe tregtimin e lëndëve hidrokarbure", i ndryshuar, dhe i cili, gjithashtu, plotëson kërkesat e tjera të përcaktuara me ligj.

2. Inspektori është i pavarur në kryerjen e aktiviteteve në kuadër të kompetencave të përcaktuara me ligj dhe me rregulloret e tjera dhe është personalisht përgjegjës për punën e tij.

3. Inspektori i gazit kryen mbikëqyrje të objekteve të transmetimit, shpërndarjes, hapësirave të depozitimit nëntokësor, instalimeve të gazit natyror të lëngëzuar (GNL) dhe linjave direkte të gazit natyror, në përputhje me kompetencat e përcaktuara me këtë ligj. Inspektori i gazit natyror nuk kryen mbikëqyrjen e objekteve të tjera të gazit ose pajisjeve nën presion, në qoftë se ajo është e përcaktuar me një ligj tjetër.

4. Inspektori i sektorit të gazit natyror ka të drejtë dhe detyrë për të kontrolluar:

a) nëse është siguruar miratimi nga organi përgjegjës për ndërtimin e instalimeve të gazit natyror;

b) nëse dokumentacioni teknik për ndërtimin dhe instalimin e tubacioneve dhe pajisjeve të gazit është përgatitur në përputhje me ligjet, rregullat teknike dhe standardet;

c) nëse ndërtimi dhe testimi i pajisjeve të gazit është kryer në përputhje me ligjet, rregullat teknike dhe standardet;

ç) nëse tubacionet, stacionet e kompresorëve mirëmbahen rregullisht dhe nëse inspektimi i operatorit ekonomik është i rregullt, pasi testimi është kryer në përputhje me rregulloren dhe standardet teknike;

d) nëse punonjësit, që operojnë në sistemet e gazit natyror, janë pajisur me dëshmi për pajisjet dhe enët nën presion dhe personat plotësojnë kushtet e përcaktuara për kryerjen e këtyre detyrave;

dh) rregullsinë e dorëzimit dhe cilësinë e gazit natyror të dorëzuar për klientët.

Neni 10

Kompetencat e inspektorit rajonal pranë Drejtorisë së Sistemeve të Gazifikimit dhe Impianteve Kombëtare

1. Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes inspektuese, inspektorët e sektorit të gazit natyror janë të autorizuar:

a) të përcaktojnë detyra për eliminimin e parregullsive dhe riparimin e defekteve të tyre brenda një afati të caktuar;

b) të pezullojë ndërtimin e një objekti të gazit, pavarësisht instalimit të tubacioneve, pajisjeve dhe impianteve, nëse:

i. parregullsitë e përcaktuara dhe mangësitë nuk janë rregulluar brenda afatit kohor të specifikuar;

ii. ndërtimi i objekteve të gazit, pajisjeve, impianteve dhe instalimi kryhet pa miratimin e organit kompetent ose në kundërshtim me dokumentacionin teknik në bazë të të cilave u dha miratimi;

c) të ndalojë përdorimin e një objekti të gazit natyror, përkatësisht pajisjeve apo instalimeve, nëse:

i. funksionimi i një objekti të gazi, pajisje, impianti apo instalimi kërcënon jetën dhe shëndetin e njerëzve, pasurinë dhe mjedisin;

ii. parregullsitë e krijuara dhe mangësitë nuk janë korrigjuar brenda afatit të përcaktuar në vendimin për pezullimin e përdorimit ose gjatë shfrytëzimit të objektit;

iii. licenca për kryerjen e aktiviteteve të gazit natyror është revokuar për shkak të mosrespektimit të kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 102/2015, datë 23.9.2015, "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar.

2. Operatori ekonomik i gazit natyror, i cili ishte urdhëruar me vendim të inspektorit për të korrigjuar gabimet ose parregullsi është i detyruar të njoftojë inspektorin me shkrim për eliminimin e mangësive apo parregullsive brenda afatit të përcaktuar në vendim.

Neni 11

Dispozitat e fundit

1. Kjo rregullore është e detyrueshme për t'u zbatuar nga strukturat e ISHTI-it.

2. Mosrespektimi i kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi dhe përbën shkak për procedim disiplinor në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, si dhe Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 372/1, datë 8.7.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 372, DATË 11.6.2021, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, PËR ZBATIMIN E MASAVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19 NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE DHE INSTITUCIONET E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; nenit 9, të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve"; nenit 5, pika 6, të ligjit nr. 80/2020, "Për Policinë e Burgjeve"; pikës 5, të urdhrit nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, "Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale", me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, përcjellë me shkresën nr. 7125 prot., datë 5.7.2021,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 372, datë 11.6.2021, të ministrit të Drejtësisë, "Për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale", bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, germa "f", togfjalëshi "në jo më shumë se 2 (dy) persona", zëvendësohet me "në jo më shumë se 2 (dy) persona të rritur dhe 2 (dy) persona të mitur".

2. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit në Ministrisë e Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri.

3. Ngarkohen drejtori i përgjithshëm i Burgjeve, Sektori i Shëndetësisë në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe drejtuesit e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale për zbatimin e këtij urdhri. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

VENDIM
Nr. 33, datë 7.7.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHOQËRISË PËR ADMINISTRIMIN E AKTIVEVE"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të nenit 29, pika 10 të ligjit nr. 133 datë, 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë"; me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë për administrimin e aktiveve", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme me zbatimin e këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHOQËRISË PËR ADMINISTRIMIN E AKTIVEVE

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve për krijimin dhe funksionimin e shoqërisë për administrimin e aktiveve.

Neni 2
Subjektet

Subjekt i kësaj rregulloreje është shoqëria për administrimin e aktiveve.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim, të:

a) nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar (ligji "Për Bankën e Shqipërisë");

b) nenit 29, pika 10, të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", në vijim "ligji nr. 133/2016".

Neni 4
Qëllimi i krijimit të Shoqërisë për administrimin e aktiveve

Shoqëria për administrimin e aktiveve (në vijim "Shoqëria") krijohet me qëllim marrjen dhe administrimin e aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose bankës urë në funksion të instrumentit të ndarjes së aktiveve dhe në përputhje me strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Neni 5
Përkufizime

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat dhe përkufizimet e përdorur në ligjin nr. 133/2016 dhe në aktet nënligjore të Bankës së Shqipërisë.

KREU II
KRIJIMI DHE VEPRIMTARIA E SHOQËRISË PËR ADMINISTRIMIN E AKTIVEVE

Neni 6
Krijimi i Shoqërisë për administrimin e aktiveve

1. Shoqëria është person juridik, e organizuar në formën e një Shoqërie aksionare, e cila është tërësisht ose pjesërisht në pronësi të një ose më shumë autoriteteve publike, si dhe kontrollohet nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

2. Banka e Shqipërisë, kur e vlerëson të nevojshëm përdorimin e fondeve publike, i paraqet propozimin Ministrisë së Financave, me qëllim krijimin dhe financimin e kapitalit të Shoqërisë, si instrument i ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme merr vendimin për krijimin e Shoqërisë, si dhe miraton statutin e saj, të cilat depozitohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

4. Statuti i Shoqërisë përmban minimalisht:

a) emrin dhe adresën e selisë së Shoqërisë për administrimin e aktiveve;

b) objektin e veprimtarisë;

c) shumën e kapitalit fillestar;

d) organet drejtuese të Shoqërisë;

e) mënyrën e emërimit, numrin e anëtarëve dhe kompetencat e Këshillit Drejtues të Shoqërisë;

f) përcaktimin e mënyrës së shpërblimit dhe të pagesës së anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të nëpunësve të tjerë të Shoqërisë, si dhe të drejtat dhe detyrimet e tyre;

g) organizimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;

h) auditorin ligjor;

i. afatin e operimit të Shoqërisë.

Neni 7
Veprimtaria e shoqërisë për administrimin e aktiveve

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është administrimi i aktiveve, të drejtave ose i detyrimeve të transferuara pranë saj, me qëllim maksimizimin e vlerës së tyre nëpërmjet shitjes.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme përcakton rast pas rasti listën e aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve që i transferohen Shoqërisë.

3. Për të përmbushur objektivat dhe funksionet e Shoqërisë, Autoritet i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme:

a) miraton buxhetin e Shoqërisë;

b) miraton strukturën e saj organizative;

4. Për të arritur objektivat dhe qëllimet e saj, Shoqëria ushtron çdo të drejtë mbi aktivet, të drejtat ose detyrimet e transferuara, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 133/2016 dhe të kuadrit rregullativ të Bankës së Shqipërisë, si dhe në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

5. Për të përmbushur objektivat dhe funksionet e veprimtarisë së saj, Shoqëria kryen funksionet e mëposhtme:

a) administron aktivet e transferuara, me qëllim ruajtjen e vlerës së tyre, në përputhje me strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme në bankë;

b) ndërmerr përpjekjet më të mira për të arritur një kthim financiar kundrejt aktiveve që ka në administrim, duke marrë në konsideratë:

i. kostot për transferimin dhe trajtimin e aktiveve të bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose bankës urë;

ii. shpenzimet për themelimin dhe fondet e transferuara për krijimin e Shoqërisë;

iii. faktorë të tjerë që Shoqëria i konsideron të rëndësishëm për arritjen e qëllimeve të veprimtarisë së saj;

c) merr aktivet e transferuara nga banka në ndërhyrje të jashtëzakonshme ose banka urë, në përputhje me vendimet e përcaktuara nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

d) administron aktivet e transferuara (duke përfshirë mbledhjen e interesave të kredisë, principalit dhe kapitalit, si dhe sipas rastit, edhe të kolateralit nëse është e nevojshme);

e) kryen funksione të tjera, që lidhen me administrimin dhe shitjen e aktiveve të transferuara;

f) ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur, për të përmirësuar ose për të likuiduar vlerën e aktiveve të transferuara, ku përfshihen:

i. shitja në treg e kredive ose të portofolave të kredisë, në përputhje me çmimin më të mirë të mundshëm;

ii. titullzimin ose rifinancimin e portofolave të kredisë;

iii. mbajtjen, rifinancimin, shitjen ose shlyerjen e titujve financiarë përkatës;

g) lidh kontrata dhe marrëveshje me subjekte publike dhe private për përmbushjen e funksioneve të veprimtarisë së saj;

h) merr shërbime këshilluese e teknike të lidhura me përmbushjen e funksioneve të veprimtarisë së saj.

4. Për përmbushjen e veprimtarisë së saj, Shoqërisë mund t'i ushtrojë funksionet e përcaktuara në këtë nen:

a) më vetë ose në bashkëpunim me institucionet e nevojshme për zbatimin e detyrave përkatëse;

b) drejtpërdrejtë ose nëpërmjet një pale të tretë të kontraktuar për ofrimin e shërbimeve, në funksion të përmbushjes së veprimtarisë së Shoqërisë.

Neni 8

Strategjia dhe profili i rrezikut të Shoqërisë për administrimin e aktiveve

1. Shoqëria harton dhe propozon për miratim pranë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, si dhe zbaton strategjinë dhe profilin e rrezikut ndaj të cilit do të ekspozohet gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj.

2. Strategjia dhe profili i rrezikut përmban një përshkrim të rreziqeve më të rëndësishme, ndaj të cilave do të ekspozohet Shoqëria, parimet mbi të cilat sigurohet administrimi dhe ndërmarrja e këtyre rreziqeve dhe/ose politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, si dhe parashikimet për ushtrimin e funksioneve të kontrollit të brendshëm;

3. Në rast të ndryshimit të fakteve dhe të rrethanave mbi të cilat është hartuar strategjia e administrimit të rrezikut, Shoqëria mund të ndryshojë profilin e rrezikut dhe strategjinë e administrimit të rrezikut, duke njoftuar paraprakisht Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për këto ndryshime.

4. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme miraton, ndryshon ose refuzon ndryshimet e propozuara, sipas pikës 3 të këtij neni.

KREU III
ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË PËR ADMINISTRIMIN E AKTIVEVE

Neni 9
Organet e administrimit të Shoqërisë për administrimin e aktiveve

1. Shoqëria organizohet, drejtohet dhe kryen veprimtarinë e saj nëpërmjet Këshillit Drejtues, administratorit dhe personelit, siç përcaktohet në këtë rregullore.

2. Këshillit Drejtues ka këto kompetenca dhe detyra:

a) garanton kryerjen me cilësi, në kohë dhe me eficiencë të funksioneve të Shoqërisë të përcaktuara në nenin 7 në këtë rregullore;

b) përcakton dhe përshtat planin strategjik dhe financiar të Shoqërisë, në përputhje me strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

c) përcakton objektivat strategjikë të Shoqërisë, në përputhje me strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme;

d) garanton se ekzistojnë sistemet dhe procedurat e përshtatshme për të arritur objektivat strategjikë dhe ndërmerr të gjithë hapat e nevojshëm për të arritur këta objektiva;

e) drejton veprimtaritë me rëndësi të veçantë me palët e lidhura dhe ekspozimet e mëdha për aktivet e transferuara;

f) miraton politikën e administrimit të rrezikut, në terma të vlerësimit të eficiencës, efikasitetit të sistemeve të brendshme të kontrollit, si dhe përshtatshmërinë e praktikave organizative, administrative dhe kontabël;

g) miraton praktikat e brendshme të funksionimit të Shoqërisë;

h) ndërton komitete të brendshme, në përputhje me përmbushjen e objektivave të Shoqërisë;

i) siguron që llogaritë financiare të Shoqërisë të kontrollohen jo më pak se 1 herë në vit nga një ekspert kontabël i licencuar;

j) siguron se kontrollet mbi llogaritë financiare të kryhen në bazë të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit;

k) mbikëqyr procesin e informimit dhe të marrëdhënieve të komunikimit me publikun mbi procesin e administrimit të aktiveve të transferuara.

3. Funksionet e Administratorit të Shoqërisë janë:

a) vepron në emër të Shoqërisë dhe përfaqëson interesat e saj;

b) drejton administrimin e Shoqërisë dhe siguron përmbushjen e vendimeve të Këshillit Drejtues të Shoqërisë;

c) emëron punonjësit e Shoqërisë.

Neni 10
Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues i Shoqërisë përbëhet nga 5 anëtarë, përfshirë këtu edhe administratorin.

2. Anëtarët e Këshillit Drejtues të Shoqërisë dhe administratori emërohen nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për një afat trevjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

3. Kandidatët për anëtar të Këshillit Drejtues duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) arsim i lartë në ekonomik ose juridik;

b) nuk është i punësuar, pronar, bashkëpronar ose anëtar i ndonjë organi statutor të bankave të nivelit të dytë, me seli në Republikën e Shqipërisë;

c) nuk ka konflikt interesi me bankën në ndërhyrje të jashtëzakonshme dhe bankën urë, sipas legjislacionit në fuqi;

d) nuk është dënuar nga gjykata për vepra penale;

e) nuk është subjekt i hetimeve për vepra penale;

f) nuk është i përfshirë ose i lidhur me humbje financiare të shkaktuara nga veprimet e pandershme, të papërgjegjshme ose neglizhente, në lidhje me kryerjen e shërbimeve financiare dhe administrimin e subjekteve ose institucioneve të tjera.

4. Anëtarët e Këshillit Drejtues dhe administratori përmbushin kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi të përcaktuara në këtë nen, gjatë gjithë kohës që janë në detyrë.

Neni 11
Administrimi i Shoqërisë për administrimin e aktiveve

1. Në çdo rast, në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullative të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe në përputhje me statutin e

Shoqërisë, Këshilli Drejtues dhe Administratori i Shoqërisë bashkëpunojnë me Autoritetin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në përputhje me strategjinë e ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

2. Brenda 3 muajve nga data e themelimit të Shoqërisë, Këshilli Drejtues miraton aktet e mëposhtme:

a) kodin e etikës dhe rregulloret e brendshme për të punësuarit e Shoqërisë;

b) standardet dhe procedurat për trajtimin e aktiveve të transferuara, në përputhje me natyrën e tyre dhe kuadrit rregullator dhe kontabël në fuqi;

c) praktikat e administrimit të rrezikut, në përputhje me përmbushjen e objektivave dhe qëllime të veprimtarisë së Shoqërisë dhe profilit të portofolit të aktiveve të transferuara;

d) mënyrën e likuidimit/shitjes së aktiveve të transferuara dhe procedurat përkatëse për administrimin e këtij procesi.

3. Këshilli Drejtues, jo më vonë se 3 muaj nga data e krijimit të Shoqërisë, miraton krijimin e 4 komiteteve dhe anëtarët përkatës të Këshillit Drejtues që do të drejtojnë secilin komitet, si në vijim:

a) komitetin e kontrollit;

b) komitetin e kredisë;

c) komitetin e financës;

d) komitetin e administrimit të riskut.

Neni 12

Marrëdhëniet kontraktuale për shërbimet e ofruara nga palët e treta

1. Me qëllim përmbushjen e objektivave të veprimtarisë, Shoqëria mund të nënkontraktojë shërbime të ofruara nga palë të treta, në lidhje me administrimin, shitjen dhe likuidimin e aktiveve të transferuara.

2. Në kontratën e nënshkruar për shërbime të ofruara nga palët e treta, Shoqëria garanton se kjo palë:

a) vepron në përputhje me standardet më të larta të etikës dhe ofron të gjitha shërbimet e duhura teknike në kryerjen e aktivitetit të saj, sipas mandatit të dhënë për të promovuar interesat më të mira të Shoqërisë;

b) vendos në dispozicion burimet dhe procedurat e nevojshme për kryerjen me cilësi të shërbimit të ofruar;

c) ndërmerr çdo përpjekje të nevojshme për të parandaluar ose administruar konfliktin e interesit dhe për të deklaruar nëse ka ndonjë konflikt të tillë (aktual ose potencial) pranë Shoqërisë;

d) përmbush të gjitha standardet rregullative ndaj të cilave është subjekt;

e) bashkëpunon me Shoqërinë në procesin e certifikimit të pozicionit financiar të portofolit të aktiveve, për aq sa lidhet me shërbimin e ofruar ndaj Shoqërisë.

KREU IV

RAPORTIMET DHE MBIKËQYRJA E SHOQËRISË PËR ADMINISTRIMIN E AKTIVEVE

Neni 13

Llogaritë dhe regjistrat financiarë të Shoqërisë për administrimin e aktiveve

1. Shoqëria mban llogari dhe regjistra financiarë të veçantë, me qëllim që në çdo kohë të pasqyrohet qartë dhe saktë pozicioni financiar i Shoqërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe me standardet ndërkombëtare.

2. Në zbatim të pikës 1, llogaritë dhe regjistra financiarë të Shoqërisë identifikojnë në mënyrë të qartë:

a) fondet e transferuara për krijimin e Shoqërisë;

b) kostot e administrimit dhe shpenzimet e Shoqërisë për kryerjen e veprimtarisë së saj;

c) listën e portofolit të aktiveve, të drejtave ose detyrimeve te transferuara dhe vlerën e vlerësimit të bërë për çdo portofol;

d) listën e garancive (nëse ka) në mbështetje të aktiveve të transferuara;

e) çdo informacion tjetër të nevojshëm të komunikuar nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme;

3. Shpenzimet e Shoqërisë gjatë kryerjes së aktivitetit të saj mbulohen nga mjetet financiare në dispozicion të Shoqërisë të cilat përbëhen nga:

a) fondet e transferuara për krijimin e Shoqërisë;

b) të ardhura nga administrimi i aktiveve të transferuara;

4. Në zbatim të pikës 1, Shoqëria miraton, dokumenton dhe zbaton të gjitha politikat, procedurat dhe sistemet mbështetëse të nevojshëm për evidentimin e detajuar dhe të plotë, regjistrimin,

kontabilizimin, vlerësimin, administrimin, raportimin dhe shitjen e aktiveve, të drejtave ose detyrimeve te transferuara.

Neni 14
Raportimet

1. Shoqëria raporton çdo tre muaj pranë Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme në lidhje me aktivitetin e saj.

2. Raportimi tremujor përfshin informacion mbi tremujorin përkatës, në lidhje me:

a) numrin dhe vlerën e kredive në portofol dhe gjendjen e tyre të kategorizuar si performuese dhe kredi me probleme;

b) kreditë me probleme të kategorizuara sipas klasës së kredisë;

c) numrin dhe vlerën e kredive të shlyera;

d) palët e treta të kontraktuara për trajtimin e kredive përkatëse sipas portofolit;

e) një listë të të gjitha çështjeve ligjore mbi aktivet e transferuara duke përcaktuar:

i. objektin në shqyrtim

ii. palët e përfshira në proces

iii. qëndrimin e Shoqërisë mbi procesin

f) detajim të të ardhurave të marra sipas portofolit, si dhe të të ardhurave të arkëtueshme;

g) shumën e rimarrë nga shitja e aktiveve në portofol;

h) të ardhura të tjera të marra nga interesi i kredisë të transferuar pranë Shoqërisë;

i) bilancin financiar të aktiveve dhe detyrimeve të Shoqërisë;

j) rezultatin financiar dhe pasqyrën financiare të të ardhurave dhe shpenzimeve të Shoqërisë.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të kërkojë nga Shoqëria raportime shtesë, sipas formatit dhe frekuencës së nevojshme, në lidhje me:

a) përmbushjen e objektivave të Shoqërisë;

b) çdo informacion apo statistikë të nevojshme për vlerësimin e performancës së Shoqërisë në kryerjen e funksionit të saj.

Neni 15
Mbikëqyrja/kontrolli i Shoqërisë për administrimin e aktiveve

1. Shoqëria respekton kërkesat ligjore dhe nënligjore në fuqi, në lidhje me ushtrimin e veprimtarive të përcaktuara në vendimin e krijimit të saj dhe/ose sipas ndryshimeve të mëvonshme.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mbikëqyr/kontrollon veprimtarinë e Shoqërisë, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 133/2016 dhe të akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në rast se konstaton që administratori ose anëtarët e Këshillit Drejtues nuk veprojnë në përputhje me interesat dhe objektivat e përcaktuar, ka të drejtë të marrë masa ose të vendosë sanksione që i gjykon të nevojshme, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 133/2016 dhe të kuadrit rregullativ mbikëqyrës të nxjerrë në bazë dhe për zbatim të tyre.

Neni 16
Përfundimi i aktivitetit të Shoqërisë për administrimin e aktiveve

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vendos përfundimin e aktivitetit të Shoqërisë, kur plotësohet të paktën një nga kushtet e mëposhtme:

a) të gjitha aktivet, të drejtat dhe detyrimet e transferuara pranë Shoqërisë i janë shitur një pale të tretë ose janë likuiduar;

b) Shoqëria nuk plotëson më kërkesat dhe objektivat për të cilat është krijuar;

c) përfundon afati i përcaktuar në vendimin për krijimin e saj.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 34, datë 7.7.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E NORMAVE TË KONVERTIMIT TË DETYRIMEVE NË KAPITAL"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe të nenit 37, pika 4, të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë"; me propozim të

Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për kriteret për përcaktimin e normave të konvertimit të detyrimeve në kapital" sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë me zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E NORMAVE TË KONVERTIMIT TË DETYRIMEVE NË KAPITAL

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kritereve për vendosjen e raporteve të konvertimit të detyrimeve në kapital, gjatë ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit ose zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:

a) nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;

b. nenit 37, pika 4 të ligjit nr. 133/2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë".

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose të përdorur në:

a) ligjin nr. 133/2016, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë" (më poshtë referuar si "ligji nr. 133/2016");

b) ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

c) rregulloren nr. 44, datë 5.6.2019, "Vlerësimi për qëllime të ndërhyrjes së jashtëzakonshme".

2. Përveç sa përcaktohet në pikën 1, termi i mëposhtëm ka këtë kuptim:

a) "raporti i konvertimit" përcakton numrin e aksioneve ose titujve të pronësisë që përftohen nga konvertimi i një detyrimi të një klase të caktuar. Ky detyrim i konvertueshëm mund të jetë një instrument i vetëm ose një njësi vlere e një pretendimi kontraktual.

Neni 5
Kriteret për përcaktimin e raporteve të konvertimit

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbatohen raporte konvertimi të njëjtë, kur vlerëson se parimet dhe objektivat e ndërhyrjes së jashtëzakonshme arrijnë të përmbushen.

Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton raporte të ndryshme të konvertimit kur është e nevojshme për përmbushjen e dy kritereve të përcaktuara në pikën 2 dhe 3 të këtij neni.

2. Kriteri i parë për mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve përcakton se asnjë aksionar apo kreditor nuk duhet të pësojë humbje më të mëdha se humbjet që ata mund të pësonin nëse banka do

të ishte vendosur në procedurën e likuidimit të detyruar.

3. Kriteri i dytë për trajtimin e aksionarëve dhe kreditorëve sipas radhës së shlyerjes së detyrimeve përcakton se Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vendos raporte konvertimi të ndryshëm, nëse është e nevojshme për përmbushjen e objektivave të ndërhyrjes së jashtëzakonshme ose parimeve të përcaktuara në nenin 22, të ligjit nr. 133/2016 dhe në përputhje me radhën e shlyerjes së detyrimeve si më poshtë:

i. aksionarët e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme janë të parët që përballojnë humbjet;

ii. përveçse nëse përcaktohet ndryshe në ligjin nr. 133/2016, kreditorët e bankës mbartin humbjet pas aksionarëve, sipas radhës së shlyerjes së detyrimeve në procedurën e likuidimit të detyruar në përputhje me legjislacionin në fuqi; dhe

iii. kreditorët e së njëjtës klasë trajtohen në mënyrë të barabartë.

4. Në rast se Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vendos raporte konvertimi të ndryshme, përcakton raporte të tilla që garantojnë në mënyrë të arsyeshme se aksionarët ose kategoritë e kreditorëve (junior) të renditur më poshtë në radhën e shlyerjes së detyrimeve, nuk duhet të pësojnë humbje më të mëdha se humbjet që ata mund të pësonin nëse banka do të ishte vendosur në procedurën e likuidimit të detyruar (në rast të zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda). Në këtë rast, raportet e konvertimit për kategoritë e kreditorëve që konsiderohen më të preferuar (senior) në radhën e shlyerjes së detyrimeve, sipas procedurave të likuidimit të detyruar, nuk duhet të jenë në mënyrë disproporcionale të larta. Pretendimi për trajtim disproporcional lind në rast se do të pritej që këta kreditorë të kenë pretendime mjaft të larta sipas vlerësimit të kryer sipas nenit 14 të rregullores së vlerësimit.

Neni 6

Përmbushja e kriterit të parë për mbrojtjen e aksionarëve dhe kreditorëve

1. Kur Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton instrumentin e rikapitalizimit nga brenda, përcakton raporte konvertimi të tilla që për çdo aksionar ose kreditor, vlera e pritur e kapitalit dhe pretendimeve të tij pas zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, e përcaktuar sipas Kreut V të rregullores së vlerësimit, është e barabartë ose më e madhe se vlera e pritur që do të ishte realizuar nëse banka do të ishte likuiduar sipas procedurave të likuidimit të detyruar, e përcaktuar sipas nenit 14 në rregulloren e vlerësimit.

2. Në rast kur kompetencat e zhvlerësimit ose konvertimit ushtrohen në mënyrë të pavarur nga zbatimi i ndonjë instrumenti tjetër të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, dhe Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme zbaton raporte konvertimi të ndryshme, këto raporte janë të tilla që për çdo aksionar ose kreditor, vlera e pritur e trajtimit aktual që ata marrin (që përfshin vlerën totale të kapitalit dhe pretendimeve të tij pas ushtrimit të kompetencës), e përcaktuar sipas Kreut V të rregullores së vlerësimit, është e barabartë ose më e madhe se vlera e pritur që do të ishte realizuar nëse banka do të ishte likuiduar sipas procedurave të likuidimit të detyruar, e përcaktuar sipas nenit 14 në rregulloren e vlerësimit.

3. Në rast se pretendimet e kreditorit janë zhvlerësuar plotësisht, ato nuk kanë më asnjë vlerë. Në rast se detyrimi apo instrumenti është konvertuar në kapital, pretendimi në formën e kapitalit mund të ketë vlerë më të lartë, më të ulët ose të njëjtë me pretendimin fillestar që është konvertuar. Vlera e këtij pretendimi në formën e kapitalit është pjesë e vlerësimit të trajtimit aktual që ka marrë kreditori.

4. Në rast se vlera totale e pritshme e kapitalit që ka marrë kreditori i prekur, pas zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda ose ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit, është më e madhe se vlera totale e pretendimeve të borxhit të zhvlerësuar ose konvertuar, kriteri i parë i përcaktuar në nenin 5 në këtë rregullore, konsiderohet i përmbushur pa zbatimin e raporteve të ndryshme të konvertimit.

5. Në rast se vlera totale e pritshme e kapitalit që ka marrë kreditori i prekur, pas zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda ose ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit, është më e vogël se vlera totale e pretendimeve të borxhit të zhvlerësuar ose konvertuar, atëherë mund të jetë e nevojshme zbatimi i raporteve të ndryshme të konvertimit.

6. Në rast se zbatimi i raporteve të ndryshme të konvertimit është i nevojshëm për të parandaluar që kreditorët të pësojnë humbje më të mëdha se humbjet që ata mund të pësonin nëse banka do të ishte vendosur në procedurën e likuidimit të detyruar ose për të përmbushur objektivat e tjerë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme nuk vendos raporte të ndryshme konvertimi të cilat i transferojnë më shumë vlerë kreditorëve të preferuar (senior), se sa është e nevojshme për të përmbushur kriterin e dytë të përcaktuar në nenin 5 në këtë rregullore, për të parandaluar që kreditorët e preferuar (senior) të pësojnë humbje më të mëdha se humbjet që ata mund të pësonin nëse banka do të ishte vendosur në procedurën e likuidimit të detyruar, ose për të mbrojtur objektivat e tjerë të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

7. Për çdo kreditor pretendimi i të cilit është konvertuar plotësisht në kapital, vlera e pritshme e kapitalit duhet të jetë të paktën sa vlera e pritshme që do të kishte marrë në likuidim të detyruar.

8. Për çdo kreditor pretendimi i të cilit është konvertuar vetëm pjesërisht në kapital, vlera e pritshme e kapitalit duhet të jetë të paktën sa vlera e pritshme që do të kishte marrë në likuidim të detyruar, duke i zbritur vlerën e pritshme të pretendimit të mbetur të borxhit të tyre.

Neni 7

Përmbushja e kriterit të dytë për trajtimin e aksionarëve dhe kreditorëve sipas radhës së shlyerjes së detyrimeve

1. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vendos raporte konvertimi që sigurojnë, për aq sa është e mundur në mënyrë të arsyeshme, që kreditorët të mbartin humbjet në përputhje me radhën e shlyerjes së detyrimeve.

2. Në rast se një klasë e caktuar e kreditorëve pritet të pësojë humbje - domethënë, nëse pas zbatimit të instrumentit të rikapitalizimit nga brenda ose ushtrimit të kompetencave të zhvlerësimit dhe konvertimit, vlera e mbetur e pretendimeve mbi detyrimet dhe kapitalin e përcaktuar sipas Kreut V të rregullores së vlerësimit, është më e vogël se vlera e pretendimeve të asaj klase para ushtrimit të këtyre kompetencave, Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme vendos raporte konvertimi të barabarta me zero ose afër zeros, për të gjitha kategoritë e tjera të detyrimeve dhe instrumenteve që janë të renditura më poshtë në radhën e shlyerjes së detyrimeve, sipas procedurave të likuidimit të detyruar (junior).

3. Në përputhje me pikën 2 në këtë nen, aksionarët mbajnë të parët humbjet. Çdo vlerë e mbetur nga ndërhyrja e jashtëzakonshme, shpërndahet fillimisht për pretendimet e kreditorëve, sipas radhës se shlyerjes së detyrimeve në procesin e likuidimit . Zbatimi i raporteve të ndryshme të konvertimit synon të garantojë se kreditorët mbajnë humbjet pas aksionarëve, në përputhje me radhën e shlyerjes së detyrimeve sipas likuidimit të detyruar.

Këto raporte përcaktohen në mënyrë që të mundësojnë që aksionarët fillestarë (dhe aksionarët pretendimi i të cilëve rezultoi nga ushtrimi i kompetencës së zhvlerësimit dhe konvertimit), të ruajnë një pretendim me vlerë pozitive ose që kapitali të mund të shpërndahet në mënyrë proporcionale në dy ose më shumë klasa kreditorësh. Aksionarët mbajnë një vlerë pozitive të pretendimit të tyre, në rast se nuk është e nevojshme të zhvlerësohet asnjë kreditor, pra në rast se instrumenti i rikapitalizimit nga brenda kërkon vetëm ushtrimin e kompetencës së konvertimit ndaj kreditorit.

4. Kapitali mund të shpërndahet në mënyrë proporcionale në dy ose më shumë klasa kreditorësh, në rast se një klasë kreditorësh është konvertuar plotësisht në kapital por është e nevojshme që të ketë akoma më shumë konvertim, dhe konvertimi i pjesshëm ose i plotë i klasës së kreditorëve më të preferuar në radhën e shlyerjes së detyrimeve (senior) nuk ka rezultuar në humbje (kreditorët e radhës më të lartë (senior) marrin një vlerë totale pretendimi në formën e kapitalit dhe borxhit të paktën të barabartë me vlerën fillestare të pretendimit që kishin në formë borxhi).

KRYETAR I KËSHILLIT MBUKËQYRËS
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 35, datë 7.7.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES "PËR LLOJET E MARRËVESHJEVE QË DO TË MBROHEN NË TRANSFERIMIN E PJESSHËM"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe të nenit 59, pika 5 dhe nenit 87, të ligjit nr. 133/2016, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë"; me propozim të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren "Për llojet e marrëveshjeve që do të mbrohen në transferimin e pjesshëm" sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Bankën e Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen bankat e licencuara nga Banka e Shqipërisë, me zbatimin e këtij VENDIMI.
4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

RREGULLORE
PËR LLOJET E MARRËVESHJEVE QË DO TË MBROHEN NË TRANSFERIMIN E PJESSHËM

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i kushteve lidhur me llojet e marrëveshjeve të cilat mbrohen gjatë transferimit të pjesshëm të aktiveve, të drejtave dhe detyrimeve të një banke nën ndërhyrje të jashtëzakonshme.

Neni 2
Subjektet

Subjekte të kësaj rregulloreje janë bankat dhe degët e bankave të huaja, të licencuara nga Banka e Shqipërisë.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore nxirret në bazë dhe për zbatim të:
a) nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
b) nenit 59, pika 5 dhe nenit 87, të ligjit nr. 133, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë".

Neni 4
Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përkufizuar ose të përdorur në:
a. ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar;
b. ligjin nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
c. ligjin nr. 133/2016, datë 22.12.2016, "Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë", në vijim ligji nr. 133/2016.
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1, "Titullzimi" ka të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në nenin 4, pika 43 e rregullores nr. 48, datë 31.7.2013, "Për Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit", e ndryshuar.

Neni 5
Kushtet lidhur me marrëveshjet e garancisë përfshirë dhe titujt që financojnë transaksionet

1. Marrëveshjet e garancisë në përputhje me nenin 59, pika 1 shkronja "a", të ligjit nr. 133/2016 përfshijnë:

a) marrëveshjet që përfshijnë kushte garancie si dhe garanci personale;

b) marrëveshjet e pengut, hipotekë e barrë siguruese dhe interesa të tjerë të ngjashëm;

c) titujt të lidhura me transaksionet e huas së kolateralizuar, ku në këmbim të fondeve, huamarrësi transferon përkohësisht tek huadhënësi kolateral për gjithë kohëzgjatjen e huas, dhe i paguan huadhënësit një tarifë ose vlerë interesi.

2. Marrëveshjet e garancisë cilësohen si marrëveshje garancie në përputhje me nenin 59, pika 1, shkronja "a", të ligjit nr. 133/2016, vetëm nëse të drejtat ose aktivet, të cilat shërbejnë si garanci, qoftë edhe në rast të ekzekutimit të detyrueshëm, janë të identifikuar plotësisht ose janë të identifikueshëm në mënyrë të mjaftueshme në përputhje me kushtet e marrëveshjes dhe ligjit në fuqi.

Neni 6
Kushtet lidhur me marrëveshjet e kompensimit *set-off*

1. Marrëveshjet e kompensimit *set-off* lidhur midis një banke dhe një pale të vetme cilësohen si marrëveshje kompensimi *set-off* sipas nenit 59, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 133/2016, kur ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat financiare ose derivatet.

2. Marrëveshjet e kompensimit *set-off* lidhur midis një banke dhe një ose më shumë palëve cilësohen si marrëveshje kompensimi *set-off* sipas nenit 59, pika 1, shkronja "c" të ligjit nr. 133/2016 në rrethanat e mëposhtme:

a) kur marrëveshjet janë të lidhura me veprimtarinë e palës tjetër si një kundërpalë qendrore;

b) kur marrëveshjet kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet ndaj sistemeve të pagesave ose të shlyerjeve të titujve dhe janë të lidhura me veprimtarinë e tyre si sistem pagese ose shlyerje të titujve.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të vendosë, në raste të veçanta, që marrëveshjet e kompensimit *set-off* të lidhura midis një banke dhe një ose më shumë palëve, për aq sa ato lidhen me lloje të tjera të të drejtave dhe detyrimeve, përveç atyre të përmendura në pikat 1 dhe 2, mund të cilësohen si marrëveshje kompensimi *set-off* në përputhje me nenin 59, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 133/2016, ku marrëveshjet njihen për qëllime të zbutjes së rrezikut sipas rregullave prudenciale dhe mbrojtja, veçanërisht për të ruajtur mosndashmërinë, është një kusht për atë njohje.

Neni 7
Kushtet lidhur me marrëveshjet e kompensimit *netting*

1. Marrëveshjet e kompensimit *netting* të lidhura ndërmjet bankës dhe një pale të vetme cilësohen si marrëveshje kompensimi *netting* në përputhje me nenin 59, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 133/2016 ku ato kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontratat financiare ose derivatet.

2. Marrëveshjet e kompensimit *netting* të lidhura midis bankës dhe një ose më shumë palëve do të cilësohen si marrëveshje kompensimi *netting* në përputhje me nenin 59, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 133/2016 në rrethanat e mëposhtme:

a) kur rregullimet janë të lidhura me veprimtarinë e palës tjetër si një kundërpalë qendrore;

b) kur marrëveshjet kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet ndaj sistemeve të pagesës ose të shlyerjes së titujve dhe janë të lidhura me veprimtarinë e tyre si sisteme pagese ose shlyerje të titujve.

3. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme mund të vendosë, në raste të veçanta, që marrëveshjet e kompensimit *netting* të lidhura ndërmjet një banke dhe një ose më shumë palëve mund të cilësohen si një marrëveshje kompensimi *netting* në përputhje me nenin 59, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 133/2016, kur ato njihen për qëllimet e zbutjes së rrezikut sipas rregullave prudenciale dhe mbrojtja, veçanërisht për mosndashmërinë, është një kusht për atë njohje.

Neni 8
Kushtet e përgjithshme që zbatohen për marrëveshjet e garancisë, marrëveshjet e kompensimit set-off dhe netting dhe marrëveshjet e tjera financiare

1. Nenet 5, 6 dhe 7 në këtë rregullore nuk kufizojnë kompetencat e mëposhtme të Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme:

a) për të mbrojtur çdo lloj marrëveshjeje që mund të përfshihet në një nga klasat e shkronjave "a", "c", "ç", "dh" në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 133/2016, dhe të cilat në procedurat e likuidimit të detyruar mund të jenë objekt i një ndarjeje të përkohshme;

b) për të mbrojtur çdo lloj marrëveshjeje që nuk përfshihet në nenin 59, pika 1, të ligjit nr. 133/2016 dhe të cilat në procedurat e likuidimit të detyruar mund të jenë objekt i një ndarjeje të përkohshme.

2. Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, në raste të veçanta, mund të përjashtojë nga mbrojtja e dhënë në nenin 59, pika 2 të ligjit nr. 133/2016, marrëveshjet e garancisë, ose marrëveshjet e kompensimit *set-off* dhe *netting* që kanë të bëjnë me kontratat që përfshijnë klauzola të cilat, në raste paaftësie paguese të palës tjetër, lejon një palë me aftësi paguese të bëjë vetëm pagesa të kufizuara ose të mos bëjë pagesa ndaj palës në paaftësi paguese, edhe nëse kjo palë është një kreditore neto.

Neni 9

Kushtet në lidhje me marrëveshjet e tjera financiare, duke përfshirë titullzimet dhe instrumentet e përdorura për qëllime të zbutjes së rrezikut (*hedging*)

1. Marrëveshjet e tjera financiare të përmendura në nenin 59, pika 1, shkronja "dh" të ligjit nr. 133/2016 përfshijnë sa vijon:

a) titullzimet në të cilat ekspozimet themelore janë vendosur në transhe dhe janë transferuar me një transferim të plotë të titullit nga bilanci i palës inicuese në ndërhyrje të jashtëzakonshme (titullzim *true sale*). Në këto titullzime, çdo rol i palës iniciuese, duke përfshirë shërbimin e huas, ofrimin e çfarëdo forme të mbrojtjes ndaj rrezikut ose ofrimin e likuiditetit, konsiderohet si një detyrim që bën pjesë në marrëveshjet e tjera financiare.

b) titullzimet me anë të instrumenteve kontraktuale, kur aktivet themelore mbeten në bilancin e bankës në ndërhyrje të jashtëzakonshme (titullzim sintetik). Në këto titullzime, interesi i letrës me vlerë konsiderohet si e drejtë që bën pjesë në marrëveshjen financiare vetëm nëse është i bashkëngjitur në aktive të cilat janë mjaftueshëm të identifikuara ose të identifikueshme në përputhje me kushtet e marrëveshjes dhe ligjin në fuqi.

2. Marrëveshjet që përbëjnë një strukturë të titullzimit e cila mbulon marrëdhëniet e ndërsjella midis iniciuesve, emetuesve, trustees, ofruesit të shërbimit, administrimit të *cash*-it dhe kundërpalëve të *swap*-it apo mbrojtjes ndaj riskut të kredisë, konsiderohen se formojnë pjesë të marrëveshjeve të tjera financiare, nëse ato marrëdhënie reciproke janë të lidhura drejtpërdrejt me aktivet themelore dhe me pagesat që do të bëhen nga të ardhurat e gjeneruara nga këto aktive për mbajtësit e instrumenteve të strukturuara. Këto marrëdhënie reciproke përfshijnë detyrime dhe të drejta në lidhje me aktivet themelore, detyrimet nën instrumentet e emetuara dhe marrëveshjet e garancisë, përfshirë transaksionet derivative, të kërkuara për ruajtjen e fluksit të pagesave sipas këtyre detyrimeve.

3. Pika 2 në këtë nen, nuk cenon kompetencën e Autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për të vendosur, rast pas rasti dhe duke marrë në konsideratë strukturën specifike të marrëveshjeve të tjera financiare në përputhje me nenin 59, pika 1, shkronja "dh" të ligjit nr. 133/2016, që marrëveshjet e tjera midis palëve të përmendura në pikën 2, të tilla si marrëveshjet e shërbimit të huas, të cilat nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me aktivet themelore dhe pagesat që do të bëhen, të bëjnë pjesë në marrëveshjet e tjera financiare.

Neni 10

Identifikimi i marrëveshjeve sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore

Në përputhje me përcaktimet në këtë rregullore, banka kujdeset për identifikimin e marrëveshjeve sipas kushteve të përcaktuara në këtë rregullore dhe mbajtjen e një regjistri të veçantë për to.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

VENDIM
Nr. 37, datë 7.7.2021

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR ZOTËRIMIN NGA *ÇALIK HOLDING A.Ş.* TË 100 PËR QIND TË KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS KOMBËTARE TREGTARE SHA

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e", të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", i ndryshuar; të shkronjës "h", të pikës 1, të nenit 24, dhe nenit 25 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; si dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, e ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e 100 për qind të aksioneve me të drejtë vote të kapitalit aksionar të Bankës Kombëtare Tregtare sh.a., nga *Çalik Holding A.Ş.*
2. Ngarkohet Banka Kombëtare Tregtare sh.a. të njoftojë Bankën e Shqipërisë për përfundimin e transaksionit të përmendur në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gent Sejko

KËRKESË
Nr. 289, datë 13.7.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi projektit "Unaza lindore e Kavajës", me vlerë totale paraprake të shpronësimit 15,134,372.20 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy pikë njëzetë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Kavajë.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për interes publik për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

1. Për pasuritë e llojit "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".
2. Për pasuritë e llojit "ndërtesë", është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit në Bashkinë Kavajë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 15,134,372.20 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e tridhjetë e katër mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy pikë njëzet) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Erlis Hereni

LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "UNAZA LINDORE E QYTETIT, BASHKIA KAVAJË"

Nr.	Të dhënat mbi pasurinë sipas ASHK-së				Shpronësim tokë "truall"			Ndërtesë					
	Emri Mbiemri	ZK	Nr. pasurie	Lloji i pasurisë	Sip. e prekur m²	Çmimi/m²	Vlera, lek	Sip. e prekur m²	Çmimi/m²	Vlera, lek	Vlera totale, lek	Vendndodhja	Konfirmimi nga ASHK-ja
1	Hamide, Fiqret, Bujar Dimni, Zeliha Cepa, Luljeta Cankja	8551	18/361	Truall	200	7,745	1,549,000.00	111.00	26,520.20	2,943,742.20	**4,492,742.20**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
2	Emine, Galip,Ruzhdi, Xheladete Dimni, Saje Rrica, Shpresa Dylgjeri, Shahidije Marku, Jadushe Majani	8551	18/28	Truall	154	7745	1,192,730.00				**1,192,730.00**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
3	Gezim Gjoci	8551	17/233	Truall	308	7745	2,385,460.00				**2,385,460.00**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
4	Rexhep Gjoci	8551	17/184	Truall	231	7745	1,789,095.00				**1,789,095.00**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
5	Shtet (Selim Gjoci)	8551		Truall	--	7745	-				**-**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
6	Eqerem Maliqati	8551	17/110	Truall	45	7745	348,525.00				**348,525.00**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
7	Bajram Medihoxha	8551	17/109	Truall	60.8	7745	470,896.00				**470,896.00**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
8	Mynyr Maledhi	8551	17/111	Truall	50.4	7745	390,348.00				**390,348.00**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
9	Mustafa Celhaka	8551	17/106	Truall	72	7745	557,640.00				**557,640.00**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
10	Nazmi Baulja	8551	17/96	Truall	41.3	7745	319,868.50				**319,868.50**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
11	Nazmi Kuqi	8551	17/53	Truall	180	7745	1,394,100.00				**1,394,100.00**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
12	Eqerem Sheshi	8551	3/199	Truall	156	7745	1,208,220.00				**1,208,220.00**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
13	Defrim Sheshi	8551	3/198	Truall	15	7745	116,175.00				**116,175.00**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
14	Ylli Tafa	8551	17/112	Truall	60.5	7745	468,572.50				**468,572.50**	Lagja nr. 1	Konfirmimi nga ASHK-ja
	TOTAL						**12,190,630.00**			**2,943,742.20**	**15,134,372.20**		

Shënime:
1. Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".
2. Vlerësimi i pasurisë "ndërtesë" është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000 (i ndryshuar).

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2021-1979), datë 31.3.2021, vendosi shpalljen e vdekjes së shtetasit Burhan Strazimiri në datën 30.6.1993, lindur më datë 18.2.1947.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë me vendimin nr. 4 (64-2021-1332), datë 10.6.2021 vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasin Fatmir Guci, lindur dhe banues në Lushnjë më datë 23.10.1965, dhe vendosjen e tij në kujdestarinë e përfaqësuesit ligjor shtetasit Irind Guci.

KËRKESË

Shtetasi Zenan Petanaj kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë shpalljen të vdekur të shtetasit Fejzi Petanaj, lindur më 8.8.1966 në Vlorë.

KËRKUES
Zenan Petanaj

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 112
Datë: 2021/07/15 13:39:35
09a2849b-98f1-4800-8b90-fd824b449346

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 816 lekë